



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 14 Prill 2021

Nr: 18

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E UDHËZUESVE PËR MËNYRËN E RAPORTIMIT FINANCIAR NGA PARTITË POLITIKE, KANDIDATËT E LISTAVE SHUMËMËRORRE DHE KANDIDATËT E PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË

(Ndryshuar me vendimin nr. 11, datë 27.2.2025)

Komisioni Rregullator, në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “gj”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

(Shtojcat 1, 2 dhe 3, zëvendësuar me shtojcat e vendimit nr. 11, datë 27.2.2025)

1. Miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike, kandidatët e listave shumëëmërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, si vijon:
 - a) Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi,
 - b) Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët e listave shumëëmërore, sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi,
 - c) Udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO	Kryetar
Arens ÇELA	Anëtar
Dritan ÇAKA	Anëtar
Helga VUKAJ	Anëtar
Muharrem ÇAKAJ	Anëtar





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

**“UDHËZUES PËR MËNYRËN E RAPORTIMIT FINANCIAR NGA PARTITË POLITIKE, PËR
FUSHATËN ZGJEDHORE PËR KUVEND”**

HYRJE

Partitë politike të cilat marrin pjesë në zgjedhje, kandidatët dhe mbështetësit e tyre janë të detyruar të zbatojnë kuadrin ligjor që rregullon financimin e fushatës zgjedhore. Ky udhëzues synon të shpjegojë aspektet kryesore të kuadrit ligjor dhe në veçanti të ndihmojë partitë politike që garojnë në zgjedhje, që të raportojnë financimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.¹ Një udhëzues tjetër i hartuar posaçërisht për mënyrën e raportimit financiar të kandidatëve të listave shumëmemërore gjendet në faqen e internetit të KQZ-së.

Ky manual udhëzues është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë paraqet një pasqyrë të kuadrit ligjor që rregullon aspektet e financimit të fushatave zgjedhore, ndërsa pjesa e dytë ofron udhëzime për plotësimin e raportit financiar të fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend.

Nëse keni pyetje apo ju duhet informacion i mëtejshëm, ju lutemi kontaktoni:

Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 4

Tiranë, Shqipëri

Email: _____

I. Përmbledhje e kuadrit ligjor mbi financimin e fushatës zgjedhore

Në legjislacionin shqiptar, ka dispozita që rregullojnë financimin vjetor të veprimtarisë së partive politike dhe dispozita të posaçme që rregullojnë financimin e fushatës zgjedhore.² Ky udhëzues fokusohet në rregullat e "financimit të fushatës zgjedhore". Kur flasim për rregullat e financimit dhe raportimit të fushatës zgjedhore, është e rëndësishme të kuptojmë që “shpenzim fushate” është çdo shpenzim që bën një parti ose kandidatët e saj pavarësisht datës se kur është bërë. Pra, raporti do të duhet të përmbajë të gjitha shpenzimet e bëra edhe para fushatës zgjedhore, pavarësisht datës se kur kanë ndodhur. Ndërkohë që dhurimet, huatë ose kreditë që partia politike mund të ketë marrë dhe që kanë detyrimin për të raportuar, janë ato gjatë fushatës zgjedhore dhe 6 (gjashtë) muaj para fillimit të fushatës.

¹Ky udhëzues nuk ka për qëllim të jetë gjithëpërfshirës apo të zëvendësojë Ligjin, andaj përdoruesit këshillohen të konsultohen me Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të miratuara nga KQZ-ja dhe Ligjin për Partitë Politike.

²Shiko Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 9, Ligji “Për partitë politike” Kreu III, Kodi Zgjedhor Pjesa VII.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Në momentin e regjistrimit në zgjedhje, partia politike duhet të deklarojë llogarinë apo llogaritë e posaçme bankare për të marrë donacionet mbi vlerën 50,000 lekë³. Partia mund të zgjedhë të ketë vetëm një llogari të posaçme ose edhe disa, por kushti është që llogaritë të deklarohen. Nëse ju nuk keni llogari bankare të hapura për këtë qëllim, atëherë duhet të siguroheni që llogaria apo llogaritë e posaçme të jenë të hapura para momentit të regjistrimit, i cili është **jo më vonë se 75 ditë** përpara datës së zgjedhjeve⁴. Subjekti zgjedhor/Partia politike⁵ duhet të përfshijë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet, qoftë monetare apo në natyrë, që janë kryer edhe nga degët për qëllime zgjedhore pavarësisht datës se kur janë bërë. Të gjitha këto shpenzime përlllogariten përkundrejt tavanit të shpenzimeve që mund të bëjë një parti politike për qëllime të fushatës zgjedhore⁶.

“Fushata zgjedhore” është periudha kohore që fillon 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 (njëzet e katër) orë para fillimit të votimit. Gjatë kësaj periudhe, përveç rregullimeve ligjore të përmendura më sipër ka edhe disa rregulla në lidhje me llojin e aktiviteteve të lejuara (p.sh. materialet propagandistike dhe koha televizive).

Çfarë do të thotë financim i fushatës?

Sipas legjislacionit zgjedhor, financimi i fushatës i referohet fondeve që mblidhen dhe përdoren nga një parti politike për qëllime apo aktivitete të fushatës zgjedhore. Këtu përfshihen dhurimet monetare, por edhe mallrat ose shërbimet që ofrohen pa pagesë ose me një ulje çmimi për një parti politike⁷ dhe shpenzimet që bëhen për qëllim të fushatës.

Cilat janë burimet që lejohen për financimin e fushatës zgjedhore?

Burimet e financimit të fushatës zgjedhore për partitë politike janë katër:

- Fondet shtetërore;
- Financimi nga burime vetjake të subjektit zgjedhor;
- Dhurimet nga burime jo-publike (private);
- Huatë ose kreditë e marra nga partitë politike apo kandidatët e tyre⁸.

Ligji përcakton kushtet dhe kufizimet për çdo burim financimi, siç trajtohet më poshtë:

Fondet shtetërore ose publike

Fondi i Buxhetit të Shtetit ofron lëvrime në para për partitë politike të regjistruara si parti politike⁹. KQZ-ja i shpërndan këto fonde tek partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje të cilat kanë marrë jo më pak se 1% të votave në shkallë vendi në zgjedhjet pararendëse të të njëjtit lloj. Si rregull, financimi lëvrohet jo më vonë se

³ Neni 92/2, pikat 3 dhe 3/1 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

⁴ Neni 64 i Kodit Zgjedhor, të ndryshuar.

⁵ Këtu e më poshtë termi “Subjekt zgjedhor” janë partitë politike kur konkurojnë më vete apo si pjesë e një koalicioni përfshirë kandidatët e tyre dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Referuar neni 1 të Vendimit nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator.

⁶ Neni 92/2, pika 4 e Kodit Zgjedhor, të ndryshuar

⁷ Ky udhëzues përdor përgjithësisht termin "subjekt zgjedhor" duke iu referuar një partie politike apo kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit që janë regjistruar në KQZ si subjekte zgjedhore në përputhje me Kodin Zgjedhor. Neni 2, pika 20 e Kodit Zgjedhor përkufizon si subjekte zgjedhore “partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit”. Gjithashtu neni 63 i Kodit Zgjedhor ka përcaktime për subjektet zgjedhore. Megjithatë ka raste kur i referohemi atyre si parti politike, aty ku legjislacioni e përdor këtë term.

⁸ Neni 86 pika “ç” e Kodit Zgjedhor dhe nenet 17 dhe 20, paragrafi i dytë të ligjit “Për partitë politike”.

⁹ Neni 88, pikat 2, 3,4 dhe 5 të Kodit Zgjedhor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

5 (pesë) ditë nga regjistrimi i listave shumëmemërore të partisë përkatëse¹⁰. Nëse shuma e përfituar që i takon një partie politike është më e lartë se sa shuma e shpenzuar sipas raportimit të vetë partisë politike apo sipas vlerësimit të bërë nga KQZ-ja, atëherë partia politike do të duhet t'i kthejë fondet e ngelura. Nëse partia politike nuk e bën një gjë të tillë, atëherë kjo parti humbet të drejtën për të marrë fonde publike për të paktën 5 vjet përveçse kur shlyen detyrimin bashkë me gjobat¹¹.

Së dyti, në dispozicion të partive politike vihet edhe mbështetja jo-direkte shtetërore në formën e minutazhit falas në radio dhe televizionin publik¹² dhe privat¹³, por edhe të vendeve publike ku partitë politike mund të vendosin materiale me karakter propagandistik zgjedhor. Kryetari i bashkisë përcakton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme vendet publike të autorizuar për të afishuar materialet propagandistike.¹⁴

SHËNIM I RËNDËSISHËM

➤ Përdorimi i burimeve dhe asetëve shtetërore përveçse atyre të lejuara shprehimisht me ligj për të mbështetur partitë politike, kandidatët, ose koalicionet në zgjedhje është i paligjshëm.¹⁵ Ligji gjithashtu ndalon zhvillimin e fushatës zgjedhore në ambiente të institucioneve publike.¹⁶ Kjo do të thotë se është i ndaluar përdorimi i burimeve të autoriteteve apo institucioneve shtetërore për qëllime të fushatës zgjedhore, duke përfshirë:

- Asetet e luajshme dhe të paluajshme, si automjetet apo ndërtesat;
- Burimet njerëzore (punonjësit).

Shembull i përdorimit të paligjshëm të burimeve shtetërore:

- Zhvillimi i fushatës në ambiente të institucioneve publike.
- Përdorimi i automjeteve të institucioneve publike për transportimin e mbështetësve të partisë në një aktivitet fushate.
- Përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore.
- Përdorimi i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhor gjatë orëve të mësimi.
- Premtimi ose ofrimi i përfitimeve për punonjësit e administratës publike ose studentët për të marrë pjesë në aktivitete të lidhura me fushatën zgjedhore jashtë orëve të punës/mësimi ose ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.
- Përfshirja e logove të partive politike në faqet e internetit të institucioneve publike.
- Përdorimi i faqeve të internetit / portaleve të institucioneve publike për të promovuar fushatën e një partie politike;

¹⁰ Neni 88, pika 6 e Kodit Zgjedhor.

¹¹ Neni 88, pika 8 e Kodit Zgjedhor

¹² Neni 80 i Kodit Zgjedhor

¹³ Neni 84, pika 6 e Kodit Zgjedhor.

¹⁴ Shiko nenin 79, pika 1 e Kodit Zgjedhor dhe udhëzimin e KQZ nr. 06, datë 23.03.2021, "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".

¹⁵ Shiko nenin 91 të Kodit Zgjedhor. Ndalimi i përdorimit të burimeve shtetërore zbatohet edhe për partitë/subjektet ku shteti zotëron kapital ose kuota dhe/ose emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose administrues të entit

¹⁶ Shiko neni 3, pika 7 dhe neni 78, pika 6 të Kodit Zgjedhor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

- Dhënia ose shpërndarja e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë (p.sh. rritja e pagave, pensioneve etj.)
- Marrja në punë, shkarkimi apo transferimi në detyrë i punonjësve në institucionet publike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, përveç në rrethana specifike.

Financimi nga burime vetjake të partisë politike

Neni 20, i ligjit për “Partitë Politike”, i ndryshuar, i lejon partive politike të përdorin pasuritë dhe mjediset e tyre për aktivitete të ndryshme me qëllim përfitimi. Ligji identifikon aktivitete specifike të tilla si botimet, shtypshkrimet, shërbimet ose qiradhëniet. Të ardhurat e krijuara nga këto lloj aktiviteteve dhe nga tarifatat e anëtarësimit mund të përdoren për të financuar fushatën zgjedhore të partisë politike.

Financimi nga burime jo-publike (private)

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, partitë politike mund të marrin fonde vetëm nga persona fizik ose juridik vendas.¹⁷ Tek personat fizik vendas përfshihen edhe shtetasit shqiptarë që jetojnë në një shtet tjetër.¹⁸ Fjala “vendas” në ligj është përdorur si antonim i fjalës “i huaj”, pra ka lidhje me shtetësinë e personit dhe jo me vendbanimin e tij. Prandaj termi “person fizik vendas” përfshin edhe shtetas shqiptarë që jetojnë në një vend tjetër.

Dhuruesit e palejueshëm

Personat fizikë dhe juridikë të huaj nuk lejohen të dhurojnë vlera monetare për fushatën zgjedhore të një partie politike. Gjithashtu një parti politike nuk mund të pranohet donacione nga donatorë anonimë¹⁹.

Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik vendas nëse personi juridik apo çdo aksionar i tij:

Ka përfituar fonde publike, kontrata, apo koncesione gjatë tre viteve të fundit, të cilat tejkalojnë 10 milionë lekë. Ky detyrim zbatohet edhe për rastet e nënkontraktimeve apo të kontratave të partneritetit publik privat.

Ushtron veprimtari në fushën e medias;

Ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme; ose

Ka një detyrim monetar kundrejt shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.²⁰

Përveç ndalimit si më sipër, edhe personat fizikë apo juridikë që nuk kanë përfituar fonde publike, kontrata apo koncesione gjatë 3 (tre) viteve të fundit para zgjedhjeve, por që financojnë partitë politike në fushatë apo kandidatët e tyre, nuk do të mund të përfitojnë për periudhën deri tre vite pas zgjedhjeve, kontrata publike, kontrata të partneritetit publik privat ose në çdo mënyrë tjetër fonde me vlerën totale që tejkalon shumën 10 milionë lekë.

Shuma totale që një dhurues i vetëm mund të kontribuojë është e kufizuar me ligj në vlerën 1 milion lekë (qoftë në para ose kundërvlera në sende ose shërbime). Çdo dhurim që kap vlerën mbi 1 milion lekë është i paligjshëm.²¹

¹⁷ “Person juridik” është termi i përdorur nga ligji i cili nënkupton subjektet juridike.

¹⁸ Shiko nenin 92/1, pika 1 e Kodit Zgjedhor.

¹⁹ Shiko nenin 23/1, pika 2 e Ligjit për partitë politike

²⁰ Shiko nenin 92/1, pika 3 ç e Kodit Zgjedhor.

²¹ Shiko nenin 92/1, pika 2 e Kodit Zgjedhor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Huatë ose kreditë

Huatë ose kreditë janë një formë tjetër e burimit të ligjshëm të financimit për fushatën zgjedhore²². Kreditë do të llogariten përkundrejt tavanit të dhurimit prej 1 milion lekë. Kushtet e kontratës së kredisë do t'i nënshtrohen auditimit si çdo burim tjetër financimi për çdo parti politik. Kur merr një kredi, partia politike duhet të respektojë legjislacionin fiskal në fuqi që rregullon këtë aktivitet, në të kundërt kreditë e marra në kundërshtim me ligjin mund të përbëjnë një burim ilegal të financimit. Partia politike do të duhet të sigurojë dokumentacionin mbështetës për secilën hua, përfshirë kështu e pagimit.

Rregulla të tjera

Mënyra e financimit me fonde private i fushatave zgjedhore rregullohet nga dispozita të tjera:

Çdo dhurues duhet të nënshkruajë një deklaratë, duke pohuar se nuk aplikohet asnjë nga kushtet e përgjashtimit të dhuruesit nga dhurimi.²³

Të gjitha dhurimet mbi 50,000 lekë duhet të bëhen vetëm në llogaritë bankare të posaçme të deklaruara në KQZ nga partia politike.²⁴ Edhe nëse dhurimet janë më të vogla se 50,000 lekë, por do bëhen nëpërmjet bankës, atëherë partia politike është gjithsesi e detyruar të përdorë vetëm llogaritë e deklaruara.

Emri i personave që dhurojnë shuma më të mëdha se 50 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse bëhet publike bashkë me raportin e partisë politike dhe raportin e auditimit.²⁵

Çfarë është një dhurim në natyrë? Si ndryshon nga aktiviteti vullnetar?

Disa mbështetës të partisë politike mund të bëjnë dhurim monetar, për shembull, duke transferuar para në llogari bankare ose duke i ofruar para fizike (e quajtur ndryshe “cash”) për partinë politike. Përkrahës të tjerë mund t'i ofrojnë partisë politike mallra ose shërbime falas ose me një çmim të ulur, të cilat quhen ndryshe dhurime në natyrë. Në rast se malli apo shërbimi është ofruar me çmim më të ulët nga çmimi real, atëherë diferenca ndërmjet shumës që një parti politike do të paguante me çmim tregu për mallrat apo shërbimet dhe çmimit që ka paguar realisht do të konsiderohet si dhurim në natyrë. Dhurimet, qofshin këto në para ose në natyrë, i nënshtrohen të njëjtave rregulla. Dhurimet mund të ofrohen nga dhuruesit e lejuar deri në shumën 1 milion lekë dhe bëhen publike nëse shuma e përgjithshme nga një dhurues tejkalon vlerën 50,000 lekë. Deklaratat e dhuruesve mbahen nga partia politike si për dhurimet në para ashtu edhe për ato në natyrë.

Kur dikush ofron kohën e tij/saj pa pagesë për të ndihmuar në fushatë (p.sh. duke shpërndarë fletushka), ky është “aktivitet vullnetar” dhe jo “dhurim në natyrë”. Ai nuk do të përfshihet në raportin e financimit të zgjedhjeve të partisë politike. Nëse shërbimet nuk ofrohen sipas kushteve të tregut dhe as në formë vullnetare, atëherë këto konsiderohen dhurime në natyrë dhe si të tilla duhet të kostohen dhe regjistrohen. Për të kuptuar më mirë dallimin ndërmjet aktivitetit vullnetar dhe dhurimit në natyrë po japim disa shembuj të tjerë:

²² Shiko Nenin 86 pika ç e Kodit Zgjedhor

²³ Shiko nenin 92/2, pika 1 e Kodit Zgjedhor

²⁴ Shiko nenin 92/2, pika 2 e Kodit Zgjedhor

²⁵ Shiko nenin 92/6, pika 1 dhe 4 e Kodit Zgjedhor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

- Vendosja në dispozicion e mjediseve tregtare për zyra zgjedhore apo për zhvillimin e mbledhjeve është dhurim në natyrë, ndërsa hapja e dyerve të shtëpisë për takime fushate me komunitetin është aktivitet vullnetar;
- Vendosja në dispozicion të fushatës e automjetit personal për transportin e aktivistëve është aktivitet vullnetar, kurse vendosja e mjeteve të kompanisë, e mjeteve taksi apo e autobuzëve është donacion.
- Marrja apo përdorimi i mallrave (të tilla si kompjuterat) pa pagesë ose me një vlerë të ndryshme nga tregu, do të konsiderohet si dhurim në natyrë dhe jo si veprimtari vullnetare.

Si të vlerësoni një dhurim në natyrë²⁶?

Kur partia politike merr një dhurim në natyrë, vlera e këtij dhurimi duhet të përcaktohet në vlerë monetare. Nëse lindin pyetje se si do të bëhet përlllogaritja e vlerës që ka në para, përgjigja mund të trajtohet si më poshtë: Sa do të kishte paguar partia politike për mallrat ose shërbimet nëse do t'i kishte blerë me çmimin e tregut? Vlera e dhurimit në natyrë është diferenca ndërmjet vlerës së tregut me shumën e paguar (nëse ka).

$$\text{(Vlera e tregut)} - \text{(Vlera e paguar)} = \text{Dhurim në natyrë}$$

Për të bërë sa më të lehtë raportimin dhe vlerësimin e dhurimeve në natyrë, do të zbatohen rregullat e mëposhtme. Në rastin kur partisë politike i janë ofruar:

- a) mallra dhe/ose shërbime falas ato do të vlerësohen me çmimin e tregut dhe do të raportohen;
- b) mallra dhe/ose shërbime me një çmim që është të paktën 10% më i ulët se çmimi i tregut, atëherë diferenca prej 10% apo më shumë (sipas rastit) do të raportohet si donacion;
- c) edhe në rastet kur diferenca midis çmimit të tregut dhe çmimit të ofruar është më pak se 10% e vlerës por më e madhe se 50 mijë lekë, vlera duhet të raportohet si dhurim. (shihni shembullin 4 më poshtë)

Çmimi i tregut për mallra dhe shërbime do të përcaktohet me një nga metodat e mëposhtme:

- Nëse është e mundur, duke iu referuar indeksit mujor të çmimeve, të publikuara nga INSTAT, në kohën kur mallrat/shërbimet janë ofruar.
- Nëse furnitori operon në biznesin e ofrimit të këtyre të mallrave dhe shërbimeve, çmimi i tregut do të jetë vlera normale tregtare që aplikon furnitori për to, ose
- Partia politike llogarit çmimin e tregut mbi bazën e mesatares së çmimeve të ofruara nga tre ofrues mallrash /shërbimesh të ngjashme.

Shembull 1

Partia politike A (SZA) kërkon të marrë me qira pajisje audio-vizuale për mitingun e hapjes së fushatës zgjedhore në Tiranë. Shoqëria “Shiko dhe Dëgjo” është ofruar t’i japë pajisjet për këtë organizim me një kosto prej 135,000 lekë. Normalisht, kjo shoqëri do të kërkonte 165,000 lekë për një organizim të tillë, por administratori i shoqërisë “Shiko dhe Dëgjo” dëshiron të mbështesë SZA-në.

- Në këtë rast, partia politike SZA duhet të raportojë një dhurim në natyrë prej 30,000 lekë nga shoqëria “Shiko dhe Dëgjo” në raportin e tij në seksionin 2(c) të formularit tip. Kjo sepse shumën e zbritjes

²⁶ Shih vendimin nr .10, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator të KQZ-së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

është më shumë se 10% e çmimit normal. Vlera e dhurimit në natyrë prej 30,000 lekë, do të llogaritet vetë automatikisht edhe si shpenzim nga formati tip i raportimit.

Shembull 2:

Partisë “Dua të Fitoj” i ofrohet hapësirë për zyre falas në Vlorë, Tiranë dhe Korçë për t’u përdorur si zyra zgjedhore nga z. Bujar, një shtetas shqiptar që zotëron pasuri të patundshme në të gjithë vendin. Partia ka bërë përlllogaritjen se sa do të kushtonte për të marrë me qira një hapësirë të ngjashme në këto vende për periudhën e fushatës dhe arriti në përfundimin se vlera e dhurimit arriti në 800,000 lekë.

Në këtë rast dhurimet në natyrë për zyrat zgjedhore përfshihen në Seksionin 2(c) të formatit tip të raportimit. Në rast se partia politike ka paguar vetë qiranë e zyrave, këto shpenzime do të raportohen në kategorinë “Shpenzime zyrë elektorale” në tab-in “4. Shpenzimet e partisë”. Përveç qirasë së ambientit për zyra zgjedhore, partia politike gjithashtu duhet të raportojë kostot e tjera të zyrës zgjedhore siç janë uji, energjia elektrike, dhe çdo shpenzim tjetër i kryer në funksion të zyrave zgjedhore. Kjo duhet të bëhet për të gjitha zyrat zgjedhore në çdo zonë elektorale pavarësisht nëse ato janë siguruar si dhurime në natyrë ose përfshijnë pagesa parash për përdorimin e tyre.

Shembull 3:

Shoqëria "Karrige me Mbështetëse" i jep partisë politike SZA 100 karrige për t’i përdorur gjatë takimeve të fushatës për një periudhë dy javore. Shoqëria normalisht do të kërkonte 75,000 lekë për këtë lloj qiraje.

Në qoftë se partia politike SZA nuk paguan këtë shërbim, atëherë ky dhurim në natyrë në vlerën 75,000 lekë duhet të regjistrohet. Partia politike SZA mund t’i referohet INSTAT-it për të parë nëse ka një normë të caktuar. Nëse Shoqëria “Karrige me Mbështetëse” vetëm shet karrige dhe zakonisht nuk i jep ato me qira, atëherë partia politike SZA duhet të marrë normën e çmimeve nga tre shoqëri që ofrojnë shërbimin e dhënies së karrigeve me qira. Mesatarja e tri ofertave do të raportohet si shuma e dhurimit në natyrë.

Shembull 4:

Mega Media është një shoqëri që operon në sektorin e reklamave. Zakonisht, kjo shoqëri merr 1,500,000 lekë për prodhimin e reklamave të fushatës zgjedhore në televizion dhe radio. Megjithatë, ajo i ofron partisë politike SZA, një zbritje prej 5% (një zbritje çmimi prej 75,000 lekë) për të prodhuar reklamat televizive dhe në radio të SZA-së, e kështu i faturon SZA-së vetëm vlerën prej 1,425,000 lekë.

- Partia politike SZA duhet të raportojë një dhurim në natyrë prej 75,000 lekë nga Mega Media në seksionin 2c të raportit të vet, sepse vlera e zbritur është më e lartë se 50,000 lekë, pavarësisht se është më pak se 10% e çmimit të tregut.

Si raportohen dhurimet në natyrë?

Dhurimet në natyrë raportohen si dhuratë për fushatën dhe njëkohësisht si shpenzim i fushatës. Kufiri prej 1 milion lekë i dhurimeve nga një dhurues i vetëm përfshin edhe dhurimet në natyrë. Këto dhurime në natyrë llogariten kundrejt kufirit të lejueshëm të shpenzimeve të partisë politike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Partia politike do t'i regjistrojë dhurimet në natyrë duke plotësuar informacionin e kërkuar për raportimin e dhurimeve në natyrë në seksionin 2c të formularit tip të raportimit (dhurimet jo-publike në natyrë). Pasi të futen këto të dhëna në formularin tip në Excel ata do të përlllogariten automatikisht në totalin e pjesës përmbledhëse financiare (Pjesa B e Tabelës 1, Përmbledhje Financiare) për shpenzimet indirekte.

VINI RE: Vlera e çdo dhurimi në natyrë do të llogaritet automatikisht edhe si shpenzim nga formati tip i raportimit. Kjo do të thotë që ky shpenzim llogaritet përkundrejt edhe tavanit total të shpenzimeve që mund të bëjë një partia politike.²⁷

Shembull 5:

Z. Luan është një mbështetës i madh i partisë politike A (SZA) dhe mik i vjetër i një kandidati të listës shumemërore të SZA-së në zonën zgjedhore X. Z. Luan i dhuron SZA-së 125,000 lekë. Ai i jep gjithashtu kandidati që e ka mik, një donacion prej 60,000 lekësh dhe një donacion tjetër prej 25,000 lekë degës lokale të SZA-së në zonën zgjedhore përkatëse. Gjatë fushatës, z. Luan shpërndan fletushka në lagjen e tij. Ai gjithashtu pajton dikë me kontratë shërbimi që të ndihmojë fushatën me kryerjen e telefonatave. Z. Luan e paguan këtë person me 40,000 lekë. Së fundmi, ai i jep kandidati që e kishte mik, të përdorë pa pagesë mjediset e zyrës në ndërtesën e tij tregtare. Normalisht, ai do ta jepte me qira atë hapësirë për 30,000 lekë në muaj. Kjo do të thotë që z. Luan ka bërë një donacion total për fushatën në shumen e 280,000 lekëve.

Partia do të raportojë dhurimin monetar prej 125,000 lekë që ka marrë nga z. Luan dhe dhurimin tjetër prej 25,000 lekë në degën e saj të bërë po ashtu nga z. Luan, në tab-in 2b të raportit të partisë. Gjithashtu, do të duhet të raportojë donacionin në natyrë 40,000 lekë (tek tab-i 2c) që z. Luan ka bërë si pagesë për punonjësin e telefonit.

Kandidati që ishte mik i z. Luan dhe që mori dhurimin nga ai, do të duhet të përfshijë në raportin e financimit të fushatës së tij 60,000 lekë të dhuruara nga z. Luan dhe 30,000 lekë dhuratë në natyrë për hapësirën e zyrës, së bashku me të gjitha donacionet e tjera të marra për fushatën e tij / saj. Kryefinancieri i SZA-së do të përfshijë shumën totale të dhurimeve dhe të shpenzimeve të raportuara nga kandidati në fjalë në tab-in 5.a apo 5.b (sipas rastit) të formatit tip të raportimit të SZA-së.

Asgjë nuk duhet të raportohet për kohën që z. Luan shpenzoi për shpërndarjen e fletushkave pasi kjo do të kualifikohet si aktivitet vullnetar.

Shembull 6:

Kompania “Albanian Mega Estate” i ofron hapësirë falas për zyra zgjedhore partisë politike A (SZA) 60 ditë para ditës së zgjedhjeve deri një javë pas ditës së zgjedhjeve. Pagesa normale e qirasë për këtë hapësirë do të ishte 150,000 lekë në muaj.

Kompania “Albanian Mega Estate” ka ofruar një kontribut prej 300,000 lekë për SZA për periudhën parazgjedhore (qiraja të cilën partia do ta kishte paguar me çmim tregu për periudhën në fjalë), e cila duhet të raportohet në raportin financiar të fushatës zgjedhore si dhurim në natyrë. Pjesa e ngelur për një periudhë një javore (ose një javë) pas zgjedhjeve me një kundërvlerë prej 37,500 lekë duhet të raportohet sërish si donacion në natyrë por kjo pjesë mund të përfshihet në raportin vjetor financiar të partisë meqenëse fushata zgjedhore dhe zgjedhjet kanë përfunduar.

²⁷ Neni 92/2, pika 4 e Kodit Zgjedhor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Shembull 7:

Kompania “Albanian Super Financial” i jep një kredi prej 2 milion lekë partisë politike SZA me normë interesi 1% në vend të normës 4% që do të ishte vlera normale e tregut, e pagueshme për një periudhë 1 (një) vjeçare.

- Kompania “Albanian Super Financial” i ka dhënë një kontribut në natyrë prej 60,000 lekë (diferenca ndërmjet shumës së paguar nga SZA dhe shumës që do paguhej nëse norma interesit do të ishte me vlerën normale të tregut). Kjo duhet të raportohet si dhurim në natyrë. Megjithatë kredia është e paligjshme sepse kalon parashikimin ligjor për pragun e 1 milion lekëve mbi dhurimet dhe kreditë²⁸. Për këtë shkelje, KQZ-ja do të ndërmernte sanksione sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

Shembull 8:

Një mbështetës i SZA që merret me biznes, shpenzon drejtpërdrejt një shumë prej 2,5 milion lekë për organizimin e një mitingu fushate për partinë politike SZA.

- Personi në fjalë ka dhënë një kontribut në natyrë prej 2,5 milion lekësh, por ka kaluar pragun prej 1 milion lekë pasi dhurimet që mund të bëjë një donator i vetëm janë kufizuar deri në 1 milion lekë. Në këtë rast kemi një kontribut të paligjshëm prej 1.5 milion lekë. Partia politike nuk duhet të pranonte një donacion në para, apo kundërvlerën në sende apo shërbime që e kalojnë vlerën 1 milion lekë.

Çfarë hapash duhet të ndjekë një parti politike në lidhje me mbledhjen e fondeve për zgjedhje?

1. Të hapë llogari bankare të posaçme dhe t’i deklarojë ato pranë KQZ-së në momentin e regjistrimit si parti politike. Partia politike mund të zgjedhë të hapë vetëm 1 (një) llogari të posaçme, por ligji ia lejon të hapë apo të përdorë më shumë se një llogari nëse partia politike e gjykon të nevojshme. Megjithatë për arsye se periudha e raportimit për dhurimet që mund t’i bëhen partisë politike fillon që 6 (gjashtë) muaj para fillimit të fushatës, sugjerohet që partia politike të hapi llogarinë apo llogaritë bankare të posaçme për të marrë donacione dhe të mos presë deri në afatin e fundit që ka përcaktuar ligji;
2. Të regjistrojë dhurimet e marra nga çdo dhurues së bashku me të dhënat e identitetit të tij/saj në formularin e miratuar nga KQZ-ja;
3. Të pranojë dhurime monetare që tejkalojnë shumën 50,000 lekë vetëm përmes llogarisë/llogarive bankare të posaçme dhe të mos pranojë dhurime qofshin edhe me më pak se 50,000 lekë në një llogari bankare të padeklaruar.
4. Të kujdeset që të gjitha dhurimet në natyrë të vlerësohen dhe regjistrohen siç duhet;
5. Të ruajë dokumentet origjinale dhe kopjet e të gjithë dokumentacionit mbështetës në lidhje me të ardhurat e fushatës të mbledhura, qoftë monetare apo në natyrë;
6. Të mbajë kopje të të gjithë formularëve të deklarimit të dhuruesve.

SHËNIM I RËNDËSISHËM

²⁸ Neni 86 pika ç e Kodit Zgjedhor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Partitë politike të regjistruara në zgjedhje kanë përgjegjësi ligjore për të raportuar bilancin e aseteve për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatëve të listave shumëmemërore gjithashtu duhet të respektojnë rregullimet për kufirin e lejueshëm të dhurimeve. Edhe kandidatët e listave shumëmemërore duhet t'i regjistrojnë të gjitha donacionet e marra, të sigurohen që donacionet në natyrë vlerësohen dhe regjistrohen si duhet dhe të mbajnë 1 (një) kopje të deklaratës që firmos dhuruesi. Kandidatët mund të pranojnë donacione mbi 50,000 lekë vetëm nëpërmjet një llogarie të posaçme bankare, edhe nëse donacionet janë më të vogla se 50,000 lekë por kryhen me anë të bankës. Këto dhurime duhet të derdhen vetën në llogarinë e posaçme të deklaruar në momentin e regjistrimit. Nëse kandidati vendos të mos pranojë dhurime të tilla (p.sh. kandidati vendos që dhurimet të dërgohen tek llogaria e posaçme e partisë për fushatën), atëherë kandidati nuk e ka të detyrueshme të hapi një llogari bankare të posaçme.

Është e kundërligjshme nëse një parti politike apo edhe një kandidat pranon një dhurim nga një person fizik ose juridik që nuk deklaron identitetin e tij, apo identiteti i të cilit është i paqartë.

Si raportohen donacionet e bëra për kandidatët dhe degët e partive?

Donacionet e fushatës mund të bëhen në zyrën qendrore të një partie politike, tek një degë apo zyrë lokale ose tek kandidati i partisë. Kryefinancieri i zyrës qendrore të partisë do të duhet të përfshijë të gjitha donacionet në raportin e financimit të fushatës që i dorëzon KQZ-së pavarësisht se ku ose nga kush janë pranuar. Sipas Kodit Zgjedhor²⁹, raporti duhet të përfshijë “çdo dhurim, hua ose kredi që i është dhënë subjektit zgjedhor (përfshirë degët dhe kandidatët e tij) gjatë fushatës dhe 6 (gjashtë) muaj para fushatës dhe burimin e saj, përfshirë këtu dhurimet apo shërbimet në natyrë.”

Siç u theksua me sipër, kandidatët e listave shumëmemërore janë të detyruar të regjistrojnë dhe të dokumentojnë të gjitha financimet e fushatës. Siç diskutohet më poshtë, KQZ ka miratuar një formular tip raportimi për t'u plotësuar nga kandidatët e listave shumëmemërore dhe për t'u dorëzuar tek kryefinancieri i partisë së tyre brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e zgjedhjeve. Në rast se një kandidat është pjesë e një liste të mbështetur nga një koalicion partish, atëherë partia brenda koalicionit e cila është caktuar si parti udhëheqëse duhet të raportojë shpenzimet për secilin kandidat të partive pjesë e koalicionit në raportin financiar të fushatës zgjedhore.

Partia duhet të krijojë mekanizmat për degët dhe pjesët përbërëse në mënyrë që të raportojnë donacionet dhe shpenzimet tek zyrat qendrore të partisë³⁰.

Cilat janë rregullat në lidhje me shpenzimet e fushatës?

Ligji përcakton si detyrim një tavan të nivelit të shpenzimeve që një parti politike mund të kryejë për fushatën zgjedhore. Neni 92/2, pika 4 e Kodit Zgjedhor parashikon:

Shuma e shpenzimeve të bëra nga një subjekt zgjedhor, pa përfshirë kandidatët e tij, për fushatën zgjedhore, nuk duhet të jetë më shumë se 5 herë më e madhe se shumta më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji.

²⁹ Neni 92/3 pika 2, gërma “a” e Kodit Zgjedhor

³⁰ Neni 90, pika 3 e Kodit Zgjedhor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Shpenzimet e kujt duhet të përfshihen si shpenzime fushate?

Kufizimi (tavani) i shpenzimeve zbatohet për të gjitha shpenzimet e bëra, qoftë nga zyra qendrore e partisë politike, zyrat e qarkut / degës.

SHËNIM I RËNDËSISHËM

- Partitë politike duhet të udhëzojnë degët e tyre që niveli maksimal i shpenzimeve të mos tejkalohet dhe do të duhet të përcaktojnë se si degët raportojnë në zyrën qendrore që më pas t'i përfshijë në raportin financiar për fushatën zgjedhore. Partia politike është ligjërisht përgjegjëse për të siguruar që raporti i fushatës zgjedhore përfshin shpenzimet e degëve të saj dhe të kandidatëve të listave shumemërore.³¹
- Kandidatët e listave shumemërore duhet të regjistrojnë shpenzimet e tyre të fushatës duke përdorur formatin tip të raportimit të miratuar nga KQZ-ja dhe të dërgojnë formularin e plotësuar tek kryefinancieri në zyrën qendrore të partisë, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e zgjedhjeve.

Çfarë shpenzimesh duhet të përfshihen si shpenzime fushate?

Si shpenzim për fushatë konsiderohet çdo shpenzim që bëhet për qëllime të fushatës nëse është bërë nga partia, kandidatët apo degët e saj. Çdo shpenzim i fushatës, pagesa përfundimtare e të cilit shtyhet deri pas zgjedhjeve duhet gjithashtu të regjistrohet.

Çfarë raportesh do të dorëzohen nga partia politike dhe cili është afati kohor për to?

Kryefinancieri i çdo partie politike të koalicionit, parti politike më vete duhet të paraqesë një raport të konsoliduar të zgjedhjeve të financave të fushatës, me dokumentacionin mbështetës, në KQZ jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve. Raporti duhet të përfshijë të ardhurat dhe shpenzimet e partisë politike, degëve dhe të gjithë kandidatëve të saj. Për kryefinancierin është e rëndësishme të hartojë një raport të plotë duke përdorur formatin e standardizuar të miratuar me vendimin nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 13, datë 6.4.2021, të Komisionit Rregullator “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”; mosrespektimi i parashikimit ligjor për ta bërë këtë do të rezultojë në vendosjen e një penalteti.

Për të ndihmuar kryefinancierët në përpilimin e raporteve financiare të konsoliduara, KQZ-ja ka hartuar një format tip të raportimit për e listave shumemërore, i cili duhet të përdoret nga kandidatët. Raporti i kandidatëve të listave shumemërore i plotësuar duhet të paraqitet së bashku me dokumentet mbështetëse, tek kryefinancieri i partisë politike jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e zgjedhjeve. Koha e nevojshme për kryefinancierin të përpilojë raportin e plotë të fushatës, i cili duhet të depozitohet në KQZ jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve dhe duhet të jetë i nënshkruar nga kryetari i partisë politike ose personi i autorizuar nga ky i fundit dhe nga financieri i saj, si dhe kopjet e raporteve të kandidatëve duhet të bashkëngjiten. **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u mundëson subjekteve**

³¹Neni 90, pika 4 e Kodit Zgjedhor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

zgjedhore dorëzimin e raporteve financiare të fushatës zgjedhore edhe nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar (PERF), e cila gjendet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Çfarë ndodh pasi raportet për fushatën zgjedhore janë dorëzuar?

KQZ-ja do të ndërmarrë një shqyrtim paraprak të raporteve për të verifikuar përputhjen me kërkesat formale, sipas formatit tip të miratuar nga KQZ-ja. Në rast të gjetjes së mangësive, KQZ njofton partinë politike dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga paraqitja e raportit dhe partia politike do të ketë 3 (tre) ditë pune për të korrigjuar raportin. Në çdo rast, raporti i ndryshuar ose shpjegimet e partisë politike publikohen nga KQZ-ja në faqen e saj zyrtare jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas ridepozitimit të tij. Pas verifikimit fillestar, KQZ-ja do t'i krahasojë të dhënat në raport me gjetjet dhe konkluzionet e raporteve të auditimit dhe raportet e monitorimit të fushatës zgjedhore gjithashtu dhe me çdo informacion të marrë zyrtarisht ose gjatë hetimeve administrative ose nga denoncimet për shkelje të mundshme të financimit të fushatës sipas Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për Partitë Politike.

KQZ-ja cakton një numër personash për të monitoruar përmbushjen nga partitë politike të detyrimeve në lidhje me financimin e fushatës dhe detyrimeve të tjera që lidhen me përdorimin apo shpërdorimin e burimeve publike. Roli i monitoruesve të fushatës është që të sigurohen që partitë politike të respektojnë rregullat e fushatës dhe të raportojnë në KQZ për aktivitetet zgjedhore që do të vëzhgojnë.

KQZ-ja do të caktojë një ose më shumë auditues ligjorë të licencuar për të kryer kontrollin e fondeve të marra dhe shpenzuara nga çdo parti politike sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit dhe kontabilitetit. Caktimi i audituesve bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.³²

Partitë politike duhet të venë në dispozicion të gjitha informacionet, dokumentet dhe të dhënat që lidhen me financimin dhe shpenzimet e fushatës, përndryshe do të dënohen me gjobë.³³ Për ta bërë këtë gjë në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme, partitë duhet të përdorin formularët tip të standardizuar, të miratuara nga KQZ-ja.

Për t'i ndihmuar me dorëzimin dhe paraqitjen e rregullt të informacionit, KQZ-ja ka miratuar një formular raporti tip të financimit të zgjedhjeve për t'u përdorur nga ana e partive politike. Formulari tip i raportit do të shqyrtohet më në detaj më poshtë. KQZ-ja gjithashtu ka miratuar një formular tip raportimi për t'u përdorur nga kandidatët e listave shumemërore. Vlen të përmendet përsëri se dorëzimi i raporteve në kundërshtim me formatin e standardizuar - që do të thotë raporte që nuk janë të plota, nuk ndjekin të njëjtën strukturë, janë formuluar përmes një aplikacioni tjetër kompjuterik, etj. - do të rezultojnë në një gjobë që varion nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë, pavarësisht nga saktësia e informacionit që ato përmbajnë. Informacioni mbi formularin e raportimit për kandidatët e listave shumemërore mund të gjenden në Udhëzimet për Mënyrën e Raportimit të Kandidatëve të listave shumemërore.

Çfarë dokumentesh duhet të mbahen nga partia politike?

³²Shiko Nenin 92/6 të Kodit Zgjedhor

³³Neni 173 i Kodit Zgjedhor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Partitë politike kanë detyrimin të “vënë në dispozicion të auditit të emëruar nga KQZ-ja çdo informacion, dokumente apo të dhëna që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore”, sipas nenit 92/6, pika 2, të Kodit Zgjedhor³⁴. Këtu përfshihen:

- Deklaratat e dhuruesve, e miratuar me vendimin nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 13, datë 6.4.2021, të Komisionit Rregullator “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”;
- Dokumentet që përcaktojnë identitetin e dhuruesit;
- Bilancin e asetëve të miratuar me vendimin nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 13, datë 6.4.2021, të Komisionit Rregullator “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”;
- Kopje të çeqeve të marra nga dhuruesit;
- Pasqyra nga llogaritë bankare të partisë politike;
- Faturat e të gjitha shpenzimeve;
- Të gjitha dokumentet e përdorura nga partia politike për të llogaritur vlerësimin e dhurimeve dhe shpenzimeve në natyrë, p.sh. indeksi mujor i çmimeve i publikuar nga INSTAT, kuotat e ofruara nga ofruesit e mallrave/shërbimeve të ngjashme, kopja e tarifave tregtare për mallin/ shërbimin përkatës;
- Pasqyrë e llogarive të partisë politike në fillim të fushatës;
- Dokumente që vërtetojnë kryerjen e një këmbimi valutë me kursin e caktuar, të një monedhe të huaj në monedhën vendase apo anasjelltas, me qëllim kryerjen e një pagese apo shlyerjen e një fature, apo nëse partia politike merr një dhurim në monedhë të huaj të cilin e konverton në monedhën vendase.

Shënim i Rëndësishëm:

Kandidatët e listave shumëmemërore duhet gjithashtu të dokumentojnë siç duhet financimin e tyre në zgjedhje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe partitë politike duhet të konsiderojnë se si ata mund ta përforcojnë këtë mesazh dhe të mbështesin kandidatët e tyre për ta bërë këtë.

Cilat janë sanksionet në rast shkeljeje të ligjit?

Në varësi të natyrës së shkeljes mund të vendosen një numër sanksionesh në lidhje me financimin e fushatës, Neni 173 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

1. Shkelja e dispozitave për financimin e fushatës zgjedhore nga personi përgjegjës i financës dënohet me një gjobë nga 100 000 deri 200 000 lekë.
2. Pengimi ose mosbashkëpunimi i subjektit zgjedhor me audituesin e KQZ-së dënohet me një gjobë nga 2 000 000 deri 3 000 000 lekë. E njëjta shkelje e kryer kundrejt monitoruesit të KQZ-së dënohet me gjobë nga 50 000 deri 100 000 lekë.
3. Mosparaqitja e një raporti financiar për fushatën brenda afatit ligjor dënohet me një gjobë prej 2 000 000 lekësh. Paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja dënohet me gjobë nga 500 000 deri 1 000 000 lekë.

³⁴ Përsa i përket shpenzimeve, Neni 92/3, pika 3 e Kodit Zgjedhor, thotë që çdo shpenzim për fushatën zgjedhore duhet të dokumentohet dhe kryhet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

4. Fondet jopublike të përfuara nga një subjekt zgjedhor, identiteti i dhuruesit të të cilave nuk dihet ose nuk përcaktohet qartësisht, transferohen në llogarinë e KQZ-së. Moskalimi çon në konfiskimin e fondeve të marra dhe në një gjobë të barabartë me shumën e fondeve të marra.
5. Pranimi i fondeve private më vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare, dënohet me një gjobë të barabartë me shumën e dhuruar dhe në kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së.
6. Pranimi i fondeve nga donatorë të ndaluar, siç specifikohet në pikën 3 të nenit 92/1, dënohet me kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së dhe me një gjobë të barabartë me dyfishin e shumës së fondeve të marra.
7. Shkelja e përcaktimeve të bëra në nenin 92/2 të këtij ligji nga dhuruesit ndëshkohet me gjobë deri në 30 për qind të shumës së dhuruar.
8. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme gjatë procesit të verifikimit nga KQZ-ja sipas pikës 6 të nenit 92/6, ndëshkohet me gjobë nga KQZ-ja nga 100 000 lekë deri në 3 000 000 lekë.
9. Shkelja e kufirit maksimal të shpenzimeve nga një subjekt zgjedhor dënohet me një gjobë prej 5 000 000 lekësh ose me një gjobë të barabartë me shumën që ka kaluar kufirin, cilado që është më e lartë.
10. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të gjobës së dhënë në bazë të këtij neni. Gjoha e vënë nga KQZ-ja është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet brenda 30 ditësh nga marrja dijani për të. KQZ-ja përjashtohet nga detyrimi të parapaguajë taksën apo tarifën për shërbimin përmbartimor.

Gjatë vlerësimit të sanksioneve KQZ do të aplikojë parimin e proporcionalitetit dhe do të marri në konsideratë faktorët e mëposhtëm.

- a) rrethanat e kryerjes së shkeljes;
- b) rëndësinë e shkeljes;
- c) nëse partia politike është ose jo përsëritës;
- d) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi i subjektit deklarues;
- e) sjellja që ka pasur partia politike kundrejt rekomandimeve të KQZ-së si dhe niveli i bashkëpunimit gjatë procesit të verifikimit.

II. Formulari tip i raportimit financiar të fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend.

Të gjitha partitë politike duhet të raportojnë në lidhje me dhurimet dhe shpenzimet e tyre për periudhën para dhe gjatë fushatës, dhe duhet të mbajnë dokumentacionin mbështetës. Komisioni Qendror Zgjedhor ka miratuar një format tip për raportim, i cili detajon gjithë informacionin që duhet të jepet nga partitë politike.

Formulari tip i miratuar është në formatin Excel dhe do të dorëzohet në KQZ në një kopje fizike dhe një kopje elektronike.

Formulari tip i raportimit përmban seksionet e mëposhtme:

1. Përmbledhje financiare
 - 2.a Të ardhura - Financime publike
 - 2.b Të ardhura monetare - Financime jopublike
 - 2.c Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike
 - 2.d Të ardhura të krijuara nga vetë partia politike - Financime jopublike
3. Huatë dhe Kreditë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

4. Shpenzimet e partisë
 - 5.a Raportet e kandidatëve të listave shumëmemërore
 6. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)
- Çdo seksion i formularit tip shpjegohet më poshtë.

Çdo seksion i formularit tip shpjegohet më poshtë.

Pjesa 1: Përmbledhje financiare

Informacioni i kërkuar në pjesën 1 identifikon partinë politike dhe personin përgjegjës të financave për atë parti politike.

Figure 1

Shifrat që shfaqen në përmbledhjen financiare përlllogariten në mënyrë *automatike* mbi bazën e të dhënave që vendosen në pjesë të tjera të formularit tip. *Nuk është e nevojshme që shifrat në këtë seksion të hidhen në mënyrë manuale.*

Përgjegjësi i financës dhe personi që e miraton, duke venë emrat e tyre në kutizën e nënshkrimit, konfirmojnë vërtetësinë e informacionit të dhënë në raport. Bërja e një deklaratë të rreme, jo të plotë ose të pasaktë, sjell pasoja ligjore.

Pjesa 2a: Të ardhura – Fonde Publike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË □
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

2.a Të ardhura - Financime publike

Shuma e fondeve publike të përfituara në përputhje me nenet 88 dhe 89 të Kodit Zgjedhor

- a Fondi i marrë nga Buxheti i Shtetit (sipas nenit 88)
Data e marrjes së fondit nga Buxheti i Shtetit
Diferenca e kthyer (nëse ka, sipas nenit 88, pika 7)
Data e kthimit të diferencës
- b Kompensimi financiar paszgjedhor (neni 89)
Data e marrjes së kompensimit financiar paszgjedhor

FINANCIERI

Emër Mblimër Firmë

APROVUESI

Emër Mblimër Firmë

Kjo është pjesa ku partia politike regjistron shumën e fondeve publike të marra në lidhje me fushatën zgjedhore.

Seksioni 2b: Të ardhura monetare - Financime jopublike (Private)

Formulari tip do t'ju ndihmojë të jepni të gjithë informacionin që duhet të raportohet në lidhje me dhurimet monetare jo-publike (private), që janë dhurime të marra në formën e të hollave, çeqeve, transferimeve bankare apo me anë të kartave të kreditit (por jo në formën e të mirave materiale apo shërbimeve, për këtë shih seksionin 2c). Të gjitha dhurimet monetare duhet të evidentohen në një zë të veçantë. Dhurimet monetare të bëra në monedhë të huaj duhet të raportohen me kundërvlerën e barabartë në monedhën vendase lekë, në bazë të vlerës sipas kursit të këmbimit në ditën që është bërë konvertimi. Për shembull ju mund të përdorni kursin e këmbimit të bankës tuaj për të reflektuar konvertimin. Për këtë qëllim ju duhet të mbani kopje të faturave që vërtetojnë kryerjen e një këmbimi valutator me kursin e caktuar.

Nëse nuk keni marrë dhurime monetare lidhur me fushatën zgjedhore, ju lutemi zgjidhni alternativën “Konfirmoj se nuk kam zëra për të raportuar” në të djathtë të kuadratisë që thotë “Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar - Të ardhura monetare – Financime jopublike” dhe procedoni më tej me seksionin vijues të këtij formulari.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike Shkronjat Nisore

2.b Të ardhura monetare - Financime jopublike

Ju lutemi konfirmont nëse nuk keni gjë për të raportuar
2.b Të ardhura monetare - Financime jopublike

A. Statusi i dhuruesit B. Emri i dhuruesit C. Mbiemri i dhuruesit D. Adresa (rreshti 1) E. Adresa (rreshti 2) F. Kodi postar i adresës G. ID / NIPT H. Shuma e dhurimit I. Data e dhurimit J. Totali i agreguar i dhurimeve nga dhuruesit për zgjedhjet K. Metoda e dhurimit L. Kodi bankar i llogaritë në të cilën u depozitua dhurimi M. Numri i llogaritë në të cilën u depozitua dhurimi dorëzim nga: N. Mamtë në deqit O. Emri i deqit

ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -
ALL -

FINANCIERI APROVUESI
Emri Mbiemri Firmë Emri Mbiemri Firmë

Kolona	Emërtimi Kolonës	i Informacioni që duhet dhënë
A	Statusi i Dhuruesit	Evidentoni statusin e dhuruesit – menuja që hapet me klikim do t’ju lejojë të zgjidhni person fizik ose juridik
B	Emri i Dhuruesit	Jepni emrin e personit fizik që ka bërë dhurimin. Nëse dhuruesi është person juridik, jepni emrin e personit juridik
C	Mbiemri i Dhuruesit	Jepni mbiemrin e personit fizik që ka bërë dhurimin. Nëse dhuruesi është person juridik, lëreni këtë kolonë bosh.
D	Adresa, rreshti 1	Jepni emrin e rrugës dhe numrin ose informacionet e tjera të dhuruesit (adresa e banesës për persona fizikë, adresa e zyrës për persona juridikë)
E	Adresa, rreshti 2	Jepni detaje shtesë të adresës së dhuruesit nëse ka.
F	Kodi postar i adresës	Jepni kodin postar të dhuruesit
G	ID/Nipt	Jepni numrin personal të identifikimit të personit fizik ose juridik që ka bërë dhurimin apo Niptin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

H	Shuma e dhurimit	Jepni vlerën e dhurimit në Lek.
I	Data e dhurimit	Jepni datën kur është marrë dhurimi.
J	Totali i agreguar i dhurimeve nga dhuruesi për zgjedhjet	Vlera totale të dhurimeve monetare të mara deri tani nga dhuruesi në fjalë, përfshirë vlerën e dhurimit që po regjistrohet do të shfaqet automatikisht në këtë zë.
K	Metoda e dhurimit	Zgjidhni nga lista që hapet me klikim mënyrën e marrjes së dhurimit si “para në dorë/cash”, “çek”, “transfertë bankare”, ose “kartë krediti”
L	Kodi bankar i llogarisë në të cilën është depozituar dhurimi	Vendosni kodin e llogarisë bankare në të cilën është depozituar dhurimi.
M	Numri i llogarisë në të cilën është depozituar dhurimi	Vendosni numrin e llogarisë në të cilën është depozituar dhurimi
N	Marrë në dorëzim nga	Përzgjidhni nga menuja se nga kush është marrë në dorëzim dhurimi si p.sh. “Selia Qendrore, Dega (apo ndonjë nën-strukturë lokale)
O	Emri i degës	Nëse dhurimi është marrë nga një degë e partisë, vendosni emrin këtu.

Seksioni 2c: Të ardhura nga dhurimet në natyrë - Financime jo-publike (private)



REPUBLICA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Ky seksion duhet të përdoret për të dhënë informacion mbi dhurimet e marra në formën e të mirave materiale ose shërbimeve të dhëna ose ofruara pa pagesë ose me vlerë më të ulët se ajo e tregut, pa përfshirë dhurimet monetare (shih seksionin 2c). Siç u përmend më lart, shërbimet e rregullta vullnetare nuk klasifikohen si dhurime në natyrë dhe nuk duhet të regjistrohen në këtë formular. Çdo dhurim duhet të jepet në një zë të veçantë. Lutemi t’i referoheni shembujve 1-8 të këtij udhëzimi dhe seksionit 2c të formularit tip të bashkëlidhur.

Nëse nuk keni marrë dhurime në natyrë në lidhje me fushatën zgjedhore, ju lutemi zgjidhni alternativën “Konfirmoj që nuk kemi zëra për të raportuar” në të djathtë të kuadtratit që thotë “Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar – Të ardhura – Dhurime në natyrë – Financime jopublike” dhe kaloni në seksionin tjetër të këtij formulari.

REPUBLICA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike _____ Shkronjat Nistore _____

2.c Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 2.c
Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike

A. Statusi i dhuruesit	B. Emri i dhuruesit	C. Mbledhja e dhuruesit	D. Adresa (treshit 1)	E. Adresa (treshit 2)	F. Kodi postar i adresës	G. ID / NIPT	H. Vlera e dhurimit	I. Data e dhurimit	J. Totali i agreguar i dhurimeve nga dhuruesi për zgjedhjet	K. Marrë në konsiderim nga:	L. Emri i degës	M. Përshkrimi i dhurimit në natyrë
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		
									ALL	-		

FINANCIERI

Emër Mbledhje Firmë

APROVUESI

Emër Mbledhje Firmë

Kolona	Emërtimi Kolonës	i Informacioni që duhet dhënë
A	Statusi i dhuruesit	Evidentoni statusin e dhuruesit – menuja që hapet me klikim do t’ju lejojë të zgjidhni person fizik ose juridik
B	Emri i dhuruesit	Jepni emrin e personit fizik që ka bërë dhurimin. Nëse dhuruesi është person juridik, jepni emrin e personit juridik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

C	Mbiemri i dhuruesit	Jepni mbiemrin e personit fizik që ka bërë dhurimin. Nëse dhuruesi është person juridik, lëreni këtë kolonë bosh.
D	Adresa, rreshti 1	Jepni emrin e rrugës dhe numrin ose informacionet e tjera të dhuruesit (adresa e banesës për persona fizikë, adresa e zyrës për persona juridikë)
E	Adresa, rreshti 2	Jepni detaje shtesë të adresës së dhuruesit.
F	Kodi postar i adresës	Jepni kodin postar të dhuruesit
G	ID / Nipt	Jepni numrin personal të identifikimit të personit fizik ose juridik që ka bërë dhurimin apo Nipt-in
H	Vlera e dhurimit	Përcaktoni vlerën monetare të dhurimit, duke përdorur vlerën aktuale të tregut (për çfarë vlere mund të shitet artikulli nëse ofrohet në treg në kushtet e tij aktuale).
I	Data e dhurimit	Jepni datën në të cilën është marrë dhurimi.
J	Totali i agreguar i dhurimeve nga dhuruesi për zgjedhjet	Vlera totale e dhurimeve monetare të mara deri tani nga dhuruesi në fjalë, përfshirë vlerën e dhurimit që po regjistrohet do të shfaqet automatikisht në këtë zë
K	Marrë në dorëzim nga:	Zgjidhni nga lista që hapet me klikim nga kush është marrë dhurimi, si “Selia (selia e partisë)”, ose “dega/qarku” (çdo strukturë nën-kombëtare e partisë).
L	Emri i degës/qarkut	Nëse dhurimi është marrë nga një degë ose qark i partisë, vendosni emrin këtu.
M	Përshkrimi i dhurimit në natyrë	Jepni detaje mbi formën e dhurimit – të mirat materiale ose shërbimet e mara dhe kushtet.

Seksioni 2d: Të ardhura të krijuara nga vetë partia– Financime jopublike (private)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Partitë politike lejohen sipas ligjit të përdorin pronat dhe ambientet e tyre për disa lloje veprimtarish shoqërore/ekonomike si botime, shtypshkronja dhe qëllime qiradhënie. Ato mund të mbledhin edhe tarifën e anëtarësisë nga anëtarët e partisë. Një parti politike mund të përdorë të ardhurat e përfituara nga këto veprimtari për financimin e fushatës zgjedhore. Çdo zë i financimit nga burime vetjake të partisë politike/subjektit zgjedhor duhet të shënohet në një zë të veçantë në këtë seksion.

Nëse nuk keni të ardhura të krijuara nga vetë partia/subjekti për fushatën zgjedhore, ju lutemi zgjidhni alternativën “Konfirmoj që nuk kemi zëra për të raportuar” në të djathtë të kuadratit që thotë “Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar – Të ardhura të krijuara nga vetë subjekti – Financime jopublike” dhe kaloni në seksionin tjetër të këtij formulari.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

2.d Të ardhura të krijuara nga vetë subjekti - Financime jopublike

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 2.d Të ardhura të krijuara nga vetë subjekti - Financime jopublike

A. Aktiviteti nga i cili keni krijuar të ardhura

B. Shuma e të ardhurave

C. Data në të cilën janë depozituar të ardhurat

D. Kodi bankar i llogarisë në të cilën janë depozituar të ardhurat

E. Numri i llogarisë në të cilën janë depozituar të ardhurat

F. Të ardhura të krijuara nga:

G. Emri i degës (nëse është i aplikueshëm)

H. Përshkrimi

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë

Kolona Emërtimi i Informacioni që duhet dhënë Kolonës

- | | | |
|---|---|--|
| A | Aktiviteti nga i cili keni krijuar të ardhura | Zgjidhni nga lista që hapet me klikim llojin e aktivitetit që krijon të ardhura, si p.sh. “shtypshkronjë”, “shitje botimesh”, “qiradhënie”, “interes bankar” “kuotat e anëtarësisë”, “llogaria ekzistuese e partisë” ose “tjetër”. Nëse shënimi është “tjetër”, ju lutemi jepni detaje në kolonën F. |
| B | Shuma e të ardhurave | Jepni shumën e të ardhurave të marra. |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

- | | | |
|---|---|---|
| C | Data në të cilën janë depozituar të ardhurat | Jepni datën kur të ardhurat janë depozituar në llogarinë bankare |
| D | Kodi bankar i llogarisë në të cilën janë depozituar të ardhurat | Fusni kodin e llogarisë së bankës në të cilën janë depozituar të ardhurat. |
| E | Numri i llogarisë në të cilën janë depozituar të ardhurat | Fusni numrin e llogarisë në të cilën janë depozituar të ardhurat. |
| F | Të ardhura të krijuara nga: | Zgjidhni nga lista që hapet me klikim nga kush është krijuar kjo e ardhur, si “Selia (selia e partisë)”, “dega” (çdo strukturë nën-kombëtare e partisë) |
| G | Emri i degës (nëse është i aplikueshëm) | Nëse të ardhurat janë marrë nga një degë e partisë, jepni emrin këtu. Nëse e ardhura është marrë nga Selia e partisë, lëreni bosh. |
| H | Përshkrimi | Jepni detaje mbi të ardhurat nga burime vetjake të subjektit |

Shembull:

Partia Politike/subjekti zgjedhor A krijon të ardhura nga dhënia me qira e zyrave të saj për aktivitete të veçanta. Dega e partisë/subjektit në një qytet të caktuar boton fletëpalosje të programit të partisë/subjektit, që shiten në takimet e partisë/subjektit të organizuara në të gjithë vendin. Gjatë fushatës, të ardhurat nga këto burime i dhurohen fushatës zgjedhore. Këto të dhëna tregohen si në Tabelën 2d të modelit të raportit si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

2d. Të ardhura të krijuara nga vetë subjekti - Financime jopublike						
1	Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 2d. Të ardhura të krijuara nga vetë subjekti - Financime jopublike			Te dhënat e mëposhtme		
2	A. Aktiviteti nga i cili keni krijuar të ardhura	B. Shuma e të ardhurave	C. Data në të cilën janë depozituar të ardhurat	D. Kodi bankar i llogarisë në të cilën janë depozituar të ardhurat	E. Numri i llogarisë në të cilën janë depozituar të ardhurat	F. Të ardhura të krijuara nga:
3						G. Emri i degës aplikueshëm)
4	Dhënia me qera	ALL 12 000,00	11.4.2017	1122334455	123456789	Zyra qendrore
5	Shitja e publikimeve	ALL 5 000,00	8.3.2017	9988776655	123456789	Dega <input type="text"/>

Seksioni 3: Huatë dhe kreditë

Huatë dhe kreditë përbëjnë llojin e fundit të financimit që do të regjistrohet në model. Ka një seksion i cili i kushtohet kredive, që kërkon identitetin e huadhënësit dhe detajet që lidhen me kredinë ose linjën e kredisë.³⁵

Nëse nuk keni marrë hua apo kredi për fushatën zgjedhore, ju lutemi zgjidhni alternativën “Konfirmoj që nuk kemi zëra për të raportuar” në të djathtë të kuadrantit që thotë “Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar – Huatë dhe kreditë e tjera” dhe kaloni në seksionin tjetër të këtij formulari.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shënime tjera

3. Huatë dhe Kreditë

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 3. Huatë dhe Kreditë

										Tërmat	
A. Emri i Huadhënësit	B. Statusi i huadhënësit	C. Adresa e huadhënësit (rrethi 1)	D. Adresa e huadhënësit (postei 2)	E. Kodi postar i huadhënësit	F. Numri i identifikimit i huadhënësit	G. Numri i referencës së huadhënësit	H. Shuma e huadhënësit i shprehur	I. Data e fillimit të huadhënësit	J. Norma e interesit	K. Data e afatit të huadhënësit	L. Vlerësimi i dhuruar

FINANCIERI

APROVUESI

Kolona Emërtimi i Informacioni që duhet dhënë Kolonës

³⁵Një linjë kredie është një shumë e rënë dakord kredie e disponueshme që klienti i bankës mund ta tërheqë në çdo kohë. Për shembull, mund të jetë një formë linjë kredie (overdraft) i ose një llogari e karte krediti, etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

A	Emri i huadhënësit	Jepni emrin e plotë të huadhënësit
B	Statusi i huadhënësit	Evidentoni statusin e huadhënësit – menuja që hapet me klikim do t’ju lejojë të zgjidhni person fizik ose juridik
C	Adresa huadhënësit, rreshti 1	Jepni emrin e rrugës dhe numrin ose informacionet e tjera të huadhënësit (adresa e banesës për persona fizikë, adresa e zyrës për persona juridikë)
D	Adresa huadhënësit, rreshti 2	Jepni detaje shtesë të adresës së huadhënësit.
E	Kodi postar i huadhënësit	Jepni kodin postar të huadhënësit
F	Numri i identifikimit i huadhënësit	Jepni numrin e identifikimit të personit fizik ose juridik që ka dhënë huanë ose ka hapur linjën e kredisë.
G	Numri i referencës së huasë/kredisë	Jepni numrin e referencës të dhënë nga huadhënësi për huanë apo linjën e kredisë përkatëse
H	Shuma e huasë/Limiti i kredisë	Jepni vlerën e huasë ose linjës së kredisë
I	Data e fillimit të huasë/kredisë	Jepni datën e fillimit të huasë ose kredisë
J	Norma e interesit	Jepni normën e interesit që është rënë dakord për huanë ose linjën e kredisë
K	Data e shlyerjes	Jepni datën kur duhet të shlyer plotësisht huaja ose linja e kredisë.
L	Kolaterali i ofruar	Zgjidhni “po” ose “jo” nga lista që hapet me klikim, nëse është ofruar kolateral ose jo.

Shembull:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

SZA ka raportuar një kredi prej 75,000 lekë nga Banka më Mirë e Shqipërisë të cilën e ka marrë më 15 Mars 2021 për të mbuluar kostot e fushatës. Marrëveshja e kredisë përcakton një normë interesi prej 2.45% dhe datë shlyerje më 30 gusht 2021. Për kredinë nuk është dhënë kolateral.

3. Huatë dhe borxhet e tjera						
Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 3. Huatë dhe borxhet e tjera						
Të dhënat e mëposhtme						
A. Emri i Huadhënësit	B. Adresa e huadhënësit (rreshti 1)	C. Adresa e huadhënësit (rreshti 2)	D. Kodi postar i huadhënësit	E. Numri i identifikimit i huadhënësit	F. Numri i referencës së huasë/kredisë	G. Shuma e huasë/limiti i kredisë
Banka Më e Mirë e Shqipërisë	Rr. Ismail Qemali			1000 YY11223344ZZ	54215896	ALL 75 000,00

Sesioni për Shpenzimet

Sesioni i shpenzimeve të formularit tip përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë, Seksioni 4a, parashikon raportimin e shpenzimeve në bazë të faturës. Partia Politike/Subjekti zgjedhor do të regjistrojë të gjitha shpenzimet e tij këtu, duke siguruar informacion për çdo faturë të shpenzimeve. Kjo ofron një pasqyrë të detajuar të të gjitha shpenzimeve të fushatës të kryera nga partia politike/subjekti zgjedhor.

Sesioni 6 (Shpenzimet për mitingjet), ka një qëllim më të fokusuar raportimi. Kjo pjesë kërkon që partia politike/subjekti zgjedhor të japë informacion financiar rreth mitingjeve të fushatës, sipas vlerës së shpenzuar për çdo miting. Të gjitha shpenzimet që lidhen me mitingun e caktuar duhet të jepen. Kjo siguron një pasqyrë se sa mund të kushtojë një aktivitet i tillë.

Vetëm shifrat në Sesionin 4 agregohen automatikisht për të nxjerrë shumën totale të shpenzuar nga partia politike/subjekti zgjedhor gjatë fushatës, prandaj në seksionin 6 nuk do të ketë llogaritje të dyfishtë të shpenzimeve.

Të gjitha shpenzimet e kryera në monedhë të huaj duhet të raportohen me kundërvlerën e barabartë në monedhën vendase Lek, në bazë të vlerës sipas kursit të këmbimit në ditën që është bërë konvertimi. Për shembull ju mund të përdorni kursin e këmbimit të bankës tuaj për të reflektuar konvertimin. Për këtë qëllim ju duhet të mbani kopje të faturave që vërtetojnë kryerjen e një këmbimi valutor me kursin e caktuar.

Shpenzimet ndahen në kategori të veçanta:

Mitingje/tubime dhe aktivitete fushate

Tubimet dhe aktivitetet e fushatës përfshijnë mitingjet në ajër të pastër, mbledhje apo takime dhe aktivitete të tjera jashtë dhe brenda. Kostot e zakonshme të lidhura me to janë qiramarrja e ambientit, tarifat për argëtimin, qiramarrja e sistemit të audio/ dritat, materialet specifike të printuara dhe ushqim e pije freskuese. Siç theksohet në Sesionin 6, partitë politike duhet të japin informacion shtesë në lidhje me mitingje të mëdha të fushatës/ për secilin miting.

Materiale promocionale

Kostot e materialeve promocionale lidhen me përgatitjen dhe prodhimin e materialeve për promovimin e fushatës së partisë politike/subjektit zgjedhor. Përfshin kosto për hartimin e mesazheve të fushatës si dhe të gjitha shpenzimet për prodhimin e artikujve si bluza dhe artikuj të tjerë promocionale të fushatës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Media

Shpenzimet për media përfshijnë koston e prodhimit të spoteve televizive dhe radiofonike. Komunikimet në linjë/online mund të përfshihen nën zërin e medias. Shpenzimet për median përfshijnë gjithashtu kostot për blerjen e kohës së transmetimit. Shpenzimet për median përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të kostove të fushatës zgjedhore dhe duhet të jenë të dokumentuara plotësisht, përfshirë informacionin lidhur me datat, kohën dhe kohëzgjatjen e saktë të të gjitha transmetimeve në media.

Mediat sociale

Shpenzimet e mediave sociale do të përfshijnë shpenzimet e bëra për reklamim në platformat e mediave sociale si Facebook, Twitter, etj.

Sondazhe

Në këtë kategori, subjektet zgjedhore zakonisht përfshijnë kostot e hartimit, zbatimit dhe analizimit të rezultateve të sondazheve dhe anketimit të opinionit.

Botime/publikime

Këto shpenzime lidhen me kostot e hasura për qiramarrjen e hapësirave të reklamave dhe prodhimin e fletëpalosjeve dhe materialeve të tjera propagandistike të fushatës.

Transporti

Kostot e transportit përfshijnë kostot e blerjes, qiramarrjes dhe përdorimit të autobusëve, veturave dhe mjeteve të tjera të transportit.

Konsulenca

Këtu do të përfshihen kostot e shërbimeve të konsulencës për zhvillimin e strategjisë së fushatës dhe mesazheve, apo shërbime të tjera profesionale.

Reklamime në natyrë

Kjo kategori do të përfshijë kostot e të gjitha aktiviteteve të zhvilluara jashtë në natyrë, përfshirë këtu kostot për billborde, dritat dhe forma të tjera të aktiviteteve jashtë në natyrë. Gjithsesi, në bazë të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, është e ndaluar vendosja e materialeve propagandistike statike në një distancë më të madhe se pesë metra nga zyrat elektorale të partisë politike/subjektit zgjedhor.

Shpenzime për zyra zgjedhore

Kjo kategori do të përfshijë të gjitha shpenzimet për zyrat zgjedhore të bëra nga partia/subjekti juaj. Përveç koston së qerasë, këtu ju duhet të raportoni edhe për kosto të tjera nëse do të keni, si p.sh. për ujë dhe drita të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

zyrave zgjedhore. Kur të përzgjidhni këtë kategori, sigurohuni që tek kolona “T” të jepni një përshkrim se cilin shpenzim po raportoni dhe gjithashtu tek kolona “L” bashkinë ku ka qenë kjo zyrë zgjedhore për të cilën keni raportuar këtë shpenzim.

Shpenzime administrative

Kjo kategori përfshin pagesat për shërbimet profesionale si ato juridike, kontabilitetit ose të tjera. Gjithashtu mbulon kostot për kancelari shtesë si kompjutera, telefona dhe paga personeli.


Udhëzimet e mëposhtme duhet të ndiqen për të lehtësuar raportimin e shpenzimeve:

- Caktojini çdo faturë një numër unik identifikimi dhe shkruajeni atë në faturë (p.sh. 0001, 0002, 0003 etj.). Regjistroni shpenzimet në model duke përdorur referencën në faturë. Modeli i ndan shpenzimet në një sërë kategorish të veçanta. Nëse një faturë përfshin shpenzime që lidhen me kategori të ndryshme, vendosni kostot përkatëse në kategoritë e duhura.
- Informacione të ngjashme nevojiten për shumicën e kategorive, si p.sh. numrin e faturës, informacionin e shitësit, datën e faturës, vlerën, përshkrimin, datën e pagesës.
 1. Për mitingje/tubime dhe aktivitete fushate, modeli kërkon gjithashtu edhe vendndodhjen, ambientin dhe datën e aktivitetit. Lutemi t’i referoheni Sesionit 6 më poshtë.
 2. Për shpenzimet për media, modeli ofron një menu që hapet me klikim me alternativa për të identifikuar llojin e medias të përfshirë dhe një hapësirë për një përshkrim më të plotë.
- Ndërmjet kategorive të shpenzimeve të përmendura më sipër mund të ketë mbivendosje. Kjo do të thotë se në rastet kur një zë shpenzimi mund të bëjë pjesë në më shumë se një kategori, subjekti zgjedhor duhet të gjykojë vetë se në cilën kategori mund të futet ai zë shpenzimi. Praktika e mirë rekomandon caktimin e kostove në kategoritë ku shkojnë më natyrshëm. Për shembull, shpenzimet për marrjen me qira të një mjeti për transportimin e kandidatëve në një tubim duhet të futet në kategorinë e transportit; tullumbacet duhet të përfshihen në kategorinë e reklamave edhe nëse ato përdoren gjatë një aktiviteti fushate.

Sesioni 4: Shpenzimet e kryera nga partia



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE


 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
 Emri i Partisë Politike _____ Shkronjat Historike _____

4. Shpenzimet e partisë

Ju lutemi konfirmimi nëse nuk keni qej për të raportuar 4. Shpenzimet e partisë

A. Kategoria e shpenzimeve	B. Shitësi/furnizuesi	C. Nr identifikimi ID faturës	D. Data e faturës	E. Data e pagesës	F. Shuma e paguar	G. Shuma e papaguar (nëse ka)	H. Metoda e kryerjes së pagesës	I. Shpjegimi	J. Shpenzimi kryer nga	K. Dega e partisë	L. Spas bashkëve	Shpenzimet e zyrës elektorale		Mitingjet e fushatës		Media		Materialet promovionale/Meclia Sociale/Sondazhet/Publikime dhe reklama/Transport/Reklamime në natyrë/Koncerte etj										
												M. Vendi i mitingut	N. Antiserti	O. Data e mitingut	P. Lloji i medias	R. Përshkrimi	S. Përshkrimi											

FINANCIERI _____ APPROVUESI _____
 Emri Mëmbër Financ _____ Emri Mëmbër Financ _____

Kolona	Emërtimi Kolonës	i Informacioni që duhet dhënë
A	Kategori a e shpenzi meve	Nga lista që hapet me klikim, zgjidhni kategorinë ku futet shpenzimi
B	Shitësi/furnizuesi	Jepni emrin e shitësit ose furnizuesit
C	Numrin ID të faturës	Jepni numrin e ID të dhënë në faturë
D	Data e faturës	Jepni datën në faturë
E	Data e pagesës	Jepni datën kur është paguar fatura
F	Shuma e paguar	Jepni shumën që është paguar
G	Shuma e papaguar (nëse ka)	Nëse ka, jepni shumën e faturës që nuk është paguar akoma
H	Metoda e kryerjes së pagesës	Zgjidhni nga lista që hapet me klikim mënyrën e kryerjes së pagesës si “para në dorë/cash”, “çek”, “transfertë bankare”, ose “kartë krediti”
I	Shpjegimi	Jepni detaje se me çfarë lidhen shpenzimet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

- | | | |
|---|---|---|
| J | Shpenzimi i kryer nga: | Përzgjidhni nga menuja se nga kush është kryer shpenzimi, si p.sh. Selia qendrore, dega/ qarku (apo ndonjë njësi e saj). |
| K | Dega e partisë | Nëse shpenzimi është bërë nga ndonjë degë e partisë, vendosni emrin. Nëse shpenzimi është kryer nga selia qendrore ose kandidati lëreni bosh. |
| O | Shpenzimet e zyrës zgjedhore sipas bashkive | Përzgjidhni nga menuja bashkinë përkatës. |

Plotësoni M-N-O vetëm nëse shpenzimi lidhet me tubimet e fushatës

- | | | |
|---|------------------|--|
| M | Vendi i mitingut | Jepni informacione mbi vendndodhjen (p.sh. qytetin ose bashkinë) ku është mbajtur tubimi/mitingu që lidhet me shpenzimet |
| N | Ambienti | Jepni informacion mbi vendin ose ambientin e saktë ku është zhvilluar tubimi/mitingu me të cilin lidhet shpenzimi |
| O | Data e mitingut | Jepni datën kur është mbajtur tubimi me të cilin është lidhur shpenzimi |

Plotësoni P-R vetëm nëse shpenzimi lidhet me median

- | | | |
|---|----------------|---|
| P | Lloji i medias | Zgjidhni nga lista që hapet me klikim llojin e medias në fjalë, “TV”, “radio”, “shtyp”, ose “internet”. |
| R | Përshkrimi | Jepni detaje për shpenzimin |

Plotësoni S vetëm nëse shpenzimet lidhen me Materialet Promocionale / Mediat sociale/Sondazhet apo Anketimet e Opinioneve Publik/Reklama dhe Botime/Transport

- | | | |
|---|------------|-----------------------------------|
| S | Përshkrimi | Jepni një përshkrim të shpenzimit |
|---|------------|-----------------------------------|



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Sesioni 5a: Të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatëve të listave shumemërore

Ky seksion kërkon që partitë politike/subjektet zgjedhore të japin të ardhurat totale dhe shpenzimet totale të raportuara nga kandidatët përmes formatit të raportimit të miratuar nga KQZ-ja. Shifrat duhet të futen manualisht nga kryefinancieri për secilën bashki. Modeli Excel automatikisht do të llogarisë të dhënat të cilat pastaj do të popullohen në seksionin përmbledhës financiar të tab 1. Të ardhurat e raportuara nga kandidatët do të shtohen automatikisht te shuma totale e të ardhurave. Shpenzimet e raportuara nga kandidatët do të shtohen në automatikisht tek shpenzimet totale të kryera nga partia/subjekti.

Sesioni 6: Shpenzimet për mitingje në fushatë

Kjo pjesë kërkon që subjektet zgjedhore të japin me detaje shpenzimet që lidhen me një tubim/miting të veçantë apo aktivitet tjetër të fushatës. Siç theksohet më lart, këto shpenzime do të raportohen të shoqëruara me faturë, sipas Sesionit 4.

Çdo miting i fushatës, ku marrin pjesë 5,000 pjesëmarrës ose më shumë, duhet të regjistrohet në një rresht në sesionin 6. Në rast se për një miting të caktuar, ju nuk jeni të sigurt nëse kanë marrë pjesë 5,000 veta apo jo, atëherë ju duhet ta konsideroni dhe ta raportoni këtë miting njësoj sikur numri i pjesëmarrësve të ishte 5000 apo më tepër. Nëse më shumë se një faturë lidhet me të njëjtin miting dhe me të njëjtën kategori shpenzimi, vlera e përgjithshme e këtyre faturave duhet të regjistrohet në kolonën C. Nëse një faturë lidhet me më shumë se një nga kategoritë e mëposhtme, shpenzimet duhet të ndahen sipas kategorive për të reflektuar koston që i takon secilës kategori.

Shpenzimet për mitingjet e mëdha duhet të regjistrohen në kategoritë e mëposhtme:

Shpenzime për vendin/ambientin: Këto janë shpenzimet që lidhen me sigurimin dhe përdorimin e hapësirës për mitingun. Këtu mund të përfshihet për shembull një tarifë për marrjen me qira të hapësirës dhe shpenzimet për rrethimin, masat e sigurisë dhe tarifa e pastrimit.

Shpenzime për zbavitje/argëtim: Në këtë kategori përfshihen shpenzime si tarifatat për folës, këngëtarë/muzikantë, etj.

Shpenzime për pajisje: Këto janë shpenzimet e kryera për rregullimin e vendit për ta bërë të përshtatshëm për mitingun e fushatës, dhe këtu përfshihen tarifatat për marrjen me qira të një skene, karrigeve dhe sistemit audio-vizuale, si dhe kostot për operimin e pajisjeve.

Shpenzime për pijet freskuese: Në këtë kategori përfshihen shpenzime si për ushqimin dhe pijet e ofruara në këtë aktivitet.

Shpenzime për reklama/promocion: Kjo kategori përfshin kostot e promovimit të ngjarjes, si dhe kostot e materialeve vizuale dhe materialeve të tjera promovuese të krijuara për ngjarjen.

Shpenzime për transport: Shpenzimet e kryera për transportimin e pajisjeve tek vendi dhe të njerëzve që marrin pjesë në miting do të raportohen si shpenzime transporti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Shpenzime administrative: Shpenzimet që lidhen me telefoninë, mesazhet tekst dhe materialet e përdorura nga vullnetarët do të përfshihen në këtë kategori.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Emri i Partisë Politike

Shkronjat Nistore

6. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 6. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

A. Mitingjet e fushatës

B. Kategoritë e shpenzimeve për mitingje

C. Kostoja

FINANCIERI

Emër Mbiemër Firmë

APROVUESI

Emër Mbiemër Firmë

Kolona	Emërtimi Kolonës	i Informacioni që duhet dhënë
A	Mitingjet e fushatës	Përzgjidh nga menuja mitingun/tubimin e caktuar
B	Kategoritë e shpenzimeve për mitingje	Përzgjidh nga menuja kategorinë e shpenzimit
C	Kostoja	Vendos kostot për secilën kategori të shpenzimeve

Shembull: Miting fushate në kryeqytet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Partia politike/Subjekti zgjedhor A (SZA) ka organizuar një miting të madh në Tiranë për rreth 10,000 mbështetës për hapjen e fushatës së tij. Shpenzimet janë:

- Marrja me qira e fushës sportive ku është mbajtur mitingu / 100,000 lekë
- Marrja me qira e skenës, montimi dhe çmontimi/ 135,000 lekë
- Skenografia dhe skenari- projektimi 270,000 Lekë
- Skenografia dhe skenari- montimi/ çmontimi - 70,000 lekë
- Marrja me qira e pajisjeve audio dhe video 135,000 lekë
- Marrja me qira e gardhit 13,500 lekë
- Siguria, 50 vullnetarë, 50 nëpunës të një agjencie profesioniste 135,000 lekë (përfshirë 30% zbritje të ofruar nga Shoqëria e Sigurisë)
- Protokolli – 50 vullnetarë, zburime reklamuese (bluza, kapele, byzylykë)/ 70,000 lekë
- Fletëpalosje: projektimi, fotografia, shtypja, kopje, printimi 100,000 artikuj / 700,000 lekë
- Flamuj: 2000 artikuj, 70,000 Lekë
- Spot video: kopjimi, regjistrimi, prodhimi në 3 versione / 1,100,000 lekë
- Tribuna/ stenda për vullnetarët, për shpërndarjen e materialeve promovuese- projektimi dhe prodhimi i stendës 30 artikuj / 200,000 Lekë
- Fushata dixhitale /në linjë - FB 27,000 lekë në ditë/10 ditë, TV 7,000 Lekë në ditë/ 10 ditë, projektimi dixhital 70,000 lekë
- Kosto telefonie + sms – për të marrë në telefon anëtarë, aktivistë dhe vullnetarë, gazetarë, komunikim pa kufi, dërgimi i 100000 sms – 270,000 lekë;
- Tarifa e folësve 20,000 lekë
- Pijet freskuese 13,500 lekë
- Stenda- në të gjitha bashkitë një javë para mitingut të kryeqytetit, çdo ditë 61 x 5 vullnetarë - 305 vullnetarë në ditë (çmimi i komunikimit me vullnetarët dhe trajnimi i tyre - 150,000 lekë;
- Materialet promovuese- kapele, kapëse, këmisha, byzylykë - 250,000 lekë;
- Marrja me qira e autobusit (50 autobusë) për të sjellë aktivistët / përkrahësit nga qytete të tjera - 1,350,000 lekë;
- Pastrim vendi pas mitingut – shoqëri pastrimi 70,000 lekë

Këto do të regjistrohen në kategoritë e mëposhtme:

Shpenzimet për vendin/ambientin:

- Marrja me qira e fushës sportive ku është mbajtur mitingu / 100,000 lekë
- Marrja e gardhit 13,500 lekë
- Siguria, 50 vullnetarë, 50 nëpunës të një agjencie profesioniste 135,000 lekë (përfshirë 30% zbritje të ofruar nga Shoqëria e Sigurisë)
- Pastrim vendi pas mitingut – shoqëri pastrimi 70,000 lekë

Shpenzimet për zbavitje/argëtim

- Tarifa e folësve 20,000 lekë

Shpenzime për pajisje:

- Marrja me qira e skenës, montimi dhe çmontimi/ 135000 lekë
- Marrja me qira e pajisjeve audio dhe video / 135000 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Tribuna/ stenda për vullnetarët, për shpërndarjen e materialeve promovuese- projektimi dhe prodhimi i stendës 30 artikuj/ 200,000 lekë

Shpenzimet për pijet freskuese:

Pijet freskuese 13,500 lekë

Shpenzime për reklama/promocion:

Skenografia dhe skenari- projektimi 270,000 lekë

Skenografia dhe skenari- montimi/ çmontimi - 70 000 lekë

Fletëpalosje: projektimi, fotografia, shtypja, kopje, printimi 100,000 artikuj / 700,000 lekë

Flamuj: 2000 artikuj, 70,000 lekë

Spot video: kopjimi, regjistrimi, prodhimi në 3 versione / 1,100,000 lekë

Fushata dixhitale /në linjë - FB 27,000 lekë në ditë/10 ditë, TV 7,000 lekë në ditë/ 10 ditë, projektimi dixhital 70,000 lekë

Stenda- në të gjitha bashkitë një javë para mitingut të kryeqytetit, çdo ditë 61 x 5 vullnetarë - 305 vullnetarë në ditë (çmimi i komunikimit me vullnetarët dhe trajnimi i tyre - 150,000 lekë;

Materialet promovuese - kapele, kapëse, këmisha, byzylykë - 250,000 lekë;

Shpenzime për transport:

Marrja me qira e autobusit (50 autobusë) për të sjellë aktivistët / përkrahësit nga qytete të tjera - 1,350,000 Lekë;

Shpenzime administrative:

Protokolli – 50 vullnetarë, zburime reklamuese (bluza, kapele, byzylykë)/ 70,000 lekë;

Kosto telefonie + sms – për të marrë në telefon anëtarë, aktivistë dhe vullnetarë, gazetarë, komunikim pa kufi, dërgimi i 100000 sms – 270,000 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

**“UDHËZUES PËR MËNYRËN E RAPORTIMIT FINANCIAR PËR KANDIDATËT E LISTAVE
SHUMEMËRORE PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR KUVEND”**

HYRJE

Partitë politike dhe koalicionet që paraqesin listat e kandidatëve për zgjedhjet për Kuvend ("partitë") i nënshtrohen një kuadri detyrimesh në fushën e financimit të fushatës zgjedhore. Kandidatët e emëruar nga partitë politike ose koalicionet ("kandidatët"), iu nënshtrohen kërkesave të njëjta, për shembull ndalimet për të pranuar donacione nga burime të caktuara, ose për forma të caktuara të fushatës. Për më tepër, në bazë të ligjit, donacionet për kandidatët dhe shpenzimet nga kandidatët duhet të përfshihen në raportin financiar të fushatës zgjedhore të partive/koalicioneve.

Kandidatët e listave shumëmemërore për zgjedhjet për Kuvend duhet të regjistrojnë, dokumentojnë dhe raportojnë financimin e fushatës së tyre duke përdorur një formular tip raportimi të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Ky udhëzues ka për qëllim të shpjegojë aspektet kryesore të kornizës ligjore dhe të ndihmojë kandidatët që të përmbushin detyrimet e raportimit të financimit të fushatës zgjedhore.

Ky udhëzues është i ndarë në dy sesione. Sesioni i parë paraqet një përmbledhje të bazës ligjore dhe kërkesave që rregullojnë financimin e fushatave zgjedhore për kandidatët e listave shumëmemërore¹, ndërsa sesioni i dytë jep udhëzime për plotësimin e formularit tip të raportimit të financimit të fushatës zgjedhore për kandidatët.

Nëse keni pyetje apo ju duhet informacion i mëtejshëm, ju lutemi kontaktoni:

Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 4
Tiranë, Shqipëri
Email: _____

I. Përmbledhje e bazës ligjore mbi detyrimin për raportim financiar të kandidatëve të listave shumëmemërore të zgjedhjeve për Kuvend.

¹ KQZ gjithashtu ka nxjerrë një udhëzues tjetër që detajon mënyrën e raportimit të partive politike në lidhje me financimin e fushatës zgjedhore. Asnjë udhëzues nuk mund të jetë aq gjithëpërfshirës apo të zëvendësojë ligjin, prandaj përdoruesit inkurajohen që të konsultohen me Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të miratuara nga KQZ-ja dhe Ligjin për Partitë Politike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Pse është rregulluar raportimi për financimin e fushatës zgjedhore të kandidatëve të listave shumëpartisore?

Kodi Zgjedhor rregullon financimin e fushatave zgjedhore edhe të kandidatëve të listave shumëpartisore. Ligji gjithashtu përfshin kufizimet në burimet e lejuara të dhurimeve dhe shuma maksimale e lejuar e dhurimeve vlen edhe për dhurimet për kandidatët.

KQZ ka miratuar një akt nënligjor për verifikimin dhe kontrollin e raporteve të financimit të fushatës. Akti nënligjor detyron kandidatët të raportojnë të ardhurat dhe shpenzimet tek kryefinancieri në selinë qendrore të partisë së tyre politike apo tek kryefinancieri i partisë udhëheqëse në rastin e koalicioneve brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e zgjedhjeve, në mënyrë që informacioni të integrohet në raportin financiar që partia politike/subjekti zgjedhor paraqet në KQZ.

Cilat janë burimet që lejohen për financimin e fushatës zgjedhore për kandidatët e listave shumëpartisore?

Burimet e financimit të fushatës zgjedhore për kandidatët janë:

- Dhurimet nga burime jo-publike (private);
- Financimi nga burime vetjake të kandidatit;
- Mbështetja financiare nga partia/subjekti²;
- Huatë ose kreditë³.

Ligji përcakton kushtet dhe kufizimet për çdo burim financimi, siç trajtohen më poshtë:

1. Dhurimet nga individë privatë

Për qëllime të financimit të fushatës zgjedhore, kandidatët mund të marrin fonde vetëm nga personat fizikë ose juridikë vendas⁴. Fjala “vendas” në ligj është përdorur si antonim i fjalës “i huaj”, pra ka lidhje me shtetësinë e personit dhe jo me vendbanimin e tij. Prandaj termi “person fizik vendas” përfshin edhe shtetas shqiptarë që jetojnë në një vend tjetër⁵. Kjo do të thotë që personat fizikë dhe juridikë të huaj nuk lejohen të dhurojnë për fushatën e kandidatit.

Përveç kësaj, ndalohet dhënia e fondeve nga një person *juridik* vendas nëse personi juridik apo çdo aksionar i tij:

- Ka përfituar fonde publike, kontrata, apo koncesione gjatë 3 (tre) viteve të fundit, të cilat tejkalojnë 10 milionë lekë;
- Ushtron veprimtari në fushën e medias;
- Ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme; ose
- Ka një detyrim financiar kundrejt shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.⁶

²Ky udhëzues përdor përgjithësisht termin "subjekt zgjedhor" duke iu referuar një partie politike apo kandidatëve të propozur nga zgjedhësit që janë regjistruar në KQZ si subjekte zgjedhore në përputhje me Kodin Zgjedhor. Neni 2, pika 20 e Kodit Zgjedhor përkufizon si subjekte zgjedhore “partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit”. Gjithashtu neni 63 i Kodit Zgjedhor ka përcaktime për subjektet zgjedhore. Megjithatë ka raste kur i referohemi atyre si parti politike, aty ku legjislati e përdor këtë term.”

³ Shiko nenin 86, pika ç, e Kodit Zgjedhor.

⁴ Person juridik’ është termi i përdorur nga ligji i cili nënkupton subjektet juridike.

⁵ Shiko nenin 92/1, pika 1 e Kodit Zgjedhor

⁶ Shiko nenin 92/1, pika 3 ç e Kodit Zgjedhor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Përveç ndalimit si më sipër, edhe ato persona fizike apo juridike që nuk kanë përfituar fonde publike, kontrata apo koncesione gjatë 3 (tre) viteve të fundit para zgjedhjeve, por që financojnë partinë politike/subjektet zgjedhore⁷ në fushatë apo kandidatët e tyre, nuk do të mund të përfitojnë për periudhën deri 3 (tre) vite pas zgjedhjeve kontrata publike, kontrata të partneritetit publik privat ose në çdo mënyrë tjetër fonde me vlerën totale që tejkalojnë shumën 10 milionë lekë.

Shuma totale që mund të kontribuojë çdo donator është e kufizuar në 1 milion lekë (qoftë në para ose në vlerën ekuivalente të një donacioni në natyrë). Çdo dhurim mbi 1 milion lekë është i paligjshëm⁸. Është e rëndësishme të theksohet se kufiri prej 1 milion lekë është shuma totale që një parti/subjekt mund të marrë nga një donator i vetëm qoftë drejtpërdrejt ose qoftë nëpërmjet kandidatëve të saj.

Çdo dhurim monetar mbi 50,000 lekë duhet të derdhet në një llogari të posaçme bankare të hapur për këtë qëllim. Nëse kandidatët nuk kanë hapur llogarinë e posaçme në momentin e regjistrimit, atëherë, nga momenti i hapjes së llogarisë së posaçme për pranimin e dhurimeve, por jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e zgjedhjeve, duhet ta deklarojnë atë menjëherë në KQZ. Çdo donacion më i vogël që dërgohet me transfertë bankare, qoftë edhe më i vogël se 50,000 lekë, duhet gjithashtu të dërgohet në llogarinë bankare të posaçme.

1. *Financimi nga burime vetjake të kandidatit*

Detyrimet e kandidatit, për vetëfinancimin e fushatës së tij, do të zbatohen referuar nenit 92/2 pika 3/1 e ligjit 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar... “Kandidatët e partisë politike ose koalicionit zgjedhor të regjistruar si subjekt zgjedhor kanë të drejtë të vetëfinancojnë fushatën e tyre deri në shumën 3 milion lekë...”

2. *Mbështetja financiare nga partia/subjekti*

Disa kandidatë mund të marrin ose mbështetje financiare ose mbështetje të një natyre tjetër nga partia e tyre politike/subjekti zgjedhor. Meqenëse kjo mbështetje jepet nga partia politike/subjekti zgjedhor dhe nuk realizohet nga vetë kandidati, atëherë ajo do të regjistrohet, dokumentohet dhe raportohet si shpenzim nga vetë partia politike/subjekti zgjedhor. Si rrjedhojë, kandidatët nuk e kanë për detyrë të raportojnë mbështetjen financiare apo në natyrë nga partia e tyre politike/subjekti zgjedhor, as si donacion, as si shpenzim, në raportin që do të dorëzojnë pranë partisë/subjektit.

3. *Huatë dhe kreditë*

Kreditë janë një formë tjetër e burimit të ligjshëm të financimit për fushatën e kandidatit. Kushtet e kontratës së kredisë do t'i nënshtrohen auditimit si çdo burim tjetër financimi për fushatën zgjedhore dhe shuma e marrë për qëllime të fushatës zgjedhore nëpërmjet kredisë do të llogaritet përkundrejt tavanit të lejueshëm të donacioneve në fushatë. Kandidati do të duhet të sigurojë dokumentacionin mbështetës për secilën hua, përfshirë këstet e pagimit.

4. *Rregullat e tjera që rregullojnë donacionet*

⁷ Këtu e më poshtë termi “Subjekt zgjedhor” janë partitë politike kur konkurojnë më vete apo si pjesë e një koalicioni përfshirë kandidatët e tyre dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. referuar nenit 1 germa “a” të Vendimit nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator.

⁸Shiko nenin 92/1, pika 2 e Kodit Zgjedhor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Ka rregulla të tjera që rregullojnë financimin privat të fushatave zgjedhore:

- Çdo dhurues duhet të nënshkruajë një deklaratë, të miratuar nga Komisioni Rregullator i KQZ-së, duke pohuar se nuk aplikohet asnjë nga kushtet e përjashtimit të dhuruesit nga dhurimi⁹. Donacionet nga donatorët anonimë janë të ndaluara¹⁰. Të gjitha donacionet mbi 50,000 lekë duhet të dhurohen përmes një llogarie të posaçme bankare të deklaruara në KQZ¹¹. Emri i personave që dhurojnë shuma më të mëdha se 50,000 lekë, si dhe vlera përkatëse bëhet publik bashkë me raportin e subjektit zgjedhor¹².

SHËNIM I RËNDËSISHËM

- Përdorimi i burimeve dhe asetëve shtetërore përveçse atyre të lejuara shprehimisht me ligj për të mbështetur partitë politike/subjektet zgjedhore, kandidatët, ose koalicionet në zgjedhje nuk është i lejuar. Ligji gjithashtu ndalon zhvillimin e fushatës zgjedhore në ambiente të institucioneve publike.¹³ Kjo do të thotë se është i ndaluar përdorimi i burimeve të autoriteteve apo institucioneve shtetërore për qëllime të fushatës zgjedhore, duke përfshirë:
 - Asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, si automjetet apo ndërtesat;
 - Burimet njerëzore (punonjësit).

Shembull i përdorimit të paligjshëm të burimeve shtetërore:

- Zhvillimi i fushatës në ambiente të institucioneve publike.
- Përdorimi i automjeteve të institucioneve publike për-transportimin e mbështetësve të partisë/subjektit në një aktivitet fushate.
- Përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore.
- Përdorimi i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhor gjatë orëve të mësimi.
- Premtimi ose ofrimi i përfitimeve për punonjësit e administratës publike ose studentët për të marrë pjesë në aktivitete të lidhura me fushatën zgjedhore jashtë orëve të punës/mësimi ose ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.
- Përfshirja e logove të partive politike/subjektet zgjedhore në faqet e internetit të institucioneve publike.
- Përdorimi i faqeve të internetit / portaleve të institucioneve publike për të promovuar fushatën e një partie politike/subjekti zgjedhor;
- Dhënia ose shpërndarja e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë (p.sh. rritja e pagave, pensioneve etj.)
- Marrja në punë, shkarkimi apo transferimi në detyrë i punonjësve në institucionet publike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, përveç në rrethana specifike.

⁹ Shiko nenin 92/2, pika 1 e Kodit Zgjedhor

¹⁰ Shiko nenin 23/1, pika 3 Ligjit për Partitë Politike

¹¹ Shiko nenin 92/2, pika 3/1 e Kodit Zgjedhor

¹² Shiko nenin 92/6, pika 1 dhe 4 e Kodit Zgjedhor

¹³ Shiko nenet 3 pika 7 dhe neni 78 pika 6 e Kodit Zgjedhor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Çfarë është një dhurim në natyrë?

Disa mbështetës të partisë politike apo kandidatit/eve të tij mund të bëjnë dhurim monetar, për shembull duke transferuar para në llogarinë bankare ose duke i ofruar para fizike (apo siç njihet ndryshe “cash”) partisë politike apo kandidatit/eve të tij. Përkrahës të tjerë mund t'i ofrojnë partisë politike/ subjektit zgjedhor apo kandidatit/eve të tij mallra ose shërbime falas ose me një çmim më të ulët, të cilat quhen ndryshe dhurime në natyrë. Në rast se malli apo shërbimi është ofruar me çmim më të ulët nga çmimi real, atëherë diferenca ndërmjet shumës që një parti politike/subjekt zgjedhor do të paguante me çmim tregu për mallrat apo shërbimet dhe çmimit që ka paguar realisht do të konsiderohet si dhurim në natyrë. Dhurimet, qofshin këto në para ose në natyrë, i nënshtrohen të njëjtave rregulla. Dhurimet mund të ofrohen nga dhuruesit e lejuar deri në shumën 1 milion lekë dhe bëhen publike nëse shuma e përgjithshme nga një dhurues tejkalon vlerën 50,000 lekë. Deklaratat e dhuruesve mbahen si për dhurimet në para ashtu edhe për ato në natyrë. Vlen të theksohet se tavani i dhurimit për një dhurues të vetëm përfshin shumën e të gjitha donacioneve të bëra për partinë/subjektin apo kandidatët e saj.

Si ndryshojnë dhurimet në natyrë nga puna vullnetare?

Kur dikush ofron kohën e tij/saj pa pagesë për të ndihmuar në fushatën zgjedhore (p.sh. duke shpërndarë fletushka), ky është "*aktivitet vullnetar*" dhe jo "*dhurim në natyrë*". Ai nuk do të përfshihet në raportin e financimit të fushatës zgjedhore të kandidatit. Nëse shërbimet nuk ofrohen sipas kushteve të tregut dhe as në formë vullnetare, atëherë këto konsiderohen dhurime në natyrë dhe si të tilla duhet të kostohen dhe regjistrohen. Për të kuptuar më mirë dallimin ndërmjet aktivitetit vullnetar dhe dhurimit në natyrë po japim disa shembuj të tjerë:

- Vendosja në dispozicion e mjediseve tregtare për zyra zgjedhore apo për zhvillim mbledhjeje është dhurim në natyrë, ndërsa hapja e dyerve të shtëpisë për takime fushate me komunitetin është aktivitet vullnetar;
- Vendosja në dispozicion të fushatës e automjetit personal për transportin e aktivistëve është aktivitet vullnetar, kurse vendosja e mjeteve të kompanisë, e mjeteve taksit apo e autobuzëve është donacion.
- Marrja apo përdorimi i mallrave (të tilla si kompjuterat) pa pagesë ose me një vlerë të ndryshme nga tregu, do të konsiderohet gjithmonë si dhurim në natyrë dhe jo si veprimtari vullnetare.

Si të vlerësoni një dhurim në natyrë?

Kur kandidati merr një dhurim në natyrë, mund të lindin pyetje se si do të bëhet përlllogaritja e vlerës që ka në para, përgjigja mund të trajtohet si më poshtë: Sa do të kishte paguar partia politike/ subjekti zgjedhor për mallrat ose shërbimet nëse do t'i kishte blerë me çmimin e tregut? Vlera e dhurimit në natyrë është diferenca ndërmjet vlerës së tregut me shumën e paguar (nëse ka).

$$\text{(Vlera e tregut)} - \text{(Vlera e paguar)} = \text{Dhurim në natyrë}$$

Për të bërë sa më të lehtë raportimin dhe vlerësimin e dhurimeve në natyrë, do të zbatohen rregullat e mëposhtme. Në rastin kur kandidatit i janë ofruar:

- a) mallra dhe/ose shërbime falas ato do të vlerësohen me çmimin e tregut dhe do të raportohen;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

- b) mallra dhe/ose shërbime me një çmim që është të paktën 10% më i ulët se çmimi i tregut, atëherë diferenca prej 10% apo më shumë (sipas rastit) do të raportohet si donacion;
- c) edhe në rastet kur diferenca midis çmimit të tregut dhe çmimit të ofruar është më pak se 10% e vlerës por më e madhe se 50 mijë lekë, vlera duhet të raportohet si dhurim. (shihni shembullin 3 më poshtë)

Çmimi i tregut për mallra dhe shërbime do të përcaktohet me një nga metodat e mëposhtme:

Nëse është e mundur, duke iu referuar indeksit mujor të çmimeve, të publikuara nga INSTAT, në kohën kur mallrat/shërbimet janë ofruar.

Nëse furnitori operon në biznesin e ofrimit të këtyre të mallrave dhe shërbimeve, çmimi i tregut do të jetë vlera normale tregtare që aplikon furnitori për to, ose;

Partia politike/Subjekti zgjedhor llogarit çmimin e tregut mbi bazën e mesatares së çmimeve të ofruara nga tre ofrues mallrash/shërbimesh të ngjashme.

Shembull 1

Një kandidat kërkon të marrë me qira pajisje audio-vizuale për mitingun e hapjes së fushatës zgjedhore në Tiranë. Shoqëria “Shiko dhe Dëgjo” është ofruar t’i japë pajisjet për këtë organizim me një kosto prej 135,000 lekë. Normalisht, kjo shoqëri do të kërkonte 165,000 lekë për një shërbim të tillë, por administratori i shoqërisë “Shiko dhe Dëgjo” ka dëshirë të mbështesë kandidatin.

Në këtë rast, kandidati duhet të raportojë një dhurim në natyrë prej 30,000 lekë nga shoqëria “Shiko dhe Dëgjo” në raportin e tij në seksionin 2b të formularit tip. Kjo sepse shuma e zbritjes është më shumë se 10% e çmimit normal. Ky dhurim prej 30,000 lekësh llogaritet automatikisht si shpenzim nga formati tip i raportimit, rrjedhimisht do konsiderohet si një shpenzim i vetë partisë/subjektit tuaj.

Shembull 2:

Shoqëria "Karrige me Mbështetëse" i jep kandidatin 100 karrige për t’i përdorur gjatë takimeve të fushatës për një periudhë dy javore. Shoqëria normalisht do të kërkonte 75,000 lekë qira për këtë lloj shërbimi.

Në qoftë se kandidati A nuk paguan për këtë shërbim, atëherë ky dhurim në natyrë në vlerën 75,000 lekë duhet të regjistrohet. Kandidati A mund t’i referohet INSTAT-it për të parë nëse ka një çmim reference të caktuar. Nëse shoqëria “Karrige me Mbështetëse” vetëm shet karrige dhe zakonisht nuk i jep ato me qira, atëherë Kandidati duhet të marrë normën e çmimeve nga tre shoqëri që ofrojnë shërbimin e dhënies së karrigeve me qira. Mesatarja e tri ofertave do të raportohet si shuma e dhurimit në natyrë.

Shembull 3:

Mega Media është një shoqëri që operon në sektorin e reklamave. Zakonisht, kjo shoqëri merr 1,500,000 lekë për prodhimin e reklamave të fushatës zgjedhore në televizion dhe radio. Megjithatë, ajo i ofron kandidatin një zbritje prej 5% (një zbritje çmimi prej 75,000 lekë) për të prodhuar reklamata televizive dhe në radio të kandidatin, e kështu i faturon kandidatin vetëm vlerën prej 1,425,000 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Kandidati duhet të raportojë një dhurim në natyrë prej 75,000 lekë nga Mega Media në seksionin 2b të raportit të vet, sepse vlera e zbritur është më e lartë se 50,000 lekë, pavarësisht se është më pak se 10% e çmimit të tregut.

Si raportohen dhurimet në natyrë?

Dhurimet në natyrë raportohen si dhuratë për fushatën dhe njëkohësisht llogariten edhe si shpenzim i fushatës. Kufiri prej 1 milion lekë i dhurimeve nga një dhurues i vetëm përfshin edhe dhurimet në natyrë.

Kandidati do t'i regjistrojë dhurimet në natyrë duke plotësuar informacionin e kërkuar për raportimin e dhurimeve në natyrë në sesionin 2b të formularit tip të raportimit (dhurimet jo-publike në natyrë). Pasi të futen këto të dhëna në formularin tip në Excel ata do të përlllogariten automatikisht tek shuma totale që paraqitet në pjesën përmbledhëse financiare (Pjesa B e Tabelës 1, Përmbledhje Financiare) për shpenzimet indirekte.

Shembull 4:

Z. Luan është një mik i vjetër dhe mbështetës i madh i kandidatit që i përket partisë politike/subjektit zgjedhor A (SZA). Përveç një dhurimi që z. Luan i jep partisë/subjektit SZA, ai i jep gjithashtu kandidatit një donacion prej 60,000 lekësh. Gjatë fushatës, z. Luan shpërndan fletushka në lagjen e tij. Ai gjithashtu pajton dikë me kontratë shërbimi që të ndihmojë fushatën me kryerjen e telefonatave. Z. Luan e paguan këtë person me 20,000 lekë:

Partia/subjekti do të raportojë donacionin monetar që ka marrë nga z. Luan;

Kandidati do të duhet të përfshijë në raportin e financimit të fushatës së tij 60,000 lekë dhurim në para dhe 20,000 lekë donacion në natyrë të dhënë nga z. Luan për pagesën që i ka bërë personit që është marrë me telefonatat;

Asgjë nuk duhet të raportohet për kohën që z. Luan shpenzon për shpërndarjen e fletushkave pasi kjo do të kualifikohet si aktivitet vullnetar.

Shembull 5:

Kompania “Albanian Mega Estate” i ofron hapësirë falas për zyra kandidatit 60 ditë para ditës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve. Pagesa normale e qirasë për këtë hapësirë do të ishte 150,000 lekë në muaj.

Kompania “Albanian Mega Estate” ka ofruar një kontribut në natyrë prej 300.000 lekë për kandidatin për periudhën parazgjedhore (qiraja të cilën kandidati do ta kishte paguar me çmim tregu për periudhën në fjalë), e cila duhet të raportohet në raportin financiar të fushatës zgjedhore si dhurim në natyrë.

Shembull 6:

Një biznesmen dhe mbështetës i kandidatit të partisë/subjektit SZA, shpenzon direkt nga vetja një shumë prej 2.5 milion lekë për të paguar për një miting fushate për kandidatin e partisë/subjektit SZA.

Personi në fjalë ka dhënë një kontribut në natyrë prej 2.5 milion lekë, por ka kaluar pragun prej 1 milion lekë pasi dhurimet që mund të bëjë një donator i vetëm janë kufizuar deri në 1 milion lekë. Në këtë rast kemi një



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

kontribut të paligjshëm prej 1.5 milion lekë. Kandidati nuk duhet të pranonte një donacion në para, apo kundërvlerën në sende apo shërbime që e kalojnë vlerën 1 milion lekë.

Çfarë hapash duhet të marrë një kandidat në lidhje me fondet e grumbulluara në fushatë?

Kandidatët duhet të:

- regjistrojnë të gjitha donacionet e pranuar;
- sigurojnë që të gjitha donacionet në natyrë të vlerësohen dhe regjistrohen siç duhet;
- mbajnë dokumente origjinale dhe kopjet e të gjithë dokumentacionit mbështetës në lidhje me të ardhurat e fushatës të mbledhura qoftë monetare apo në natyrë;
- mbajnë kopjet e të gjitha formularëve të deklarimit të donatorëve;
- pranojnë vetëm donacione nga burime të identifikueshme dhe të lejueshme;
- pranojnë donacionet që tejkalojnë 50,000 lekë vetëm nëpërmjet llogarisë apo llogarive të posaçme bankare të deklaruar në KQZ. Edhe dhurimet nën këtë vlerë, nëse realizohen me derdhje në bankë, ato duhet të derdhen tek llogaria e posaçme e deklaruar. Nëse një kandidat vendos të mos pranojë ndonjë donacion atëherë kandidati nuk e ka detyrim të hapë një llogari të posaçme bankare.

➤ SHËNIM I RËNDËSISHËM

KQZ-ja cakton një numër personash për të monitoruar përmbushjen nga subjektet zgjedhore të detyrimeve në lidhje me financimin e fushatës dhe detyrimeve të tjera që lidhen me përdorimin apo shpërdorimin e burimeve publike. Roli i monitoruesve të fushatës është që të sigurohen që subjektet zgjedhore të respektojnë rregullat e fushatës dhe të raportojnë në KQZ për aktivitetet zgjedhore që do të vëzhgojnë përfshirë edhe aktivitetet e kandidatëve.

Cilat shpenzime duhet të përfshihen si shpenzime të fushatës?

Si shpenzim i fushatës konsiderohet çdo shpenzim që lidhet me fushatën pavarësisht kohës se kur është bërë dhe deri në ditën e zgjedhjeve. Çdo shpenzim gjatë fushatës, pagesa përfundimtare e të cilit shtyhet deri pas zgjedhjeve duhet gjithashtu të regjistrohet.

Cilat raporte duhet të dorëzohen nga kandidatët dhe cili është afati kohor për ta bërë këtë?

Për të ndihmuar kryefinancierin për të dorëzuar raportin e fushatës zgjedhore të partisë/subjektit, KQZ-ja ka miratuar një format tip raportimi të kandidatëve. Kandidati duhet ta plotësojë dhe dorëzojë raportin financiar të fushatës zgjedhore me dokumentat mbështetëse tek kryefinancieri i partisë/subjektit brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e zgjedhjeve. **KQZ gjithashtu mundëson plotësimin e raportit edhe nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar (PERF), e cila gjendet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ky model raportimi paraqitet në detaje në sesionin tjetër.** Raporti i kryefinancierit duhet të dorëzohet në KQZ jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Në rast se një kandidat është pjesë e një liste të mbështetur nga një koalicion partish, atëherë partia përgjegjëse e caktuar brenda koalicionit duhet të raportojë shpenzimet e kandidatit në raportin financiar të fushatës zgjedhore.

Cilat dokumente duhet të ruhen nga kandidatët?

Subjekteve zgjedhore dhe kandidatët e tyre, kanë detyrimin të “vënë në dispozicion të auditit të caktuar nga KQZ-ja çdo informacion, dokumente apo të dhëna që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore”, sipas nenit 92/6, pika 2, të Kodit Zgjedhor¹⁴. Këtu përfshihen:

- Deklaratat e dhuruesve, e miratuar me Vendimin nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator të KQZ-së, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 13, datë 6.4.2021, të Komisionit Rregullator “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”
- Dokumentet që përcaktojnë identitetin e dhuruesit;
- Kopje të çeqeve të marra nga dhuruesit;
- Pasqyra nga llogaritë bankare të kandidatit;
- Faturat e të gjitha shpenzimeve;
- Të gjitha dokumentet e përdorura nga kandidati për të llogaritur vlerësimin e dhurimeve dhe shpenzimeve në natyrë, p.sh. indeksi mujor i çmimeve i publikuar nga INSTAT, kuotat e ofruara nga ofruesit e mallrave/shërbimeve të ngjashme, kopja e tarifave tregtare për mallin/ shërbimin përkatës;
- Pasqyrë e llogarive të partisë politike/subjektit zgjedhor në fillim të fushatës;
- Dokumente që vërtetojnë kryerjen e një këmbimi valutator me kursin e caktuar, të një monedhe të huaj në monedhën vendase apo anasjelltas, me qëllim kryerjen e një pagese apo shlyerjen e një fature, apo nëse apo nëse subjekti merr një dhurim në monedhë të huaj të cilin e konverton në monedhën vendase.

Cilat janë sanksionet për mosrespektimin e ligjit?

Në varësi të natyrës së shkeljes mund të vendosen një numër sanksionesh në lidhje me financimin e fushatës. Neni 173 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

1. Shkelja e dispozitave për financimin e fushatës zgjedhore nga personi përgjegjës i financës dënohet me një gjobë nga 100 000 deri 200 000 lekë.
2. Pengimi ose mosbashkëpunimi i subjektit zgjedhor me audituesin e KQZ-së dënohet me një gjobë nga 2 000 000 deri 3 000 000 lekë. E njëjta shkelje e kryer kundrejt monitoruesit të KQZ-së dënohet me gjobë nga 50 000 deri 100 000 lekë.
3. Mosparaqitja e një raporti financiar për fushatën brenda afatit ligjor dënohet me një gjobë prej 2 000 000 lekësh. Paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja dënohet me gjobë nga 500 000 deri 1 000 000 lekë.
4. Fondet jopublike të përftuara nga një subjekt zgjedhor, identiteti i dhuruesit nuk dihet ose nuk përcaktohet qartësisht, transferohen në llogarinë e KQZ-së. Mos kalimi çon në konfiskimin e fondeve të marra dhe në një gjobë të barabartë me shumën e fondeve të marra.

¹⁴ Për sa i përket shpenzimeve, Neni 92/3, pika 3 e Kodit Zgjedhor, thotë që çdo shpenzim për fushatën zgjedhore duhet të dokumentohet dhe kryhet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

5. Pranimi i fondeve private më vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare, dënohet me një gjobë të barabartë me shumën e dhuruar dhe në kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së.
6. Pranimi i fondeve nga donatorë të ndaluar, siç specifikohet në pikën 3 të nenit 92/1, dënohet me kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së dhe me një gjobë të barabartë me dyfishin e shumës së fondeve të marra.
7. Shkelja e përcaktimeve të bëra në nenin 92/2 të këtij ligji nga dhuruesit ndëshkohet me gjobë deri në 30 për qind të shumës së dhuruar.
8. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme gjatë procesit të verifikimit nga KQZ-ja sipas pikës 6 të nenit 92/6, ndëshkohet me gjobë nga KQZ-ja nga 100 000 lekë deri në 3 000 000 lekë.
9. Shkelja e kufirit maksimal të shpenzimeve nga një subjekt zgjedhor dënohet me një gjobë prej 5 000 000 lekësh ose me një gjobë të barabartë me shumën që ka kaluar kufirin, cilado që është më e lartë.
10. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të gjobës së dhënë në bazë të këtij neni. Gjoha e vënë nga KQZ-ja është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet brenda 30 ditësh nga marrja dijeni për të. KQZ-ja përjashtohet nga detyrimi të parapaguajë taksën apo tarifën për shërbimin përmbartimor.

Gjatë vlerësimit të sanksioneve KQZ do të aplikojë parimin e proporcionalitetit dhe do të marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm.

- a) rrethanat e kryerjes së shkeljes;
- b) rëndësinë e shkeljes;
- c) nëse subjekti zgjedhor është ose jo përsëritës;
- d) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi i subjektit deklarues;
- e) sjellja që ka pasur subjekti zgjedhorë kundrejt rekomandimeve të KQZ-së si dhe niveli i bashkëpunimit gjatë procesit të verifikimit

Neni 90, pika 4 e Kodit Zgjedhor ngarkon me përgjegjësi edhe kandidatët e subjekteve zgjedhore. Referuar nenit të sipërcituar, subjekti zgjedhor mban përgjegjësi sipas këtij ligji për shkeljen e kushteve dhe detyrimeve lidhur me financimin nga ana e kandidatëve të vet, me përjashtim të rastit kur nga hetimi administrativ vërtetohet se subjekti zgjedhor nuk ka pasur mundësi ose, me gjithë përpjekjet e bëra, nuk ka arritur dot të parandalojë ose korrigjojë shkeljen e kryer nga kandidati. Në këtë rast përgjegjësia administrative dhe penaltetet për shkeljen i ngarkohen kandidatit.

Formulari tip i raportimit financiar të fushatës zgjedhore për kandidatët e listave shumemërore.

Të gjithë kandidatët duhet të raportojnë për donacionet dhe shpenzimet e tyre për periudhën e fushatës duke dorëzuar edhe dokumentacion mbështetës. Komisioni Rregullator ka miratuar një formular tip të raportimit, i cili detajon të gjithë informacionin që duhet të ofrohet nga kandidati për subjektin politik/subjektin zgjedhor që përfaqëson.

Modeli, i miratuar me Vendimin nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator të KQZ-së, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 13, datë 6.4.2021, të Komisionit Rregullator “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”, është në formatin Excel. Raporti Excel do t’i dorëzohet kryefinancierit të partisë tuaj ose kryefinancierit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

të partisë udhëheqëse në rastin e koalicioneve në një kopje fizike dhe një kopje elektronike edhe nëpërmjet platformës elektronike të raportimit financiar. Dokumentacioni mbështetës duhet të dorëzohet dorazi.

Formati tip i raportimit ka seksionet e mëposhtme:

1. Përmbledhje financiare
- 2.a Të ardhura monetare - Financime jopublike
- 2.b Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike
- 2.c Huatë dhe Kreditë
3. Shpenzime
4. Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)

Çdo sesion i formularit tip shpjegohet më poshtë.

Pjesa 1: Informacion për kandidatin, përmbledhja financiare dhe deklarata

Informacioni i kërkuar në pjesën 1 identifikon kandidatin dhe personin përgjegjës të financave.

Shifrat që shfaqen në përmbledhjen financiare përlogariten në mënyrë *automatike* mbi bazën e të dhënave që vendosen në pjesë të tjera të formularit tip. *Nuk është e nevojshme që shifrat në këtë sesion të hidhen në mënyrë manuale.*

Përgjegjësi i financës (nëse ka) dhe vetë kandidati vendosin emrat e tyre në kutizën e nënshkrimit, duke konfirmuar vërtetësinë e informacionit të dhënë në raport. Bërja e një deklarate të rreme, jo të plotë ose të pasaktë, sjell pasojë ligjore.

Sesioni 2a: Të ardhura monetare - Financime jopublike (Private)

Formulari tip do t'ju ndihmojë të jepni të gjithë informacionin që duhet të raportohet në lidhje me dhurimet monetare jo-publike (private), që janë dhurime të marra në formën e të hollave, çeqeve, transfertave bankare apo nëpërmjet kartave të kreditit (por jo në formën e të mirave materiale apo shërbimeve, për këtë shih sesionin 2b). Të gjitha dhurimet monetare duhet të evidentohen në një zë të veçantë. Dhurimet monetare të bëra në monedhë të huaj duhet të raportohen me kundërvlerën e barabartë në monedhën vendase lekë, në bazë të vlerës sipas kursit të këmbimit në ditën që është bërë konvertimi. Për shembull ju mund të përdorni kursin e këmbimit të bankës tuaj për të reflektuar konvertimin. Për këtë qëllim ju duhet të mbani kopje të faturave që vërtetojnë kryerjen e një këmbimi valutë me kursin e caktuar.

Nëse nuk keni marrë dhurime monetare lidhur me fushatën zgjedhore, ju lutemi zgjidhni alternativën “Konfirmoj se nuk kam zëra për të raportuar” në të djathtë të kuadrantit që thotë “Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar - Të ardhura monetare – Financime jopublike” dhe procedoni më tej me seksionin vijues të këtij formulari.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Kolona	Emërtimi i Kolonës	i Informacioni që duhet dhënë
A	Statusi i dhuruesit	Evidentoni statusin e dhuruesit – menuja që hapet me klikim do t’ju lejojë të zgjidhni person fizik ose juridik
B	Emri i dhuruesit	Jepni emrin e personit fizik që ka bërë dhurimin. Nëse dhuruesi është person juridik, jepni emrin e personit juridik
C	Mbiemri i dhuruesit	Jepni mbiemrin e personit fizik që ka bërë dhurimin. Nëse dhuruesi është person juridik, lëreni këtë kolonë bosh.
D	Adresa, rreshti 1	Jepni emrin e rrugës dhe numrin ose informacionet e tjera të dhuruesit (adresa e banesës për persona fizikë, adresa e zyrës për persona juridikë)
E	Adresa, rreshti 2	Jepni detaje shtesë të adresës së dhuruesit nëse ka.
F	Kodi postar i adresës	Jepni kodin postar të dhuruesit
G	ID/Nipt	Jepni numrin personal të identifikimit të personit fizik ose juridik që ka bërë dhurimin apo Nipt-in
H	Shuma e dhurimit	Jepni vlerën e dhurimit në Lek.
I	Data e dhurimit	Jepni datën kur është marrë dhurimi.
J	Totali i agreguar i dhurimeve nga dhuruesi për zgjedhjet	Vlera totale të dhurimeve monetare të marra deri tani nga dhuruesi në fjalë, përfshirë vlerën e dhurimit që po regjistrohet do të shfaqet automatikisht në këtë zë.
K	Metoda e dhurimit	Zgjidhni nga lista që hapet me klikim mënyrën e marrjes së dhurimit si “para në dorë/cash”, “çek”, “transfertë bankare”, ose “kartë krediti”
L	Kodi bankar i llogarisë në të cilën është depozituar dhurimi	Vendosni kodin e llogarisë bankare në të cilën është depozituar dhurimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

M Numri i Vendosni numrin e llogarisë në të cilën është depozituar llogarisë në të dhurimi cilën është depozituar dhurimi

Sesioni 2b: Të ardhura nga dhurimet në natyrë - Financime jo-publike (private)

Ky seksion duhet të përdoret për të dhënë informacion mbi dhurimet e marra në formën e të mirave materiale ose shërbimeve të dhëna ose ofruara pa pagesë ose me vlerë më të ulët se ajo e tregut, pa përfshirë dhurimet monetare (shih seksionin 2b). Siç u përmend më lart, shërbimet e rregullta vullnetare nuk klasifikohen si dhurime në natyrë dhe nuk duhet të regjistrohen në këtë formular. Çdo dhurim duhet të jepet në një zë të veçantë. Lutemi t'i referoheni shembujve 1-4 në faqen 6 dhe 7 të këtij udhëzuesi dhe sesionit 2b të formularit tip të bashkëlidhur

Nëse nuk keni marrë dhurime në natyrë në lidhje me fushatën zgjedhore, ju lutemi zgjidhni alternativën “Konfirmoj që nuk kemi zëra për të raportuar” në të djathtë të kuadrantit që thotë “Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar – Të ardhura – Dhurime në natyrë – Financime jopublike” dhe kaloni në seksionin tjetër të këtij formulari.

Kolona	Emërtimi i Kolonës	i Informacioni që duhet dhënë
A	Statusi i dhuruesit	Evidentoni statusin e dhuruesit – menuja që hapet me klikim do t’ju lejojë të zgjidhni person fizik ose juridik
B	Emri i Dhuruesit	Jepni emrin e personit fizik që ka bërë dhurimin. Nëse dhuruesi është person juridik, jepni emrin e personit juridik
C	Mbiemri i Dhuruesit	Jepni mbiemrin e personit fizik që ka bërë dhurimin. Nëse dhuruesi është person juridik, lëreni këtë kolonë bosh.
D	Adresa, rreshti 1	Jepni emrin e rrugës dhe numrin ose informacionet e tjera të dhuruesit (adresa e banesës për persona fizikë, adresa e zyrës për persona juridikë)
E	Adresa, rreshti 2	Jepni detaje shtesë të adresës së dhuruesit.
F	Kodi postar i adresës	Jepni kodin postar të dhuruesit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

G	ID/Nipt	Jepni numrin personal të identifikimit të personit fizik ose juridik që ka bërë dhurimin apo Nipt-in
H	Vlera e dhurimit	Përcaktoni vlerën monetare të dhurimit, duke përdorur vlerën aktuale të tregut (për çfarë vlere mund të shitet artikulli nëse ofrohet në treg në kushtet e tij aktuale).
I	Data e dhurimit	Jepni datën në të cilën është marrë dhurimi.
J	Totali i agreguar i dhurimeve nga dhuruesi për zgjedhjet	Vlera totale e dhurimeve monetare të mara deri tani nga dhuruesi në fjalë, përfshirë vlerën e dhurimit që po regjistrohet do të shfaqet automatikisht në këtë zë
K	Përshkrimi i dhurimit në natyrë	Jepni detaje mbi formën e dhurimit – të mirat materiale ose shërbimet e mara dhe kushtet.

Sesioni 2c: Huatë dhe Kreditë

Huatë përbëjnë llojin e fundit të financimit që do të regjistrohet në formatin tip të raportimit. Ka një seksion i cili i kushtohet huave, që kërkon identitetin e huadhënësit dhe detajet që lidhen me huanë ose linjën e kredisë.¹⁵

Nëse nuk keni marrë hua apo kredi për fushatën zgjedhore, ju lutemi zgjidhni alternativën “Konfirmoj që nuk kemi zëra për të raportuar” në të djathtë të kuadrantit që thotë “Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar – Huatë dhe borxhet e tjera” dhe kaloni në seksionin tjetër të këtij formulari.

Kolona	Emërtimi i Kolonës	i Informacioni që duhet dhënë
A	Emri i huadhënësit	Jepni emrin e plotë të huadhënësit
B	Statusi i huadhënësit	Evidentoni statusin e huadhënësit – menuja që hapet me klikim do t’ju lejojë të zgjidhni person fizik ose juridik

¹⁵Një linjë kredie është një shumë e rënë dakord kredie e disponueshme që klienti i bankës mund ta tërheqë në çdo kohë. Për shembull, mund të jetë një formë linjë kredie (overdraft) i ose një llogari e karte krediti, etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

C	Adresa huadhënësit, rreshti 1	Jepni emrin e rrugës dhe numrin ose informacionet e tjera të huadhënësit (adresa e banesës për persona fizikë, adresa e zyrës për persona juridikë)
D	Adresa huadhënësit, rreshti 2	Jepni detaje shtesë të adresës së huadhënësit.
E	Kodi postar i huadhënësit	Jepni kodin postar të huadhënësit
F	Numri i identifikimit i huadhënësit	Jepni numrin e identifikimit të personit fizik ose juridik që ka dhënë huanë ose ka hapur linjën e kredisë.
G	Numri i Referencës së Huasë/Kredisë	Jepni numrin e referencës të dhënë nga huadhënësi për huanë apo linjën e kredisë përkatëse
H	Shuma e huasë/Limiti i kredisë	Jepni vlerën e huasë ose linjës së kredisë
I	Data e fillimit të huasë/kredisë	Jepni datën e fillimit të huasë ose kredisë
J	Norma e interesit	Jepni normën e interesit që është rënë dakord për huanë ose linjën e kredisë
K	Data e shlyerjes	Jepni datën kur duhet të shlyer plotësisht huaja ose linja e kredisë.
L	Kolaterali i ofruar	Zgjidhni “po” ose “jo” nga lista që hapet me klikim, nëse është ofruar kolateral ose jo.

Shembull 7:

Kandidati ka raportuar një kredi prej 75,000 Lek nga Banka më Mirë e Shqipërisë të cilën e ka marrë për të mbuluar kostot e fushatës. Marrëveshja e kredisë përcakton një normë interesi prej 2.45% dhe datë shlyerje të përcaktuar. Për kredinë nuk është dhënë kolateral.

Sesioni për Shpenzimet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Sesioni i shpenzimeve të formularit tip parashikon raportimin e shpenzimeve sipas faturës. Kandidati do të regjistrojë të gjitha shpenzimet e tij këtu, duke siguruar informacion për çdo faturë të shpenzimeve. Kjo ofron një pasqyrë të detajuar të të gjitha shpenzimeve të fushatës të kryera nga kandidati.

Shifrat në sesionin 3 agregohen automatikisht për të nxjerrë shumën totale të shpenzuar nga kandidati gjatë fushatës.

Të gjitha shpenzimet e kryera në monedhë të huaj duhet të raportohen me kundërvlerën e barabartë në monedhën vendase lekë, në bazë të vlerës sipas kursit të këmbimit në ditën që është bërë konvertimi. Për shembull ju mund të përdorni kursin e këmbimit të bankës tuaj për të reflektuar konvertimin. Për këtë qëllim ju duhet të mbani kopje të faturave që vërtetojnë kryerjen e një këmbimi valutor me kursin e caktuar.

Shpenzimet ndahen në kategori të veçanta:

Mitingje/tubime dhe aktivitete fushate

Tubimet dhe aktivitetet e fushatës përfshijnë mitingjet në ajër të pastër, mbledhje apo takime dhe aktivitete të tjera jashtë dhe brenda. Kostot e zakonshme të lidhura me to janë qiramarrja e ambientit, tarifat për argëtimin, qiramarrja e sistemit të audios, dritat, materialet specifike të printuara, ushqim dhe pijet freskuese.

Materiale promociionale

Kostot e materialeve promociionale lidhen me përgatitjen dhe prodhimin e materialeve për promovimin e fushatës së kandidatit. Përfshin kosto për hartimin e mesazheve të fushatës si dhe të gjitha shpenzimet për prodhimin e artikujve si bluza dhe artikuj të tjerë promociionalë të fushatës.

Media

Shpenzimet për media përfshijnë koston e prodhimit të spoteve televizive dhe radiofonike. Komunikimet në linjë/online mund të përfshihen nën zërin e medias. Shpenzimet për median përfshijnë gjithashtu koston për blerjen e kohës së transmetimit. Shpenzimet për median përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të kostove të fushatës zgjedhore dhe duhet të jenë të dokumentuara plotësisht, përfshirë informacionin lidhur me datat, kohën dhe kohëzgjatjen e saktë të të gjitha transmetimeve në media.

Mediat sociale

Shpenzimet e mediave sociale do të përfshijnë shpenzimet e bëra për reklamim në platformat e mediave sociale si Facebook, Twitter, etj.

Sondazhe

Në këtë kategori, kandidatët zakonisht përfshijnë koston e hartimit, zbatimit dhe analizimit të rezultateve të sondazheve dhe anketimit të opinionit.

Botime/publikime



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Këto shpenzime lidhen me kostot e hasura për qiramarrjen e hapësirave të reklamave dhe prodhimin e fletëpalosjeve dhe materialeve të tjera propagandistike të fushatës.

Transporti

Kostot e transportit përfshijnë kostot e blerjes, qiramarrjes dhe përdorimit të autobusëve, veturave dhe mjeteve të tjera të transportit.

Konsulenca

Këtu do të përfshihen kostot e shërbimeve të konsulencës për zhvillimin e strategjisë së fushatës dhe mesazheve, apo shërbime të tjera profesionale.

Reklamime në natyrë

Kjo kategori do të përfshijë kostot e të gjitha aktiviteteve të zhvilluara jashtë në natyrë, përfshirë këtu kostot për billborde, dritat dhe forma të tjera të aktiviteteve jashtë në natyrë. Gjithsesi, në bazë të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, është e ndaluar vendosja e materialeve propagandistike statike në një distancë më të madhe se 5 (pesë) metra nga zyrat zgjedhore të kandidatit apo të partisë politike.

Shpenzime Administrative

Kjo kategori përfshin pagesat për shërbimet profesionale si ato juridike, kontabilitetit ose të tjera. Gjithashtu mbulon kostot për kancelari shtesë si kompjuter, telefona dhe paga personeli.

Udhëzimet e mëposhtme duhet të ndiqen për të lehtësuar raportimin e shpenzimeve:

Caktojini çdo fature një numër unik identifikimi dhe shkruajeni atë në faturë (p.sh. 0001, 0002, 0003 etj.). Regjistroni shpenzimet në model duke përdorur referencën në faturë. Modeli i ndan shpenzimet në një sërë kategorish të veçanta. Nëse një faturë përfshin shpenzime që lidhen me kategori të ndryshme, vendosni kostot përkatëse në kategoritë e duhura.

Informacione të ngjashme nevojiten për shumicën e kategorive, si p.sh. numrin e faturës, informacionin e shitësit, datën e faturës, vlerën, përshkrimin, datën e pagesës.

Për mitingje/tubime dhe aktivitete fushate, modeli kërkon gjithashtu edhe vendndodhjen, ambientin dhe datën e aktivitetit. Lutemi t'i referoheni Seksionit 3 më poshtë.

Për shpenzimet për media, modeli ofron një menu që hapet me klikim me alternativa për të identifikuar llojin e medias të përfshirë dhe një hapësirë për një përshkrim më të plotë.

Ndërmjet kategorive të shpenzimeve të përmendura më sipër mund të ketë mbivendosje. Kjo do të thotë se në rastet kur një zë shpenzimi mund të bëjë pjesë në më shumë se një kategori, partia politike/subjekti zgjedhor duhet të gjykojë vetë se në cilën kategori mund të futet ai zë shpenzimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Praktika e mirë rekomandon caktimin e kostove në kategoritë ku shkojnë më natyrshëm. Për shembull, shpenzimet për marrjen me qira të një mjeti për transportimin e kandidatëve në një tubim duhet të futet në kategorinë e transportit, tullumbacet duhet të përfshihen në kategorinë e reklamave edhe nëse ato përdoren gjatë një aktiviteti fushate.

Seksioni 3: Shpenzimet

Kolona	Emërtimi Kolonës	i Informacioni që duhet dhënë
A	Kategori a e shpenzi meve	Nga lista që hapet me klikim, zgjidhni kategorinë ku futet shpenzimi
B	Shitësi/furnizuesi	Jepni emrin e shitësit ose furnizuesit
C	Numrin ID të faturës	Jepni numrin e ID të dhënë në faturë
D	Data e faturës	Jepni datën në faturë
E	Data e pagesës	Jepni datën kur është paguar fatura
F	Shuma e paguar	Jepni shumën që është paguar
G	Shuma e papaguar (nëse ka)	Nëse ka, jepni shumën e faturës që nuk është paguar akoma
H	Metoda e kryerjes së pagesës	Zgjidhni nga lista që hapet me klikim mënyrën e kryerjes së pagesës si “para në dorë/cash”, “çek”, “transfertë bankare”, ose “kartë krediti”
I	Shpjegimi	Jepni detaje se me çfarë lidhen shpenzimet
J	Shpenzimet e zyrës elektorale sipas bashkive	Përzgjidhni nga menuja zonën zgjedhore përkatëse.

Plotësoni K vetëm nëse shpenzimet lidhen me Materialet Promocionale/Media sociale/Sondazhet apo Anketimet e Opinioneve Publik/Reklama dhe Botime/Transport



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

K Përshkrimi Jepni një përshkrim të shpenzimit

Plotësoni L -M vetëm nëse shpenzimi lidhet me median

L Lloji i Medias Zgjidhni nga lista që hapet me klikim llojin e medias në fjalë, “TV”, “radio”, “shtyp”, ose “internet”.

M Përshkrimi Jepni detaje për shpenzimin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

**“UDHËZUES PËR MËNYRËN E RAPORTIMIT FINANCIAR NGA KANDIDATËT E
PROPOZUAR NGA ZGJEDHËSIT PËR FUSHATËN ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET PËR
KUVEND”**

HYRJE

Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, partitë politike, të cilat marrin pjesë në zgjedhje dhe kandidatët e tyre janë të detyruar të zbatojnë kuadrin ligjor që rregullon financimin e fushatës zgjedhore. Ky udhëzues synon të shpjegojë aspektet kryesore të kuadrit ligjor dhe në veçanti të ndihmojë kandidatët e propozuar nga zgjedhësit që garojnë në zgjedhje, që të raportojnë aspektet e financimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet për KUVEND, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.¹

Ky manual udhëzues është i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë paraqet një pasqyrë të kuadrit ligjor që rregullon aspektet e financimit të fushatave zgjedhore, pjesa e dytë ofron udhëzime për plotësimin e raportit financiar të fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend.

Nëse keni pyetje apo ju duhet informacion i mëtejshëm, ju lutemi kontaktoni:

Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 4

Tiranë, Shqipëri

Email: _____

I. Përmbledhje e kuadrit ligjor mbi financimin e fushatës zgjedhore

¹Ky udhëzues nuk ka për qëllim të jetë gjithëpërfshirës apo të zëvendësojë Ligjin, andaj përdoruesit këshillohen të konsultohen me Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të miratuara nga KQZ-ja dhe Ligjin për Partitë Politike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Në legjislacionin shqiptar, ka dispozita që rregullojnë financimin vjetor të veprimtarisë së partive politike dhe dispozita të posaçme që rregullojnë financimin e fushatës zgjedhore.² Ky udhëzues fokusohet në rregullat e "financimit të fushatës zgjedhore", të cilat aplikohen për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Sipas Kodit Zgjedhor, kandidatët e propozuar nga zgjedhësit klasifikohen si subjekte zgjedhore³. Kur flasim për rregullat e financimit dhe raportimit të fushatës zgjedhore, është e rëndësishme të kuptojmë që "*shpenzim fushate*" është çdo shpenzim që bën një kandidat i propozuar nga zgjedhësit, një parti ose kandidatët e saj pavarësisht datës se kur është bërë. Pra, raporti do të duhet të përmbajë të gjitha shpenzimet e bëra edhe para fushatës zgjedhore, pavarësisht datës se kur kanë ndodhur. Ndërkohë që dhurimet, huatë ose kreditë që kandidati i propozuar nga zgjedhësit mund të ketë marrë dhe që keni detyrimin për të raportuar, janë ato gjatë fushatës zgjedhore dhe 6 (gjashtë) muaj para fillimit të fushatës.

Në momentin e regjistrimit në zgjedhje, kandidati i propozuar nga zgjedhësit duhet të deklarojë llogarinë apo llogaritë e posaçme bankare për të marrë donacionet mbi vlerën 50,000 lekë⁴. Kandidati mund të zgjedhë të ketë vetëm një llogari të posaçme ose edhe disa, por kushti është që ato të deklarohen. Nëse ju nuk keni llogari bankare të hapura për këtë qëllim, atëherë duhet të siguroheni që llogaria apo llogaritë e posaçme të jenë të hapura para momentit të regjistrimit, i cili është jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara datës së zgjedhjeve⁵. Subjekti zgjedhor⁶ duhet të përfshijë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet, qoftë monetare apo në natyrë, që janë kryer për qëllime zgjedhore pavarësisht datës se kur janë bërë. Të gjitha këto shpenzime përlllogariten përkundrejt tavanit të shpenzimeve që mund të bëjë një kandidat i propozuar nga zgjedhësit për qëllime të fushatës zgjedhore⁷.

"*Fushata zgjedhore*" është periudha kohore që fillon 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 (njëzet e katër) orë para fillimit të votimit. Gjatë kësaj periudhe, përveç rregullimeve ligjore të përmendura më sipër ka edhe disa rregulla në lidhje me llojin e aktiviteteve të lejuara (p.sh. materialet propagandistike dhe koha televizive).

Çfarë do të thotë financim i fushatës?

Sipas legjislacionit zgjedhor, financimi i fushatës i referohet fondeve që mblidhen dhe përdoren nga një subjekt zgjedhor për qëllime apo aktivitete të fushatës zgjedhore. Këtu përfshihen dhurimet monetare, por edhe mallrat ose shërbimet që ofrohen pa pagesë ose me një ulje çmimi për një subjekt zgjedhor⁸ dhe shpenzimet që bëhen për qëllim të fushatës.

²Shiko Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 9, Ligji "Për partitë politike" Kreu III, Kodi Zgjedhor Pjesa VII.

³ Neni 2, pika 20 e Kodit Zgjedhor

⁴ Neni 92/2, pika 3 e Kodit Zgjedhor.

⁵ Neni 69, pika 1 e Kodit Zgjedhor

⁶ Këtu e mëposhtë termi "Subjekt zgjedhor" janë partitë politike kur konkurojnë më vete apo si pjesë e një koalicioni përfshirë kandidatët e tyre dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit referuar neni 1 të Vendimit nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator

⁷ Neni 92/2, pika 5 e Kodit Zgjedhor

⁸ Ky udhëzues përdor përgjithësisht termin "subjekt zgjedhor" duke iu referuar një partie politike apo kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit që janë regjistruar në KQZ si subjekte zgjedhore në përputhje me Kodin Zgjedhor. Neni 2, pika 20 e Kodit Zgjedhor përkufizon si subjekte zgjedhore "partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Cilat janë burimet që lejohen për financimin e fushatës zgjedhore për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit?

Burimet e financimit të fushatës zgjedhore për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit janë:

- Fondet shtetërore (nëse ka sipas nenit 89 të Kodit Zgjedhor);
- Financimi nga burime vetjake të subjektit zgjedhor;
- Dhurimet nga burime jo-publike (private);
- Huatë ose kreditë.

Në dispozicion të subjekteve zgjedhore vihen edhe mbështetje jo-direkte shtetërore për vendet publike ku ato mund të vendosin materiale me karakter propagandistik zgjedhor. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore përcakton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme vendet publike të autorizuar për të afishuar materiale propagandistike.⁹

Ligji përcakton kushtet dhe kufizimet për çdo burim financimi, siç trajtohet më poshtë:

SHËNIM I RËNDËSISHËM

- Përdorimi i burimeve dhe asetëve shtetërore përveçse atyre të lejuara shprehimisht me ligj për të mbështetur partitë politike, kandidatët, ose koalicionet në zgjedhje është i paligjshëm.¹⁰ Ligji gjithashtu ndalon zhvillimin e fushatës zgjedhore në ambiente të institucioneve publike.¹¹ Kjo do të thotë se është i ndaluar përdorimi i burimeve të autoriteteve apo institucioneve shtetërore për qëllime të fushatës zgjedhore, duke përfshirë:

- Asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, si automjetet apo ndërtesat;
- Burimet njerëzore (punonjësit).

1. Financimi nga burime vetjake të kandidatit të propozuar nga zgjedhësit

Detyrimet e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit, për vetëfinancimin e fushatës së tij, do të zbatohen të njëjtat me ato referuar nenit 92/1, pika 2 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. Financimi nga burime jo-publike (private)

⁹Shiko nenin 79, pika 1 e Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimin nr. 06, datë 23.03.2021 të KQZ, “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

¹⁰Shiko nenin 91, të Kodit Zgjedhor. Ndalimi i përdorimit të burimeve shtetërore zbatohet edhe për subjektet ku shteti zotëron kapital ose kuota dhe/ose emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose administrues të entit.

¹¹Shiko nenin 3, pika 7 dhe neni 78, pika 6 të Kodit Zgjedhor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, subjektet zgjedhore mund të marrin fonde vetëm nga persona fizik ose juridik *vendas*.¹² Tek personat *fizië* vendas përfshihen edhe shtetasit shqiptarë që jetojnë në një shtet tjetër.¹³ Fjala “vendas” në ligj është përdorur si antonim i fjalës “i huaj”, pra ka lidhje me shtetësinë e personit dhe jo me vendbanimin e tij. Prandaj termi “person fizik vendas” përfshin edhe shtetas shqiptarë që jetojnë në një vend tjetër.

3. Dhuruesit e palejueshëm

Personat fizik dhe juridik të huaj nuk lejohen të dhurojnë vlera monetare për fushatën zgjedhore të një subjekti zgjedhor. Gjithashtu një subjekt zgjedhor nuk mund të pranojë donacione nga donatorë anonimë¹⁴.

Ndalohet dhënia e fondeve nga një person *juridik* vendas nëse personi juridik apo çdo aksionar i tij:

- Ka përfituar fonde publike, kontrata, apo koncesione gjatë tre viteve të fundit, të cilat tejkalojnë 10 milionë lekë. Ky detyrim zbatohet edhe për rastet e nënkontraktimeve apo të kontratave të partneritetit publik privat.
- Ushtron veprimtari në fushën e medias;
- Ka qenë partner me fonde publike në projekte të ndryshme; ose
- Ka një detyrim monetar kundrejt shtetit ose ndaj çdo institucioni publik.¹⁵

Përveç ndalimit të dhënies së fondeve nga përfituesit e kontratave publike si më sipër, edhe ato persona fizikë apo juridikë që nuk kanë përfituar fonde publike, kontrata apo konçensione gjatë 3 (tre) viteve të fundit para zgjedhjeve, por që financojnë subjektet zgjedhore në fushatë apo kandidatët e tyre, nuk do të mund të përfitojnë për periudhën deri 3 (tre) vite pas zgjedhjeve, kontrata publike, kontrata të partneritetit publik privat ose në çdo mënyrë tjetër fonde me vlerën totale që tejkalon shumën 10 milionë lekë.

Shuma totale që një dhurues i vetëm mund të kontribuojë është e kufizuar me ligj në vlerën 1 milion lekë (qoftë në para ose kundërvlefte në sende ose shërbime). Çdo dhurim që kap vlerën mbi 1 milion lekë është i paligjshëm.¹⁶

4. Huatë ose kreditë

Kreditë janë një formë tjetër e burimit të ligjshëm të financimit për fushatën e kandidatit. Kushtet e kontratës së kredisë do t'i nënshtrohen auditimit si çdo burim tjetër financimi për fushatën zgjedhore dhe shuma e marrë për qëllime të fushatës zgjedhore nëpërmjet kredisë do të llogaritet përkundrejt tavanit të lejueshëm të donacioneve në fushatë. Kandidati do të duhet të sigurojë dokumentacionin mbështetës për secilën hua, përfshirë kështu e ripagimit.

5. Rregulla të tjera

Mënyra e financimit me fonde private i fushatave zgjedhore rregullohet nga dispozita të tjera:

¹³Shiko nenin 92/1, pika 1 e Kodit Zgjedhor.

¹⁴ Shiko nenin 23/1, pika 2 e Ligjit për partitë politike

¹⁵Shiko nenin 92/1, pika 3, shkronja “ç”, e Kodit Zgjedhor.

¹⁶Shiko nenin 92/1, pika 2 e Kodit Zgjedhor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

- Çdo dhurues duhet të nënshkruajë një deklaratë, të miratuar nga KQZ-ja, duke pohuar se nuk aplikohet asnjë nga kushtet e përjashtimit të dhuruesit nga dhurimi.¹⁷
- Të gjitha dhurimet mbi 50,000 lekë duhet të bëhen vetëm në llogaritë bankare të posaçme të deklaruara në KQZ nga subjekti zgjedhor.¹⁸ Edhe nëse dhurimet janë më të vogla se 50,000 lekë por do bëhen nëpërmjet bankës, atëherë subjekti zgjedhor është gjithsesi i detyruar të përdorë vetëm llogaritë e deklaruara.
- Emri i personave që dhurojnë shuma më të mëdha se 50,000 lekë, si dhe vlera përkatëse bëhet publike bashkë me raportin e subjektit zgjedhor dhe raportin e auditimit.¹⁹

Çfarë është një dhurim në natyrë? Si ndryshon nga aktiviteti vullnetar?

Disa mbështetës të subjektit zgjedhor mund të bëjnë dhurim monetar, për shembull, duke transferuar para me bankë ose duke i ofruar para në dorë (e quajtur ndryshe “cash”) për subjektin zgjedhor. Përkrahës të tjerë mund t'i ofrojnë subjektit zgjedhor mallra ose shërbime falas ose me një çmim të ulur, të cilat quhen ndryshe dhurime në natyrë. Në rast se malli apo shërbimi është ofruar me çmim më të ulët nga çmimi real, atëherë diferenca ndërmjet shumës që një subjekt zgjedhor do të paguante me çmim tregu për mallrat apo shërbimet dhe çmimit që ka paguar realisht do të konsiderohet si dhurim në natyrë. Dhurimet, qofshin këto në para ose në natyrë, i nënshtrohen të njëjtave rregulla. Dhurimet mund të ofrohen nga dhuruesit e lejuar deri në shumën 1 milion lekë dhe bëhen publike nëse shuma e përgjithshme nga një dhurues tejkalon vlerën 50,000 Lekë. Deklaratat e dhuruesve, të miratuara nga KQZ-ja, mbahen nga subjekti zgjedhor si për dhurimet në para ashtu edhe për ato në natyrë.

Kur dikush ofron kohën e tij/saj pa pagesë për të ndihmuar fushatën (p.sh. duke shpërndarë fletushka për disa orë në fundjavë), ky është "*aktivitet vullnetar*" dhe jo "*dhurim në natyrë*". Ai nuk do të përfshihet në raportin e financimit të zgjedhjeve të subjektit zgjedhor. Nëse shërbimet nuk ofrohen sipas kushteve të tregut dhe as në formë vullnetare, atëherë këto konsiderohen dhurime në natyrë dhe si të tilla duhet të kostohen dhe regjistrohen. Për të kuptuar më mirë dallimin ndërmjet aktivitetit vullnetar dhe dhurimit në natyrë po japim disa shembuj të tjerë:

- Vendosja në dispozicion e mjediseve tregtare për zyra zgjedhore apo për zhvillim mbledhjeje është dhurim në natyrë, ndërsa hapja e deryve të shtëpisë për takime fushate me komunitetin është aktivitet vullnetar;
- Vendosja në dispozicion të fushatës e automjetit personal për transportin e aktivistëve është aktivitet vullnetar, kurse vendosja e mjeteve të kompanisë, e mjeteve taksi apo e autobuzëve është donacion.
- Marrja apo përdorimi i mallrave (të tilla si kompjuterët) pa pagesë ose me një vlerë të ndryshme nga tregu, do të konsiderohet gjithmonë si dhurim në natyrë dhe jo si veprimtari vullnetar.

Si të vlerësoni një dhurim në natyrë²⁰?

¹⁷ Shiko nenin 92/2, pika 1 e Kodit Zgjedhor

¹⁸ Shiko nenin 92/2, pika 2 e Kodit Zgjedhor

¹⁹ Shiko nenin 92/6, pika 1 dhe 4 e Kodit Zgjedhor.

²⁰ Shih vendimin nr 10 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, dt 24 Dhjetor 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Kur subjekti zgjedhor merr një dhurim në natyrë, vlera e këtij dhurimi duhet të përcaktohet në vlerë monetare. Nëse lindin pyetje se si do të bëhet përlllogaritja e vlerës që ka në para, përgjigja mund të trajtohet si më poshtë: Sa do të kishte paguar subjekti zgjedhor për mallrat ose shërbimet nëse do t'i kishte blerë me çmimin e tregut? Vlera e dhurimit në natyrë është diferenca ndërmjet vlerës së tregut me shumën e paguar (nëse ka).

$$\text{(Vlera e tregut)} - \text{(Vlera e paguar)} = \text{Dhurim në natyrë}$$

Për të bërë sa më të lehtë raportimin dhe vlerësimin e dhurimeve në natyrë, do të zbatohen rregullat e mëposhtme. Në rastin kur subjektit zgjedhor i janë ofruar:

- a) mallra dhe/ose shërbime falas ato do të vlerësohen me çmimin e tregut dhe do të raportohen;
- b) mallra dhe/ose shërbime me një çmim që është të paktën 10% më i ulët se çmimi i tregut, atëherë diferenca prej 10% apo më shumë (sipas rastit) do të raportohet si donacion;
- c) edhe në rastet kur diferenca midis çmimit të tregut dhe çmimit të ofruar është më pak se 10% e vlerës por më e madhe se 50.000 lekë, vlera duhet të raportohet si dhurim. (shihni shembullin 4 më poshtë)

Çmimi i tregut për mallra dhe shërbime do të përcaktohet me një nga metodat e mëposhtme:

- Nëse është e mundur, duke iu referuar indeksit mujor të çmimeve, të publikuara nga INSTAT, në kohën kur mallrat/shërbimet janë ofruar.
- Nëse furnitori operon në biznesin e ofrimit të këtyre të mallrave dhe shërbimeve, çmimi i tregut do të jetë vlera normale tregtare që aplikon furnitori për to, ose
- Subjekti zgjedhor llogarit çmimin e tregut mbi bazën e mesatares së çmimeve të ofruara nga tre ofrues mallrash /shërbimesh të ngjashme.

Shembull 1

Subjekti Zgjedhor A (SZA) kërkon të marrë me qira pajisje audio-vizuale për mitingun e hapjes së fushatës në Tiranë. Shoqëria “Shiko dhe Dëgjo” është ofruar t’i japë pajisjet për këtë organizim me një kosto prej 135,000 lekë. Normalisht, kjo shoqëri do të kërkonte 165,000 lekë për një organizim të tillë, por Administratori i shoqërisë “Shiko dhe Dëgjo” ka dëshirë të mbështesë SZA-në.

- Në këtë rast, subjekti zgjedhor SZA duhet të raportojë një dhurim në natyrë prej 30,000 lekë nga shoqëria “Shiko dhe Dëgjo” në raportin e tij në seksionin 2c të formularit tip. Kjo sepse shumën e zbritjes është më shumë se 10% e çmimit normal. Vlera e dhurimit në natyrë prej 30,000 lekës, do të llogaritet vetë automatikisht edhe si shpenzim nga formati tip i raportimit.

Shembull 2:

Kandidatit të propozuar nga zgjedhësit i ofrohet hapësirë për zyrë falas në Vlorë, Tiranë dhe Korçë për t’u përdorur si zyra zgjedhore nga z. Bujar, një shtetas shqiptar që zotëron pasuri të patundshme në të gjithë vendin. Kandidati ka bërë përlllogaritjen se sa do të kushtonte për të marrë me qira një hapësirë të ngjashme në këto vende për periudhën e fushatës zgjedhore dhe arriti në përfundimin se vlera e dhurimit arrin në 800,000 lekë.

Në këtë rast dhurimet në natyrë për zyrat zgjedhore përfshihen në seksionin 2 (b) të formatit tip të raportimit. Në rast se subjekti zgjedhor ka paguar vetë qiranë e zyrave, këto shpenzime do të raportohen në kategorinë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

“Shpenzime zyrë elektorale” në tab-in “4.a Shpenzimet”. Përveç qirasë së ambientit për zyra zgjedhore, subjekti zgjedhor gjithashtu duhet të raportojë kostot e tjera të zyrës zgjedhore siç janë uji, energjia elektrike, dhe çdo shpenzim tjetër i kryer në funksion të zyrave zgjedhore. Kjo duhet të bëhet për të gjitha zyrat zgjedhore në çdo zonë elektorale pavarësisht nëse ato janë siguruar si dhurime në natyrë ose përfshijnë pagesa parash për përdorimin e tyre.

Shembull 3:

Shoqëria “Karrige me Mbështetëse” i jep kandidatit të propozuar nga zgjedhësit 100 karrige për t’i përdorur gjatë takimeve të fushatës për një periudhë dy javore. Shoqëria normalisht do të kërkonte 75,000 lekë për këtë lloj qiraje.

- Në qoftë se kandidati i propozuar nga zgjedhësit nuk paguan asgjë, atëherë ky dhurim në natyrë në vlerën 75,000 lekë duhet të regjistrohet. Kandidati mund t’i referohet INSTAT-it për të parë nëse ka një normë të caktuar. Nëse Shoqëria “Karrige me Mbështetëse” vetëm shet karrige dhe zakonisht nuk i jep ato me qira, atëherë kandidati duhet të marrë normën e çmimeve nga tre shoqëri që ofrojnë shërbimin e dhënies së karrigeve me qira. Mesatarja e tri ofertave do të raportohet si shuma e dhurimit në natyrë.

Shembull 4:

Mega Media është një shoqëri që operon në sektorin e reklamave. Zakonisht, kjo shoqëri merr 1,500,000 lekë për prodhimin e reklamave të fushatës zgjedhore në televizion dhe radio. Megjithatë, ajo i ofron një subjekti zgjedhor “Kandidat i pavarur”, një zbritje prej 5% (një zbritje çmimi prej 75,000 Lekë) për të prodhuar reklamat televizive dhe në radio të kandidatit, e kështu i faturon kandidatit vetëm vlerën prej 1,425,000 Lekë.

- Subjekti zgjedhor “Kandidat i pavarur” duhet të raportojë një dhurim në natyrë prej 75,000 lekë nga Mega Media në seksionin 2b të raportit të vet, sepse vlera e zbritur është më e lartë se 50,000 lekë, pavarësisht se është më pak se 10% e çmimit të tregut..

Si raportohen dhurimet në natyrë?

Dhurimet në natyrë raportohen si dhuratë për fushatën dhe njëkohësisht si shpenzim i fushatës. Kufiri prej 1 milion lekë i dhurimeve nga një dhurues i vetëm përfshin edhe dhurimet në natyrë, madje dhurimet në natyrë llogariten kundrejt kufirit të lejueshëm të shpenzimeve të subjektit zgjedhor.

Kandidati i propozuar nga zgjedhësit do t’i regjistrojë dhurimet në natyrë duke plotësuar informacionin e kërkuar për raportimin e dhurimeve në natyrë në seksionin 2c të formatit tip të raportimit (dhurimet jo publike në natyrë). Pasi të futen këto të dhëna në formatin tip në Excel ata do të përlllogariten automatikisht në totalin e pjesës përmbledhëse financiare (Pjesa B e Tabelës 1, Përmbledhje Financiare) për shpenzimet indirekte.

VINI RE: Vlera e çdo dhurimi në natyrë do të llogaritet vetë automatikisht edhe si shpenzim nga formati tip i raportimit. Kjo do të thotë që ky shpenzim llogaritet përkundrejt edhe tavanit total të shpenzimeve që mund të bëjë një subjekt zgjedhor.²¹

²¹ Neni 92/2, pika 5 e Kodit Zgjedhor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Shembull 5:

Z. Luan është një mbështetës i madh i subjektit zgjedhor “Kandidati i pavarur”. Z. Luan i dhuron subjektit zgjedhor “Kandidati i pavarur” 125,000 lekë. Gjatë fushatës, z. Luan shpërndan fletushka tek familjet e lagjes së tij në dy raste. Ai gjithashtu pajton dikë me kontratë shërbimi që të ndihmojë fushatën me kryerjen e telefonatave. Z. Luan e paguan këtë person me 40,000 lekë. Së fundmi, ai i jep kandidatit që e kishte mik, të përdorë pa pagesë mjediset e zyrës në ndërtesën e tij tregtare. Normalisht, ai do ta jepte me qira atë hapësirë për 30,000 lekë në muaj. Kjo do të thotë që z. Luan ka bërë një donacion total për fushatën në shumën e 195,000 lekë.

- Subjekti zgjedhor “Kandidati i pavarur” do të raportojë dhurimin monetar prej 125,000 lekë që ka marrë nga z. Luan në Tab 2b të raportit. Gjithashtu, në tab-in 2c të formatit tip të raportimit, kandidati do të duhet të raportojë donacionin në natyrë 40,000 lekë që z. Luan ka bërë si pagesë për punonjësin e telefonit dhe shumën 30,000 lekë dhuratë në natyrë për hapësirën e zyrës.
- Asgjë nuk duhet të raportohet për kohën që z. Luan shpenzoi për shpërndarjen e fletushkave pasi kjo do të kualifikohet si aktivitet vullnetar.

Shembull 6:

Kompania “Albanian Mega Estate” i ofron hapësirë falas për zyra subjektit zgjedhor “Kandidat i pavarur” 60 (gjashtëdhjetë) ditë para ditës së zgjedhjeve deri një javë pas ditës së zgjedhjeve. Pagesa normale e qirasë për këtë hapësirë do të ishte 150,000 Lekë në muaj.

Kompania “Albanian Mega Estate” ka ofruar një kontribut prej 300,000 lekë për subjektin zgjedhor “Kandidat i pavarur” për periudhën parazgjedhore (qiraja të cilën kandidati do ta kishte paguar me çmim tregu për periudhën në fjalë), e cila duhet të raportohet në raportin financiar të fushatës zgjedhore si dhurim në natyrë. Gjithsesi edhe pjesa e ngelur për një çerek muaji (ose një javë) pas zgjedhjeve me një kundërvlerë prej 37.500 lekë duhet të raportohet sërish si donacion në natyrë.

Shembull 7:

Kompania “Albanian Super Financial” i jep një kredi prej 2 milion lekësh subjektit zgjedhor “Kandidat i pavarur” me normë interesi 1% në vend të normës 4% që do të ishte vlera normale e tregut, e pagueshme për një periudhë një vjeçare.

Kompania “Albanian Super Financial” i ka dhënë një kontribut në natyrë prej 60,000 lekës (diferenca ndërmjet shumës së pagueshme nga subjekti zgjedhor “Kandidat i pavarur” dhe shumës që do paguhej nëse norma interesi do të ishte me vlerën normale të tregut). Kjo duhet të raportohet si dhurim në natyrë. Megjithatë kredia është e paligjshme sepse kalon parashikimin ligjor për pragun e 1 milion lekë mbi dhurimet dhe kreditë²². Për këtë shkelje, KQZ-ja do të ndërmerre sanksione sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

Shembull 8:

²² Neni 86, shkronja “ç” e Kodit Zgjedhor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Një mbështetës i subjektit zgjedhor “Kandidat i pavarur” që merret me biznes, shpenzon drejtpërdrejt një shumë prej 2.5 milion lekë për organizimin e një mitingu fushate për subjektin zgjedhor “Kandidat i pavarur”.

Personi në fjalë ka dhënë një kontribut në natyrë prej 2.5 milion lekë, por ka kaluar pragun prej 1 milion lekësh pasi dhurimet që mund të bëjë donator i vetëm janë kufizuar deri në 1 milion. Në këtë rast kemi një kontribut të paligjshëm prej 1.5 milionë lek. Subjekti zgjedhor nuk duhet të pranonte një donacion në para, apo kundërvleftën në sende apo shërbime që e kalojnë vlerën 1 milion lekë.

Çfarë hapash duhet të ndjekë një kandidat i propozuar nga zgjedhësit në lidhje me mbledhjen e fondeve për zgjedhje?

1. Të hapë llogari bankare të posaçme dhe t’i deklarojë ato pranë KQZ-së në momentin e regjistrimit si subjekt zgjedhor. Subjekti zgjedhor mund të zgjedhë të hapë vetëm një llogari të posaçme, por ligji ia lejon të hapë apo të përdorë më shumë se një llogari nëse subjekti e gjykon të nevojshme;
2. Të regjistrojë dhurimet e marra nga çdo dhurues së bashku me të dhënat e identitetit të tij/saj në formularin e miratuar nga KQZ-ja;
3. Të pranojë dhurime monetare që tejkalojnë shumën 50,000 lekë vetëm përmes llogarisë/llogarive bankare të posaçme; dhe të mos pranojë dhurime qofshin edhe me më pak se 50,000 lekë në një llogari bankare të padeklaruar.
4. Të kujdeset që të gjitha dhurimet në natyrë të vlerësohen dhe regjistrohen siç duhet;
5. Të ruajë dokumentet origjinale dhe kopjet e të gjithë dokumentacionit mbështetës në lidhje me të ardhurat e fushatës të mbledhura qoftë monetare apo në natyrë;
6. Të mbajë kopje të të gjithë formularëve të deklarimit të dhuruesve.

Cilat janë rregullat në lidhje me shpenzimet e fushatës për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit?

Ligji përcakton si detyrim një tavan të nivelit të shpenzimeve që një kandidat i propozuar nga zgjedhësit mund të kryejë për fushatën zgjedhore. Neni 92/2, pika 5 e Kodit Zgjedhor parashikon:

Shpenzimi total që mund të kryejë kandidati i propozuar nga zgjedhësit nuk duhet të kalojë 50 për qind të shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike, sipas nenit 88 të këtij ligji.

Çfarë shpenzimesh duhet të përfshihen si shpenzime fushate?

Si shpenzim i fushatës konsiderohet çdo shpenzim që bëhet për qëllime të fushatës pavarësisht kohës se kur ka ndodhur. Çdo shpenzim i fushatës, pagesa përfundimtare e të cilit shtyhet deri pas zgjedhjeve duhet gjithashtu të regjistrohet.

Çfarë raportesh do të dorëzohen nga subjektet zgjedhore dhe cili është afati kohor për to?

Subjektit zgjedhor apo financieri i caktuar prej tij duhet të paraqesë një raport të konsoliduar të zgjedhjeve të financimit të fushatës, me dokumentacionin mbështetës, në KQZ jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve. Raporti duhet të përfshijë të ardhurat dhe shpenzimet e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

subjektit zgjedhor. Për subjektin zgjedhor apo financierin e caktuar prej tij është e rëndësishme të hartojë një raport të plotë duke përdorur formatin e standardizuar të aprovuar nga KQZ-ja; mosrespektimi i parashikimit ligjor për ta bërë këtë do të rezultojë në vendosjen e një penaliteti.

Çfarë ndodh pasi raportet për fushatën zgjedhore janë dorëzuar?

KQZ-ja do të ndërmarrë një shqyrtim paraprak të raporteve për të verifikuar përputhjen me kërkesat formale, sipas formatit tip të miratuar nga KQZ-ja. Në rast të gjetjes së mangësive, KQZ njofton subjektin zgjedhor jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga paraqitja e raportit dhe subjekti zgjedhor do të ketë 3 (tre) ditë pune për të korigjuar raportin. Në çdo rast, raporti i ndryshuar ose shpjegimet e subjektit zgjedhor publikohen nga KQZ-ja në faqen e saj zyrtare jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas ridepozitimit të tij. Pas verifikimit fillestar, KQZ-ja do t'i krahasojë të dhënat në raport me gjetjet dhe konkluzionet e raporteve të auditimit dhe raportet e monitorimit të fushatës zgjedhore gjithashtu dhe me çdo informacion të marrë zyrtarisht ose gjatë hetimeve administrative ose nga denoncimet për shkelje të mundshme të financimit të fushatës sipas Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja cakton një numër personash për të monitoruar përmbushjen nga subjektet zgjedhore të detyrimeve në lidhje me financimin e fushatës dhe detyrimeve të tjera që lidhen me përdorimin apo shpërdorimin e burimeve publike. Roli i monitoruesve të fushatës është që të sigurohen që subjektet zgjedhore të respektojnë rregullat e fushatës dhe të raportojnë në KQZ për aktivitetet zgjedhore që do të vëzhgojnë.

KQZ-ja do të caktojë një ose më shumë auditues ligjorë të licencuar për të kryer kontrollin e fondeve të marra dhe shpenzuara nga çdo subjekt zgjedhor sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit dhe kontabilitetit. Caktimi i audituesve bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.²³

Subjektet zgjedhore duhet të venë në dispozicion të gjitha informacionet, dokumentet dhe të dhënat që lidhen me financimin dhe shpenzimet e fushatës, përndryshe do të dënohen me gjobë.²⁴ Për ta bërë këtë gjë në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme, kandidatët duhet të përdorin formularët tip të standardizuar, të miratuara nga KQZ-ja.

Për t'i ndihmuar me dorëzimin dhe paraqitjen e rregullt të informacionit, KQZ-ja ka miratuar një formular raporti tip të financimit të zgjedhjeve për t'u përdorur nga ana e subjekteve zgjedhore. Formulari tip i raportit do të shqyrtohet më në detaj më poshtë. Vlen të përmendet përsëri se dorëzimi i raporteve në kundërshtim me formatin e standardizuar - që do të thotë raporte që nuk janë të plota, nuk ndjekin të njëjtën strukturë, janë formuluar përmes një aplikacioni tjetër kompjuterik, etj. - do të rezultojë në një gjobë që varion nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë, pavarësisht nga saktësia e informacionit që ato përmbajnë.

Çfarë dokumentesh duhet të mbahen nga subjekti zgjedhor?

Subjektet zgjedhore kanë detyrimin të “vënë në dispozicion të auditit të emëruar nga KQZ-ja çdo informacion, dokumente apo të dhëna që kanë të bëjnë me financimin dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore”, sipas nenit 92/6, pika 2, të Kodit Zgjedhor²⁵. Këtu përfshihen:

²³Shiko Nenin 92/6 të Kodit Zgjedhor

²⁴Neni 173 i Kodit Zgjedhor.

²⁵ Përsa i përket shpenzimeve, Neni 92/3, pika 3 e Kodit Zgjedhor, thotë që çdo shpenzim për fushatën zgjedhore duhet të dokumentohet dhe kryhet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

- Deklaratat e dhuruesve, e miratuar me Vendimin nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator të KQZ-së, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 13, datë 6.4.2021, të Komisionit Rregullator “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”;
- Dokumentet që përcaktojnë identitetin e dhuruesit;
- Kopje të çeqeve të marra nga dhuruesit;
- Pasqyra nga llogaritë bankare të subjektit zgjedhor;
- Faturat e të gjitha shpenzimeve;
- Të gjitha dokumentet e përdorura nga subjekti zgjedhor për të llogaritur vlerësimin e dhurimeve dhe shpenzimeve në natyrë, p.sh. indeksi mujor i çmimeve i publikuar nga INSTAT, kuotat e ofruara nga ofruesit e mallrave/shërbimeve të ngjashme, kopja e tarifave tregtare për mallin/ shërbimin përkatës;
- Pasqyrë e llogarive bankare në fillim të fushatës;
- Dokumente që vërtetojnë kryerjen e një këmbimi valutë me kursin e caktuar, të një monedhe të huaj në monedhën vendase apo anasjelltas, me qëllim kryerjen e një pagese apo shlyerjen e një fature, apo nëse subjekti merr një dhurim në monedhë të huaj të cilin e konverton në monedhën vendase.

Cilat janë sanksionet në rast shkeljeje të ligjit?

Në varësi të natyrës së shkeljes mund të vendosen një numër sanksionesh në lidhje me financimin e fushatës, Neni 173 i Kodit Zgjedhor parashikon se:

1. Shkelja e dispozitave për financimin e fushatës zgjedhore nga personi përgjegjës i financës dënohet me një gjobë nga 100 000 deri 200 000 lekë.
2. Pengimi ose mosbashkëpunimi i subjektit zgjedhor me audituesin e KQZ-së dënohet me një gjobë nga 2 000 000 deri 3 000 000 lekë. E njëjta shkelje e kryer kundrejt monitoruesit të KQZ-së dënohet me gjobë nga 50 000 deri 100 000 lekë.
3. Mosparaqitja e një raporti financiar për fushatën brenda afatit ligjor dënohet me një gjobë prej 2 000 000 lekësh. Paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja dënohet me gjobë nga 500 000 deri 1 000 000 lekë.
4. Fondet jopublike të përfutuara nga një subjekt zgjedhor, identiteti i dhuruesit të të cilave nuk dihet ose nuk përcaktohet qartësisht, transferohen në llogarinë e KQZ-së. Moskalimi çon në konfiskimin e fondeve të marra dhe në një gjobë të barabartë me shumën e fondeve të marra.
5. Pranimi i fondeve private më vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare, dënohet me një gjobë të barabartë me shumën e dhuruar dhe në kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së.
6. Pranimi i fondeve nga donatorë të ndaluar, siç specifikohet në pikën 3 të nenit 92/1, dënohet me kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së dhe me një gjobë të barabartë me dyfishin e shumës së fondeve të marra.
7. Shkelja e përcaktimeve të bëra në nenin 92/2 të këtij ligji nga dhuruesit ndëshkohet me gjobë deri në 30 për qind të shumës së dhuruar.
8. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme gjatë procesit të verifikimit nga KQZ-ja sipas pikës 6 të nenit 92/6, ndëshkohet me gjobë nga KQZ-ja nga 100 000 lekë deri në 3 000 000 lekë.
9. Shkelja e kufirit maksimal të shpenzimeve nga një subjekt zgjedhor dënohet me një gjobë prej 5 000 000 lekësh ose me një gjobë të barabartë me shumën që ka kaluar kufirin, cilado që është më e lartë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

10. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të gjobës së dhënë në bazë të këtij neni. Gjoha e vënë nga KQZ-ja është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet brenda 30 ditësh nga marrja dijeni për të. KQZ-ja përjashtohet nga detyrimi të parapaguajë taksën apo tarifën për shërbimin përmbartimor.

Gjatë vlerësimit të sanksioneve KQZ do të aplikojë parimin e proporcionalitetit dhe do të marri në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- a) rrethanat e kryerjes së shkeljes;
- b) rëndësinë e shkeljes;
- c) nëse subjekti zgjedhor është ose jo përsëritës;
- d) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi i subjektit deklarues;
- e) sjellja që ka pasur subjekti zgjedhor kundrejt rekomandimeve të KQZ-së si dhe niveli i bashkëpunimit gjatë procesit të verifikimit

II. Formulari tip i raportimit financiar të fushatës zgjedhore për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet për Kuvend.

Të gjitha subjektet zgjedhore duhet të raportojnë në lidhje me dhurimet dhe shpenzimet e tyre për periudhën e fushatës, dhe duhet të mbajnë dokumentacionin mbështetës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar një format tip për raportim, i cili detajon gjithë informacionin që duhet të jepet nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.

Formulari tip, i miratuar me Vendimin nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator të KQZ-së, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 13, datë 6.4.2021, të Komisionit Rregullator “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar të subjekteve zgjedhore, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore”, është në formatin Excel dhe do të dorëzohet në **KQZ edhe nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar (PERF) si dhe në hard copy.**

Formulari tip i raportimit përmban seksionet e mëposhtme:

1. Përmbledhje financiare
- 2a. Të ardhura – financime publike
- 2b. Të ardhura nga dhurime monetare jo-publike (private)
- 2c. Të ardhura nga dhurime në natyrë jo-publike (private)
3. Kreditë dhe huatë
4. Shpenzime
5. Shpenzimet për mitingje në fushatë (pasqyrë)

Çdo seksion i formularit tip shpjegohet më poshtë.

Pjesa 1: Përmbledhje financiare

Informacioni i kërkuar në pjesën 1 identifikon subjektin zgjedhor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Shifrat që shfaqen në përmbledhjen financiare përlllogariten në mënyrë *automatike* mbi bazën e të dhënave që vendosen në pjesë të tjera të formularit tip. *Nuk është e nevojshme që shifrat në këtë seksion të hidhen në mënyrë manuale.*

Subjekti zgjedhor apo financieri i caktuar prej tij, duke vënë emrat e tyre në kutizën e nënshkrimit, konfirmojnë vërtetësinë e informacionit të dhënë në raport. Bërja e një deklarate të rremë, jo të plotë ose të pasaktë, sjell pasoja ligjore.

Sesioni 2a: Të ardhura monetare - Financim publike

Sipas nenit 89 të Kodit Zgjedhor, subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhje, të cilat nuk kanë përfituar nga shpërndarja e fondeve sipas nenit 88 të Kodit Zgjedhor, kur marrin jo më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi, KQZ-ja, jo më vonë se 30 ditë nga data e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, iu kompenson fondet me shumën që rezulton nga shumëzimi i votave të vlefshme të marra prej tyre me vlerën e votës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 88 të Kodit Zgjedhor. Në rast se sipas këtij neni, kandidati i propozuar nga zgjedhësit kualifikohet për të marrë fonde shtetërore, atëherë ky fond duhet të shënohet në këtë seksion, në rast se jo, kutiza mund të lihet bosh ose të shënohet me “0” (zero).

2.b Të ardhura monetare - Financime jopublike (Private)

Formulari tip do t’ju ndihmojë të jepni të gjithë informacionin që duhet të raportohet në lidhje me dhurimet monetare jo-publike (private), që janë dhurime të marra në formën e të hollave, çeqeve, transferimeve bankare apo me anë të kartave të kreditit (por jo në formën e të mirave materiale apo shërbimeve, për këtë shih sesionin 2b). Të gjitha dhurimet monetare duhet të evidentohen në një zë të veçantë. Dhurimet monetare të bëra në monedhë të huaj duhet të raportohen me kundërvleftën e barabartë në monedhën vendase lek, në bazë të vlerës sipas kursit të këmbimit në ditën që është bërë konvertimi. Për shembull ju mund të përdorni kursin e këmbimit të bankës tuaj për të reflektuar konvertimin. Për këtë qëllim ju duhet të mbani kopje të faturave që vërtetojnë kryerjen e një këmbimi valutor me kursin e caktuar.

Nëse nuk keni marrë dhurime monetare lidhur me fushatën zgjedhore, ju lutemi zgjidhni alternativën “Konfirmoj se nuk kam zëra për të raportuar” në të djathtë të kuadratis që thotë “Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar - Të ardhura monetare – Financime jopublike” dhe procedoni më tej me seksionin vijues të këtij formulari.

Kolona	Emërtimi i Kolonës	i Informacioni që duhet dhënë
A	Statusi i dhuruesit	Evidentoni statusin e dhuruesit – menuja që hapet me klikim do t’ju lejojë të zgjidhni person fizik ose juridik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

B	Emri i dhuruesit	Jepni emrin e personit fizik që ka bërë dhurimin. Nëse dhuruesi është person juridik, jepni emrin e personit juridik
C	Mbiemri i dhuruesit	Jepni mbiemrin e personit fizik që ka bërë dhurimin. Nëse dhuruesi është person juridik, lëreni këtë kolonë bosh.
D	Adresa, rreshti 1	Jepni emrin e rrugës dhe numrin ose informacionet e tjera të dhuruesit (adresa e banesës për persona fizikë, adresa e zyrës për persona juridikë)
E	Adresa, rreshti 2	Jepni detaje shtesë të adresës së dhuruesit nëse ka.
F	Kodi postar i adresës	Jepni kodin postar të dhuruesit
G	ID/Nipt	Jepni numrin personal të identifikimit të personit fizik ose juridik që ka bërë dhurimin apo Nipt-in
H	Shuma e dhurimit	Jepni vlerën e dhurimit në Lek.
I	Data e dhurimit	Jepni datën kur është marrë dhurimi.
J	Totali i agreguar i dhurimeve nga dhuruesi për zgjedhjet	Vlera totale të dhurimeve monetare të mara deri tani nga dhuruesi në fjalë, përfshirë vlerën e dhurimit që po regjistrohet do të shfaqet automatikisht në këtë zë.
K	Metoda e dhurimit	Zgjidhni nga lista që hapet me klikim mënyrën e marrjes së dhurimit si “para në dorë/cash”, “çek”, “transfertë bankare”, ose “kartë krediti”
L	Kodi bankar i llogarisë në të cilën është depozituar dhurimi	Vendosni kodin e llogarisë bankare në të cilën është depozituar dhurimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

M	Numri i llogarisë në të cilën është depozituar dhurimi	Vendosni numrin e llogarisë në të cilën është depozituar dhurimi
---	--	--

Sesioni 2c: Të ardhura nga dhurimet në natyrë - Financime jo-publike (private)

Ky seksion duhet të përdoret për të dhënë informacion mbi dhurimet e marra në formën e të mirave materiale ose shërbimeve të dhëna ose ofruara pa pagesë ose me vlerë më të ulët se ajo e tregut, pa përfshirë dhurimet monetare. Siç u përmend më lart, shërbimet e rregullta vullnetare nuk klasifikohen si dhurime në natyrë dhe nuk duhet të regjistrohen në këtë formular. Çdo dhurim duhet të jepet në një zë të veçantë. Lutemi t'i referoheni shembujve 1-8 të këtij udhëzimi dhe sesionit 2b të formularit tip të bashkëlidhur.

Nëse nuk keni marrë dhurime në natyrë në lidhje me fushatën zgjedhore, ju lutemi zgjidhni alternativën “Konfirmoj që nuk kemi zëra për të raportuar” në të djathtë të kuadratisë që thotë “Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar – Të ardhura – Dhurime në natyrë – Financime jopublike” dhe kaloni në seksionin tjetër të këtij formulari.

Kolona	Emërtimi i Kolonës	i Informacioni që duhet dhënë
A	Statusi i dhuruesit	Evidentoni statusin e dhuruesit – menuja që hapet me klikim do t’ju lejojë të zgjidhni person fizik ose juridik
B	Emri i dhuruesit	Jepni emrin e personit fizik që ka bërë dhurimin. Nëse dhuruesi është person juridik, jepni emrin e personit juridik
C	Mbiemri i dhuruesit	Jepni mbiemrin e personit fizik që ka bërë dhurimin. Nëse dhuruesi është person juridik, lëreni këtë kolonë bosh.
D	Adresa, rreshti 1	Jepni emrin e rrugës dhe numrin ose informacionet e tjera të dhuruesit (adresa e banesës për persona fizikë, adresa e zyrës për persona juridikë)
E	Adresa, rreshti 2	Jepni detaje shtesë të adresës së dhuruesit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

F	Kodi postar i adresës	Jepni kodin postar të dhuruesit
G	ID/Nipt	Jepni numrin personal të identifikimit të personit fizik ose juridik që ka bërë dhurimin apo Nipt-in
H	Vlera e dhurimit	Përcaktoni vlerën monetare të dhurimit, duke përdorur vlerën aktuale të tregut (për çfarë vlere mund të shitet artikulli nëse ofrohet në treg në kushtet e tij aktuale).
I	Data e dhurimit	Jepni datën në të cilën është marrë dhurimi.
J	Totali i agreguar i dhurimeve nga dhuruesi për zgjedhjet	Vlera totale e dhurimeve monetare të mara deri tani nga dhuruesi në fjalë, përfshirë vlerën e dhurimit që po regjistrohet do të shfaqet automatikisht në këtë zë
K	Përshkrimi i dhurimit në natyrë	Jepni detaje mbi formën e dhurimit – të mirat materiale ose shërbimet e mara dhe kushtet.

Sesioni 3: Huatë dhe kreditë

Huatë dhe kreditë përbëjnë llojin e fundit të financimit që do të regjistrohet në model. Ka një sesion, i cili i kushtohet kredive, që kërkon identitetin e huadhënësit dhe detajet që lidhen me kredinë ose linjën e kredisë.²⁶

Nëse nuk keni marrë hua apo kredi për fushatën zgjedhore, ju lutemi zgjidhni alternativën “Konfirmoj që nuk kemi zëra për të raportuar” në të djathtë të kuadrantit që thotë “Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar – Huatë dhe kreditë e tjera” dhe kaloni në sesionin tjetër të këtij formulari.

Kolona	Emërtimi i Kolonës	i Informacioni që duhet dhënë
A	Emri i huadhënësit	Jepni emrin e plotë të huadhënësit
B	Statusi i huadhënësit	Evidentoni statusin e huadhënësit – menuja që hapet me klikim do t’ju lejojë të zgjidhni person fizik ose juridik

²⁶ Një linjë kredie është një shumë e rënë dakord kredie e disponueshme që klienti i bankës mund ta tërheqë në çdo kohë. Për shembull, mund të jetë një formë linjë kredie (overdraft) i ose një llogari e karte krediti, etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

C	Adresa huadhënësit, rreshti 1	Jepni emrin e rrugës dhe numrin ose informacionet e tjera të huadhënësit (adresa e banesës për persona fizikë, adresa e zyrës për persona juridikë)
D	Adresa huadhënësit, rreshti 2	Jepni detaje shtesë të adresës së huadhënësit.
E	Kodi postar i huadhënësit	Jepni kodin postar të huadhënësit
F	Numri i identifikimit i huadhënësit	Jepni numrin e identifikimit të personit fizik ose juridik që ka dhënë huanë ose ka hapur linjën e kredisë.
G	Numri i referencës së huasë/kredisë	Jepni numrin e referencës të dhënë nga huadhënësi për huanë apo linjën e kredisë përkatëse
H	Shuma e huasë/Limiti i kredisë	Jepni vlerën e huasë ose linjës së kredisë
I	Data e fillimit të huasë/kredisë	Jepni datën e fillimit të huasë ose kredisë
J	Norma e interesit	Jepni normën e interesit që është rënë dakord për huanë ose linjën e kredisë
K	Data e shlyerjes	Jepni datën kur duhet të shlyer plotësisht huaja ose linja e kredisë.
L	Kolaterali i ofruar	Zgjidhni “po” ose “jo” nga lista që hapet me klikim, nëse është ofruar kolateral ose jo.

Shembull:

Subjekti zgjedhor “Kandidat i propozuar nga zgjedhësit” ka raportuar një kredi prej 75,000 lekë nga Banka më e Mirë e Shqipërisë, të cilën e ka marrë më 15 mars 2021 për të mbuluar kostot e fushatës. Marrëveshja e kredisë përcakton një normë interesi prej 2.45% dhe datë shlyerje më 30 gusht 2021. Për kredinë nuk është dhënë kolateral.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

3. Huatë dhe borxhet e tjera						
Ju lutemi konfirmoni nëse nuk keni gjë për të raportuar 3. Huatë dhe borxhet e tjera				Te dhënat e mëposhtme		
A. Emri i Huadhënësit	B. Adresa e huadhënësit (rreshti 1)	C. Adresa e huadhënësit (rreshti 2)	D. Kodi postar i huadhënësit	E. Numri i identifikimit i huadhënësit	F. Numri i referencës së huasë/kredisë	G. Shuma e huasë/limiti i kredisë
Banka Më e Mirë e Shqipërisë	Rr. Ismail Qemali			1000 YY11223344ZZ	54215896	ALL 75 000,00

Sesioni për Shpenzimet

Sesioni i shpenzimeve të formularit tip përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë, sesioni 4, parashikon raportimin e shpenzimeve në bazë të faturës. Subjekti zgjedhor do të regjistrojë të gjitha shpenzimet e tij këtu, duke siguruar informacion për çdo faturë të shpenzimeve. Kjo ofron një pasqyrë të detajuar të të gjitha shpenzimeve të fushatës të kryera nga subjekti zgjedhor.

Pjesa e dytë, sesioni 5, ka një qëllim më të fokusuar raportimi. Kjo pjesë kërkon që subjekti zgjedhor të japë informacion financiar rreth mitingjeve të fushatës, sipas vlerës së shpenzuar për çdo miting. Të gjitha shpenzimet që lidhen me mitingun e caktuar duhet të raportohen. Kjo siguron një pasqyrë se sa mund të kushtojë një aktivitet i tillë.

Vetëm shifrat në Sesionin 4 agregohen automatikisht për të nxjerrë shumën totale të shpenzuar nga subjekti zgjedhor gjatë fushatës, prandaj në sesionin 5 nuk do të ketë llogaritje të dyfishtë të shpenzimeve.

Të gjitha shpenzimet e kryera në monedhë të huaj duhet të raportohen me kundërvleftën e barabartë në monedhën vendase lek, në bazë të vlerës sipas kursit të këmbimit në ditën që është bërë konvertimi. Për shembull ju mund të përdorni kursin e këmbimit të bankës tuaj për të reflektuar konvertimin. Për këtë qëllim ju duhet të mbani kopje të faturave që vërtetojnë kryerjen e një këmbimi valutë me kursin e caktuar.

Shpenzimet ndahen në kategori të veçanta:

Mitingje/tubime dhe aktivitete fushate

Tubimet dhe aktivitetet e fushatës përfshijnë mitingjet në ajër të pastër, mbledhje apo takime dhe aktivitete të tjera jashtë dhe brenda. Kostot e zakonshme të lidhura me to janë qiramarrja e ambientit, tarifat për argëtimin, qiramarrja e sistemit audio / dritat, materialet specifike të printuara dhe ushqim e pije freskuese. Siç theksohet në Sesionin 4b, subjektet zgjedhore duhet të japin informacion shtesë në lidhje me mitingje të mëdha të fushatës/ për secilin miting.

Materiale promociionale

Kostot e materialeve promociionale lidhen me përgatitjen dhe prodhimin e materialeve për promovimin e fushatës së subjektit zgjedhor. Përfshin kosto për hartimin e mesazheve të fushatës si dhe të gjitha shpenzimet për prodhimin e artikujve si bluza dhe artikuj të tjerë promociionalë të fushatës.

Media

Shpenzimet për media përfshijnë koston e prodhimit të spoteve televizive dhe radiofonike. Komunikimet në linjë/online mund të përfshihen nën zërin e medias. Shpenzimet për median përfshijnë gjithashtu kostot për blerjen e kohës së transmetimit. Shpenzimet për median përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të kostove të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

fushatës zgjedhore dhe duhet të jenë të dokumentuara plotësisht, përfshirë informacionin lidhur me datat, kohën dhe kohëzgjatjen e saktë të të gjitha transmetimeve në media.

Mediat sociale

Shpenzimet e mediave sociale do të përfshijnë shpenzimet e bëra për reklamim në platformat e mediave sociale si Facebook, Twitter, etj.

Sondazhe

Në këtë kategori, subjektet zgjedhore zakonisht përfshijnë kostot e hartimit, zbatimit dhe analizimit të rezultateve të sondazheve dhe anketimit të opinionit.

Botime/publikime

Këto shpenzime lidhen me kostot e hasura për qiramarrjen e hapësirave të reklamave dhe prodhimin e fletëpalosjeve dhe materialeve të tjera propagandistike të fushatës.

Transporti

Kostot e transportit përfshijnë kostot e blerjes, qiramarrjes dhe përdorimit të autobusëve, veturave dhe mjeteve të tjera të transportit.

Konsulenca

Këtu do të përfshihen kostot e shërbimeve të konsulencës për zhvillimin e strategjisë së fushatës dhe mesazheve, apo shërbime të tjera profesionale.

Reklamime në natyrë

Kjo kategori do të përfshijë kostot e të gjitha aktiviteteve të zhvilluara jashtë në natyrë, përfshirë këtu kostot për billborde, dritat dhe forma të tjera të aktiviteteve jashtë në natyrë. Gjithsesi, në bazë të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, është e ndaluar vendosja e materialeve propagandistike statike në një distancë jo më të madhe se 5 (pesë) metra nga zyrat zgjedhore të subjektit zgjedhor.

Shpenzime për zyra zgjedhore

Kjo kategori do të përfshijë të gjitha shpenzimet për zyrat zgjedhore të bëra nga ju. Përveç kostonë së qirasë, këtu ju duhet të raportoni edhe për kosto të tjera nëse do të kenë, si p.sh. për ujë dhe drita të zyrave zgjedhore. Kur të përzgjidhni këtë kategori, sigurohuni që tek kolona "I" të jepni një përshkrim se cilin shpenzim po raportoni dhe gjithashtu tek kolona "N" bashkinë ku ka qenë kjo zyrë zgjedhore për të cilën keni raportuar këtë shpenzim.

Shpenzime Administrative



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Kjo kategori përfshin pagesat për shërbimet profesionale si ato juridike, kontabilitetit ose të tjera. Gjithashtu mbulon kostot për kancelari shtesë si kompjuter, telefona dhe paga personeli.

Udhëzimet e mëposhtme duhet të ndiqen për të lehtësuar raportimin e shpenzimeve:

- Caktolini çdo fature një numër unik identifikimi dhe shkruajeni atë në faturë (p.sh. 0001, 0002, 0003 etj.). Regjistroni shpenzimet në model duke përdorur referencën në faturë. Modeli i ndan shpenzimet në një sërë kategorish të veçanta. Nëse një faturë përfshin shpenzime që lidhen me kategori të ndryshme, vendosni kostot përkatëse në kategoritë e duhura.
 - Informacione të ngjashme nevojiten për shumicën e kategorive, si p.sh. numrin e faturës, informacionin e shitësit, datën e faturës, vlerën, përshkrimin, datën e pagesës.
1. Për mitingje/tubime dhe aktivitete fushate, modeli kërkon gjithashtu edhe vendndodhjen, ambientin dhe datën e aktivitetit. Lutemi t'i referoheni seksionit 4c më poshtë.
 2. Për shpenzimet për media, modeli ofron një menu që hapet me klikim me alternativa për të identifikuar llojin e medias të përfshirë dhe një hapësirë për një përshkrim më të plotë.
- Ndërmjet kategorive të shpenzimeve të përmendura më sipër mund të ketë mbivendosje. Kjo do të thotë se në rastet kur një zë shpenzimi mund të bëjë pjesë në më shumë se një kategori, subjekti zgjedhor duhet të gjykojë vetë se në cilën kategori mund të futet ai zë shpenzimi. Praktika e mirë rekomandon caktimin e kostove në kategoritë ku shkojnë më natyrshëm. Për shembull, shpenzimet për marrjen me qira të një mjeti për transportimin e kandidatëve në një tubim duhet të futet në kategorinë e transportit, tullumbacet duhet të përfshihen në kategorinë e reklamave edhe nëse ato përdoren gjatë një aktiviteti fushate.

Sesioni 4: Shpenzimet

Kolona	Emërtimi Kolonës	i Informacioni që duhet dhënë
A	Kategori a e shpenzimeve	Nga lista që hapet me klikim, zgjidhni kategorinë ku futet shpenzimi
B	Shitësi/furnizuesi	Jepni emrin e shitësit ose furnizuesit
C	Numrin ID të faturës	Jepni numrin e ID të dhënë në faturë
D	Data e faturës	Jepni datën në faturë
E	Data e pagesës	Jepni datën kur është paguar fatura



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

F	Shuma e paguar	Jepni shumën që është paguar
G	Shuma e papaguar (nëse ka)	Nëse ka, jepni shumën e faturës që nuk është paguar akoma
H	Metoda e kryerjes së pagesës	Zgjidhni nga lista që hapet me klikim mënyrën e kryerjes së pagesës si “para në dorë/cash”, “çek”, “transfertë bankare”, ose “kartë krediti”
I	Shpjegimi	Jepni detaje se me çfarë lidhen shpenzimet
J	Shpenzimet e zyrës elektorale sipas bashkive	Përzgjidhni nga menuja bashkitë përkatëse.

Plotësoni K-L-M vetëm nëse shpenzimi lidhet me tubimet e fushatës

K	Vendi i mitingut	Jepni informacione mbi vendndodhjen (p.sh. qytetin ose bashkinë) ku është mbajtur tubimi/mitingu që lidhet me shpenzimet
L	Ambienti	Jepni informacion mbi vendin ose ambientin e saktë ku është zhvilluar tubimi/mitingu me të cilin lidhet shpenzimi
M	Data e mitingut	Jepni datën kur është mbajtur tubimi me të cilin është lidhur shpenzimi

Plotësoni P-R vetëm nëse shpenzimi lidhet me median

N	Lloji i Medias	Zgjidhni nga lista që hapet me klikim llojin e medias në fjalë, “TV”, “radio”, “shtyp”, ose “internet”.
O	Përshkrimi	Jepni detaje për shpenzimin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Plotësoni S vetëm nëse shpenzimet lidhen me Materialet Promocionale/Mediat sociale/Sondazhet apo Anketimet e Opinioneve Publik/Reklama dhe Botime/Transport

P Përshkrimi Jepni një përshkrim të shpenzimit

Sesioni 5: Shpenzimet për mitingje në fushatë

Kjo pjesë kërkon që subjektet zgjedhore të japin me detaje shpenzimet që lidhen me një tubim/miting të veçantë apo aktivitet tjetër të fushatës. Siç theksohet më lart, këto shpenzime do të raportohen të shoqëruara me faturë, sipas Sesionit 4.

Çdo miting i fushatës, ku marrin pjesë 5000 pjesëmarrës ose më shumë, duhet të regjistrohet në një rresht në sesionin 5. Në rast se për një miting të caktuar, ju nuk jeni të sigurt nëse kanë marrë pjesë 5,000 pjesëmarrës apo jo, atëherë ju duhet ta konsideroni dhe ta raportoni këtë miting njësoj sikur numri i pjesëmarrësve të ishte 5000 apo më tepër. Nëse më shumë se një faturë lidhet me të njëjtin miting dhe me të njëjtën kategori shpenzimi, vlera e përgjithshme e këtyre faturave duhet të regjistrohet në kolonën C. Nëse një faturë lidhet me më shumë se një nga kategoritë e mëposhtme, shpenzimet duhet të ndahen sipas kategorive për të reflektuar koston që i takon secilës kategori.

Shpenzimet për mitingjet e mëdha duhet të regjistrohen në kategoritë e mëposhtme:

Shpenzime për vendin/ambientin: Këto janë shpenzimet që lidhen me sigurimin dhe përdorimin e hapësirës për mitingun. Këtu mund të përfshihet për shembull një tarifë për marrjen me qira të hapësirës dhe shpenzimet për rrethimin, masat e sigurisë dhe tarifa e pastrimit.

Shpenzime për zbavitje/argëtim: Në këtë kategori përfshihen shpenzime si tarifatat për folës, këngëtarë/muzikantë, etj.

Shpenzime për pajisje: Këto janë shpenzimet kryera për rregullimin e vendit për ta bërë të përshtatshëm për mitingun e fushatës, dhe këtu përfshihen tarifatat për marrjen me qira të një skene, karrigeve dhe sistemit audio-vizuale, si dhe kostot për operimin e pajisjeve.

Shpenzime për pijet freskuese: Në këtë kategori përfshihen shpenzime si për ushqimin dhe pijet e ofruara në këtë aktivitet.

Shpenzime për reklama/promocion: Kjo kategori përfshin kostot e promovimit të ngjarjes, si dhe kostot e materialeve vizuale dhe materialeve të tjera promovuese të krijuara për ngjarjen.

Shpenzime për transport: Shpenzimet kryera për transportimin e pajisjeve tek vendi dhe të njerëzve që marrin pjesë në miting do të raportohen si shpenzime transporti.

Shpenzime administrative: Shpenzimet që lidhen me telefoninë, mesazhet tekst dhe materialet e përdorura nga vullnetarët do të përfshihen në këtë kategori.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Kolona	Emërtimi Kolonës	i Informacioni që duhet dhënë
A	Mitingjet e fushatës	Përzgjidh nga menuja mitingun/tubimin e caktuar
B	Kategoritë e shpenzimeve për mitingje	Përzgjidh nga menuja kategorinë e shpenzimit
C	Kostoja	Vendos kostot për secilën kategori të shpenzimeve

Shembull: Miting fushate në kryeqytet

Subjekti zgjedhor “Kandidat i propozuar nga zgjedhësit” ka organizuar një miting të madh në Tiranë për rreth 10,000 mbështetës për hapjen e fushatës së tij. Shpenzimet janë:

- Marrja me qira e fushës sportive ku është mbajtur mitingu / 100,000 Lekë
- Marrja me qira e skenës, montimi dhe çmontimi/ 135,000 Lekë
- Skenografia dhe skenari- projektimi 270,000 Lekë
- Skenografia dhe skenari- montimi/ çmontimi - 70,000 Lekë
- Marrja me qira e pajisjeve audio dhe video 135,000 Lekë
- Marrja me qira e gardhit 13,500 Lekë
- Siguria, 50 vullnetarë, 50 nëpunës të një agjencie profesionale 135,000 lekë (përfshirë 30% zbritje të ofruar nga Shoqëria e Sigurisë)
- Protokolli – 50 vullnetarë, zburime reklamuese (bluza, kapele, byzylykë)/ 70,000 Lekë
- Fletëpalosje: projektimi, fotografia, shtypja, kopje, printimi 100,000 artikuj / 700,000 lekë
- Flamuj: 2000 artikuj, 70,000 Lekë
- Spot video: kopjimi, regjistrimi, prodhimi në 3 versione / 1,100,000 Lekë
- Tribuna/ stenda për vullnetarët, për shpërndarjen e materialeve promovuese- projektimi dhe prodhimi i stendës 30 artikuj / 200,000 Lekë
- Fushata dixhitale /në linjë - FB 27,000 lekë në ditë/10 ditë, TV 7,000 Lekë në ditë/ 10 ditë, projektimi dixhital 70,000 lekë
- Kosto telefonie + sms – për të marrë në telefon anëtarë, aktivistë dhe vullnetarë, gazetarë, komunikim pa kufi, dërgimi i 100000 sms – 270,000 lekë;
- Tarifa e folësve 20,000 lekë
- Pijet freskuese 13,500 lekë
- Stenda- në të gjitha bashkitë një javë para mitingut të kryeqytetit, çdo ditë 61 x 5 vullnetarë - 305 vullnetarë në ditë (çmimi i komunikimit me vullnetarët dhe trajnimi i tyre - 150,000 lekë;
- Materialet promovuese- kapele, kapëse, këmisha, byzylykë - 250,000 lekë;
- Marrja me qira e autobusit (50 autobusë) për të sjellë aktivistët / përkrasësit nga qytete të tjera - 1,350,000 Lekë;
- Pastrim vendi pas mitingut – shoqëri pastrimi 70,000 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Këto do të regjistrohen në kategoritë e mëposhtme:

Shpenzimet për vendin/ambientin:

- Marrja me qira e fushës sportive ku është mbajtur mitingu / 100,000 LEKË
- Marrja e gardhit 13,500 Lekë
- Siguria, 50 vullnetarë, 50 nëpunës të një agjencie profesionale 135,000 lekë (përfshirë 30% zbritje të ofruar nga Shoqëria e Sigurisë
- Pastrim vendi pas mitingut – shoqëri pastrimi 70,000 lekë

Shpenzimet për zbavitje/argëtim

- Tarifa e folësve 20,000 lekë

Shpenzime për pajisje:

- Marrja me qira e skenës, montimi dhe çmontimi/ 135000 lekë
- Marrja me qira e pajisjeve audio dhe video / 135000 lekë
- Tribuna/ stenda për vullnetarët, për shpërndarjen e materialeve promovuese- projektimi dhe prodhimi i stendës 30 artikuj/ 200,000 Lekë

Shpenzimet për pijet freskuese:

- Pijet freskuese 13,500 lekë

Shpenzime për reklama/promocion:

- Skenografia dhe skenari- projektimi 270,000 lekë
- Skenografia dhe skenari- montimi/ çmontimi - 70 000 lekë
- Fletëpalosje: projektimi, fotografia, shtypja, kopje, printimi 100,000 artikuj / 700,000 lekë
- Flamuj: 2000 artikuj, 70,000 Lekë
- Spot video: kopjimi, regjistrimi, prodhimi në 3 versione / 1,100,000 Lekë
- Fushata dixhitale /në linjë - FB 27,000 lekë në ditë/10 ditë, TV 7,000 Lekë në ditë/ 10 ditë, projektimi dixhital 70,000 lekë
- Stenda- në të gjitha bashkitë një javë para mitingut të kryeqytetit, çdo ditë 61 x 5 vullnetarë - 305 vullnetarë në ditë (çmimi i komunikimit me vullnetarët dhe trajnimi i tyre - 150,000 lekë;
- Materialet promovuese - kapele, kapëse, këmisha, byzylykë - 250,000 lekë;

Shpenzime për transport:

- Marrja me qira e autobusit (50 autobusë) për të sjellë aktivistët / përkrahësit nga qytete të tjera - 1,350,000 Lekë;

Shpenzime administrative:

- Protokollli – 50 vullnetarë, zburime reklamuese (bluza, kapele, byzylykë)/ 70,000 Lekë;

Kosto telefonie + sms – për të marrë në telefon anëtarë, aktivistë dhe vullnetarë, gazetarë, komunikim pa kufi, dërgimi i 100000 sms – 270,000 l